BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

THE NATONAL AND UNIVERSUTY LIBRAY OF KOSOVA

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

7-13 prill 2003

Prishtinë
2004

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

7-13 prill 2003

Botues:
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor i botimeve:
Dr. Sali BASHOTA

Këshilli redaktues:
Vehbi MIFTARI
Drita DEVA
Muhamed ÇITAKU

Realizimi komjuterik:
Hekuran REXHEPI

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

7-13 prill 2003

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Prishtinë
2004

Përmbajtja

Fjala e hapjes (*Mr. Rexhep Osmani*) ____ **9**

Fjalimi inaugurues për Javën e Bibliotekës në Kosovë (*Michael McClellan*) ____ **11**

Fjala hyrëse (*Dr. Sali Bashota*) ____ **14**

Bibliotekat Kombëtare dhe shtrirja e misionit të tyre zgjerues (*Grant Harris*) ____ **16**

Fëmijët në ditaret pa mure (*Mr. Ibrahim Berisha*) ____ **23**

Studimet për shqipen dhe aktualiteti (*Akademik Rexhep Ismajli*) ____ **25**

Fjalë me rastin e hapjes së ekspozitës së dokumenteve për de Radën (*Akademik Rexhep Ismajli*) ____ **39**

Letërsia Shqipe *(Akademik Sabri Hamiti)* ____ ***42***

Dorëshkrime dhe informacione shkencore me vlerë të veçantë nga fusha e albanologjisë (*Dr. Musa Ahmeti*) ____ **50**

Komponentet digjitale në Biblioteka - *Sistemet e integruara bibliotekare (ILS)* *(Grant Harris)* ____ ***66***

Shuflaj për shqiptarët (*Mr. Behxhet Brajshori*) 74

Shuflaj për shqiptarët (*Dr. M.Panxhiq*) 76

Fondi i kodikëve të AQSH (*Dr. Shaban Sinani*) 78

Dr. Milan Pl. Shuflaj (Šufflay), **Acta Albaniae III dhe Balshajt** (*Dr. Shaban Sinani*) 93

Gjetja e pamjeve dhe zërave në faqe të internetit (*Grant Harris*) 101

Fjalor i rëndësishëm i Letërsisë Botërore *(Dr. Isak Shema)* 110

Bija shqiptare - Nëna e botës - Tani Shenjtëresha e Sashurisë Nëna Tereze /1910 - 1997/ (Dr. *Don Lush Gjergji*) 115

Fjalë rasti (*Nehat Krasniqi*) 122

"Krijimi i grupeve të pakicave brenda shoqërisë" (*Anthony Lee*) 124

Bashkudhëtar dhe kronikan i letërsisë *(Mr. Osman Gashi)* 125

Romani është jeta e vërtetë njerëzore (*Dr. Liman Matoshi***)** 128

Mr. Rexhep Osmani
Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Fjala e hapjes

Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë manifestim të organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në bashkëpunim me Zyrën Amerikane në Prishtinë. Manifestimi "Java e Bibliotekës në Kosovë" paraqet një ngjarje të rrallë për jetën kulturore dhe shkencore që do të mbahet këto ditë. Një përshëndetje të veçantë do t'i bëjë mysafirit të këtij manifestimi , specialistit të bibliotekarisë nga Biblioteka e Kongresit Amerikan, z.Grant Harris dhe mysafirëve të tjerë të nderuar.
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është mirënjohëse për mbështetjen e madhe që SHBA dhe Zyra e saj në Prishtinë, kontribuojnë në zhvillimin dhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkencore, për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.
Gjatë kësaj jave do të organizohen aktivitete të shumta nga lëmi të ndryshme kulturore në përgjithësi dhe bibliotekare në veçanti. Ky është një rast i mirë për mundësinë e zhvillimit të bibliotekarisë në Kosovë.
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës po e bënë një prezantim të përbashkët për të forcuar qëllimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së saj profesionale, duke ofruar edhe përvoja të miqve tanë, siç është kësaj radhe, përvoja amerikane. Gjithashtu, një kontribut të madh do ta japin edhe pjesëmarrësit e vendeve të ndryshme dhe të kulturave të ndryshme që do të sjellin të arriturat më të mëdha të vendeve që i përfaqësojnë.
Manifestimi kulturor "Java e Bibliotekës në Kosovë" është një moment i rëndësishëm për thellimin e bashkëpunimit me Bibliotekën e Kongresit Amerikan, mbështetur në

miqësinë e thellë, që ndjejnë njerëzit dhe populli i Kosovës ndaj këtij vendi demokratik dhe vullnetin e tyre që ky manifestim në të ardhmen të bëhet tradicional. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si njëri ndër institucionet më të rëndësishme të vendit, tashti po hyn në një periudhë të re të zhvillimit dhe të përparimit të shumë sferave që kanë të bëjnë me botën e librit.



Michael McClellan
Zyra Amerikane, Prishtinë

Fjalimi inaugurues për "Javën e Bibliotekës" në Kosovë

Në emër të Zyrës Amerikane në Prishtinë, kam nderin që sot t'ju dëshiroj mirëseardhje në atë që ne shpresojmë se do të bëhet një ceremoni e rregullt vjetore për çdo pranverë – Java e Bibliotekës në Kosovë. Nuk është e rastësishme që një ritual i tillë i posaçëm të respektohet në të njëtën kohë si Java e Bibliotekës Kombëtare në Shtetet e Bashkuara, traditë që ne respektuam për çdo vit në 45 vitet e fundit. Me këtë rast, ne në Shtetet e Bashkuara kremtojmë kontributet e bibliotekave në shoqërinë tonë, kjo nënkupton të gjitha bibliotekat: Biblioteka e Kongresit, Biblioteka Universitare, bibliotekat publike, bibliotekat shkollore, si dhe bibliotekat e vogla nëpër kisha, xhamia dhe faltore çifute. Por, kjo është koha që të promovohen bibliotekat dhe të inkurajohet shfrytëzimi i tyre nga qytetarët e të gjitha moshave, nga të gjitha komunitetet, të të gjitha niveleve arsimore, sepse bibliotekat e mira kanë nga diçka për çdonjërin. Ne jemi posaçërisht të lumtur dhe përkrahim zhvillimin e bibliotekave në Kosovë duke punuar ngushtë me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jo-Rezidente. Për Kosovën, roli i Bibliotekës Kombëtare do të jetë një faktor kyç në vitet që vijnë, ashtu sikur që dijetarët dhe shkencëtarët do ta shkruajnë historinë e një Kosove të para dhe pasluftës, përjetimet e luftës dhe zhvillimet e institucioneve demokratike, vetëqeverisëse. Autori i njohur amerikan Gertrude Stein, shkroi më 1932: "Historia kërkon kohë, historia krijon kujtesa." Kjo, për mua është ajo për çka ekziston Biblioteka Kombëtare. Ekziston nëpër kujtesë –

kujtesë të Kosovës – dhe është një kujtesë e të gjitha komuniteteve të Kosovës përgjatë shekujve. Një bibliotekë e mirë kombëtare do të jetë një kujtesë e tërë shoqërisë, kujtesë që nuk do të zbehet nëpër kohë, kujtesë që do të drejtojë dhe formësojë historinë e vet dhe kulturën e gjeneratave të ardhshme. Për një shoqëri siç është kjo e Kosovës – shoqëri që është njëkohësisht e vjetër dhe moderne, e në të njëjtën kohë e vjetër dhe e re që njëkohësisht është me shekuj e vjetër, por edhe vetëm katër vite që ekziston-, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare do të jetë një nga faktorët kyç në zhvillimin intelektual dhe kulturor të shoqërisë. Është një detyrë shumë e fortë, herkuliane, detyrë që kërkon një përkushtim të madh një përgjegjësi enorme nga kujdestarët e vet. Për Kosovën, këta kujdestarë janë dr. Sali Bashota dhe stafi i Bibliotekës Kombëtare. Ashtu si ju kremtoni për të parën herë "Javën e Bibliotekës në Kosovë", ne shpresojmë se populli dhe institucionet e Kosovës do të kuptojnë dhe çmojnë, si kurrë më parë, rolin kyç që ky institucion i nderuar do të duhet ta luajë në jetën tuaj intelektuale dhe kulturore. Meqenëse ne çmojmë shumë këtë institucion, Zyra Amerikane ka sjellë një mysafir special për Javën e Bibliotekës në Kosovë, dhe unë tani kam nderin që atë t'ua prezantoj; - z. Grant Hariss, specialist i shënimeve në Bibliotekën e Kongresit, i cili ka specializuar për Ballkanin dhe gjuhët evropiano-lindore, dhe ne jemi të lumtur ta kemi pranë nesh gjatë tërë Javës së Bibliotekës.

Gjatë paraqitjeve të tij të nesërme, pastaj takimeve të tij të shpeshta dhe trajnimeve me personelin e bibliotekës, z. Hariss do të prezantojë vizionin e misionit të tij për Bibliotekën Kombëtare dhe aktivitet e saj. Jam thellësisht i bindur se ju do ta gjeni këtë vizion si shumë interesant dhe të sfidueshëm, por një detyrë me rëndësi të madhe për demokracitë e porsalindura, si ajo e Kosovës.

Zonja dhe zotërinj, përsëri ju falënderoj që sonte morët pjesë në inaugurimin e Javës së Bibliotekës në Kosovë. Ne urojmë dr. Bashotën dhe stafin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, për gjithë punën që kanë bërë në përgatitjen e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme si dhe për përmirësimet që kanë bërë për ta bërë këtë bibliotekë të bukur dhe të shfrytëzueshme për klientët e vet. Zyra amerikane shpreson të vazhdojë bashkëpunimin me Bibliotekën Kombëtare dhe me bibliotekat e tjera në Kosovë, dhe ne ju dëshirojmë të gjithë juve shumë suksese në punën tuaj. Ju faleminderit.

7 Prill 2003

Dr. Sali Bashota
Drejtor i BKUK-së

Fjala hyrëse

Në kujtesën e Kosovës, krahas të dhënave të tjera, që lidhen me lashtësinë, gjuhën, kulturën, identitetin, etj., dëshmohet edhe për institucionin e parë bibliotekar, të themeluar në vitin 1944 në Prizren. Pastaj, ky institucion kaloi nëpër disa faza të zhvillimit dhe të ndërprerjes.

Faktet dëshmojnë për ndërprerjen e punës së institucionit, për ndryshimin e emrit, ndërsa në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, e përjetoi fazën e rëndë të okupimit. Nga kujtesa e së kaluarës kosovare, pos anatemimit dhe okupimit, megjithatë ky institucion ka krijuar një traditë në zhvillimin dhe avancimin e historisë, kulturës, qytetërimit tonë.

Edhe për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, tash është krijuar një realitet i ri, që ndërlidhet me ndërtimin e institucioneve demokratike.

Ky çast solem, tregon për përcaktimin e një orientimi të qartë, siç është bashkëpunimi, fryt dhe rezultat i procesit të zhvillimit të bibliotekarisë në të ardhmen, në shkëmbimin e informacioneve, ideve, shërbimeve dhe përvojës.

Organizimi i veprimtarisë kulturore e përcaktuar si "Java e Bibliotekës në Kosovë", e cila koincidon me "Javën e Bibliotekës në Amerikë", është një shembull i mirë i bashkëpunimit në këmbimin e ideve dhe koncepteve për vizionin e bibliotekarisë në shekullin XXI. Prandaj, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Zyra e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, po bëjnë një prezentim të përbashkët, për të forcuar rolin dhe qëllimin e zhvillimit të bibliotekarisë, drejt teknologjisë bashkëkohore të informacionit dhe të komunikimit.

Në këtë veprimtari kulturore jehonë do t'i bëhet universit të librit, krijuesit, lexuesit, informacionit, edukimit, zhvillimit kulturor, bashkëpunimit reciprok, kërkimit të

dijeve, menaxhimit, etj., duke ditur faktin se Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, i duhet një shkëmbim efikas i informacioneve, i përvojës rezultative.

Projektet e përbashkëta, në inicimin dhe në zgjerimin e aktiviteteve, në radhë të parë, me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, pastaj me Bibliotekën e Kongresit Amerikan, me bibliotekat evropiane etj., do të ndihmonin në krijimin e një strategjie afatgjatë për përparimin e bibliotekarisë , si dhe nevojën për shkëmbime kulturore me interes të përbashkët. Prandaj, bashkëpunimi me bibliotekat nacionale të vendeve të tjera, është një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e këtij institucioni.

Edhe në të ardhmen BKUK-ja, do të jetë qendër e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, pastaj qendër e promovimit të kulturës kosovare dhe asaj botërore, si dhe qendër e zhvillimit të koleksioneve të veçanta që lidhen me historinë, kulturën, identitetin e Kosovës, duke i favorizuar librat e rrallë dhe dorëshkrimet me vlerë.

BKUK-së i duhet një koncept i ri i reformës në riorganizimin e shërbimeve, duke mësuar nga përvoja e mirë e bibliotekave nacionale të botës dhe veçanërisht një aktivizim i brezave të rinj, në shkollim dhe specializim profesional nga fusha e bibliotekarisë. Gjithsesi, modernizimi i shërbimeve me programe efikase bashkëkohore nënkupton fazën emergjente për këtë institucion.

Në kuadër të kësaj veprimtarie kulturore të emëruar "Java e Bibliotekës në Kosovë", e cila organizohet për herë të parë, do të ketë ligjërata, seminare, përurime veprash, ekspozita librash, pikturash, fotografish, etj.

Me shpresë se ky manifestim të jetë festë e librit dhe nismë e mbarë për zhvillimin e mëtejmë të bashkëpunimit ndërkulturor, juve pjesëmarrës të nderuar, ju urojmë mirëseardhje dhe të gjitha të mirat.

(Fjala përshëndetëse e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Dr. Sali Bashotës, në hapjen e veprimtarisë kulturore "Java e Bibliotekës në Kosovë")

7 prill 2003

Grant Harris
Biblioteka e Kongresit Amerikan

Bibliotekat Kombëtare dhe shtrirja e misionit të tyre zgjerues

(Pesë sfida për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës)

Jo dy biblioteka kombëtare janë të ngjashme. Ato ndryshojnë për kah madhësia, resurset, lloji i koleksionit, funksionet dhe shërbimet. Megjithatë, të gjitha bibliotekat kombëtare i kanë dy elemente të përbashkëta. Ato mbledhin materiale me interes kombëtar, dhe rolet e funksionet e tyre janë zgjeruese. Do të doja të them vetëm pak fjalë para se të filloja diskutimin për thelbin e bisedës sime, e cila ka të bëjë me rëndësinë e informacionit dhe misionin zgjerues që bibliotekat kombëtare po e marrin përsipër në shoqëri. Në këtë kontekst, do t'ua paraqesë pesë sfida për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, sfida që besoj se do ta shtrijnë rëndësinë e Bibliotekës Kombëtare në mbarë Kosovën.

Zhvillimi i hershëm i Bibliotekave Kombëtare

Në shekujt e kaluar, hapi i parë tradicional për një bibliotekë kombëtare ka qenë mbledhja e materialeve të shkruara dhe të shtypura të krijuara brenda vendit, ndërsa hapi i dytë ka qenë ruajtja e tyre. Shumë studiues të librit pajtohen se Franca e kishte bibliotekën e parë kombëtare. Franca ishte njëra prej shteteve të para që e fitoi statusin e kombit dhe biblioteka e saj kryesore ishte e para që

mblodhi botime kombëtare në mënyrë sistematike në kohën kur e fitoi të drejtën ligjore të depozitimit në vitin 1537.[1]

Evropa i themeloi bibliotekat e para kombëtare në shekullin e XVII . Më shumë se 20 (njëzet) biblioteka kombëtare ishin themeluar në Evropë nga fund i atij shekulli, edhe pse ato ende nuk quheshin " biblioteka kombëtare" . Në fillim, ato ishin si biblioteka mbretërore, publike apo akademike. Atyre iu bashkëngjit biblioteka e parë jashtë Evropës më 1800, -Biblioteka e Kongresit- në Washington, D.C., vend në të cilin unë punoj. Siç nënkupton edhe vetë emri i saj, Biblioteka e Kongresit filloi punën si bibliotekë parlamentare, por ajo filloi ta zgjeronte mbledhjen e koleksioneve në vitin 1815, në kohën kur kjo bibliotekë i futi në koleksionin e saj 6.500 vëllime nga biblioteka personale e ish-presidentit Thomas Jefferson (Tomas Xheferson).

Me kalimin e kohës, bibliotekat kombëtare i krijuan katalogët dhe bibliografitë e materialeve kombëtare. Këto tri elemente – mbledhja, ruajtja dhe kontrolli bibliografik – janë detyrat themelore të çdo biblioteke kombëtare. Tradicionalisht, këto funksione kanë shpënë në njërën ndër shpikjet më të mëdha në histori të librit. Libri lulëzon sot e më shumë se pesë shekuj që prej shpikjes së tij; është lehtë për ta përdorur, por ruajtur dhe për ta bartur atë. Libri mbanë në vete mendimin më bindës të autorit të tij, duke e bërë atë mjet të vlefshëm të shkollimit. Libri zgjatë me shekuj nëse ruhet ashtu siç duhet. Thomas Jofferson, me të cilin amerikanët janë krenarë, tha: "Unë nuk mund të jetoj pa libra," dhe më duhet të besoj se sot të gjithë jemi xhefersonian kur kemi parasysh librin.

Megjithatë, libri nuk është i vetmi lloj i materialit prej atyre që bibliotekat mbledhin, ndërsa pak më vonë do t'ju tregoj për koleksionet tona të doreshkrimeve, fotografive dhe materialeve të tjera. Por, së pari, pak fjalë për epokën e informacionit.

Bibliotekat në Epokën e Informacionit

Pas Luftës së Dytë Botërore, njerëzit përpiqeshin ta gjenin një emër që do t'i përshtatejë epokës së re. Disa e quajtën Periudha Pas-industriale, të tjerët e quajtën Periudha Nukleare, dhe më 1957, disa e quajtën Periudha Kozmike për arsye se Bashkimi Sovjetik e lansoi Sputnikun në atë vit. Mirëpo, viti i mëparshëm, d.m.th. viti 1956, shënoi fillimin e vërtetë të një epoke të re në Shtetet e

[1] Line, Maurice B. "National Libraries," in *International Dictonary of Library Histories,* Chicago London: Fitzroy Dearborn Publishers, 2001, Volume I, faqe 11-121.

Bashkuara – Epokën e Informacionit. Në vitin 1956, për herë të parë, kishte më shumë amerikanë që punonin në informacionin dhe sigurimin e shërbimeve se sa që prodhonin mallra. Punëtorët teknikë, udhëheqësitë dhe klerikët i tejkaluan në numër punëtorët e krahut. Tani e kemi të qartë se e kemi keqkuptuar domethënien e Sputnikut. Sputniku ishte njëri prej shumë satelitëve, shumica dërrmuese e të cilëve nuk janë të drejtuar për në hapësirën kozmike, por ata qëndrojnë afër planetit tonë dhe i marrin informacionet nga toka dhe i dërgojnë ato prapë në tokë. Sputniku është më i rëndësishmi në ndihmesën e globalizmit të Epokës së Informacionit.[2]

Nuk është kurrfarë koincidence që bibliotekat kombëtare filluan të ndryshojnë në të njëjtën kohë kur filloi edhe Epoka e Informacionit në vitet e '50-ta. Në njërën anë, bibliotekat i kanë zgjeruar detyrat e tyre themelore gjatë gjysmës së shekullit të kaluar, duke mbledhur libra në mënyrë më sistematike, duke i ruajtur ato në kushte më të mira afatgjate dhe duke siguruar informata më të mira bibliografike. Në anën tjetër, bibliotekat kombëtare janë ballafaquar me sfida dhe mundësi të reja, dhe këtu unë dëshiroj të përqendrohem në pesë sfida që duhet të ballafaqo-

2 Naisbit, John.*Megatrends: Ten New Directions Transformin our Lives.* New York: Warner Books, 1982.faqe 11-12

het biblioteka juaj dhe çdo bibliotekë tjetër.

Sfida e parë dhe e dytë: Mbledhja e formateve jo-libra dhe digjitalizimi i artikujve të zgjedhur në mesin e tyre.

Sfida e parë është nevoja që bibliotekat kombëtare të mbledhin materiale jo-libra, të tilla si dorëshkrime, harta, vepra muzikore dhe fotografi. Është thelbësore që të mblidhen këto materiale jo-libra për arsye se ato janë gjëra unike të trashëgimisë kombëtare dhe se shumica prej tyre janë burim kryesor i informacionit. Nëse nuk përfillen këto, atëherë një pjesë e çmueshme e trashëgimisë suaj do të zhduket.

Sfida e dytë, është nevoja gjithnjë në rritje që ta vëni në Internet trashëgiminë tuaj kombëtare. Pse? E para, për ta arsimuar popullin tuaj dhe popujt e kombeve të tjera; dhe e dyta, ta promovoni kulturën dhe identitetin tuaj.

Biblioteka e Kongresit e ka themeluar një koleksion të materialeve të digjitalizuara të quajtur *American Memory* (Kujtesa Amerikane), që përbëhet prej miliona artikujsh të zgjedhura prej materialeve të veçanta historike nga koleksionet e Bibliotekës së Kongresit. Këto materiale përfshijnë fotografi, dorëshkrime, libra të rrallë, harta, zëra të incizuar dhe fotografi lëvizëse. Do të dëshiroja t'ju tregoja pak shembuj të artikujve nga koleksioni ynë, të cilat janë digjitalizuar për t'u parë në Internet. Më duhet të theksoj se ne kryesisht përqendrohemi të digjitalizojmë vetëm materiale jo-libra; ne e ruajmë origjinalin pasi ta kemi digjitalizuar.

Materialet e digjitalizuara nga koleksioni ynë përfshijnë korrespondencat dhe dorëshkrimet e presidentëve Abraham Lincoln (Abraham Linkoln), George Washington (Gjorgj Washington) dhe Thomas Jefferson, …të Alexander Graham Bell, shpikës i telefonit, …të poetit Walt Whitman, …dhe draftet e para të Deklaratës për Pavarësi të Amerikës (Ammerican Declaration of Independence) të vitit 1976 dhe Gettysburg Address (Fjalimit në Getisburg) të Linkolnit të mbajtur gjatë Luftës Qytetare në Amerikë.

Në pamje kemi përfshirë fushëbetejen e Saratoga-së, New York, më 1777, gjatë luftës për pavarësi të Amerikës… Gettysburg, Pensylvania, më 1863… dhe Kolonel Teddy Roosevelt (Tedy Ruzvelt) dhe Kalorësit e Tij të Ashpër (Rough Riders) duke pushtuar San Juan Hill, më 1898.

Materialet në faqe të Internetit mirren nganjëherë nga mikrofilmi, siç është rasti me këtë artikull gazete të vitit 1947, i cili përshkruan të bëmat heroike të Jackie Robinson (Xheki Robinson), zezaku i parë të cilit iu lejua që të luajë në një ekip amerikan profesional të beisbollit.

Ne kemi digjitalizuar harta të zgjedhura, si kjo e përgatitur nga Zyra e Jashtme e Shteteve të Bashkuara për Ndihmë në Rast Fatkeqësie (U.S.Foreign Disaster Assistance), në nëntor të vitit 1998, që planifikonte për ta ndihmuar Kosovën.
Ne kemi digjitalizuar video filma të zgjedhur, të cilët shërbejnë për të treguar historinë e Amerikës, si kjo këtu e vitit 1903, të Ellis Island (Ishullit Ellis), vend ku hyjnë shumë imigrantë për herë të parë në Shtetet e Bashkuara... apo aparatin me fotografi lëvizëse të Thomas Edison-it, që solli magjinë e filmit në jetë (1900).
Çfarë kam provuar t'ju paraqesë është, para së gjithash, një model i koleksioneve të pasura jo- libra të Bibliotekës së Kongresit, dhe tjetra është se artikuj të zgjedhur nga ky koleksion jo-libra janë vënë në Internet për t'i arsimuar para së gjithash amerikanët, por edhe për ta promovuar kulturën amerikane në vend dhe në botë. E kuptoj se drafti "Ligji mbi Bibliotekat në Kosovë", i shqyrtuar nga Parlamenti i Kosovës flet për mbledhjen e formateve jo-libra nga Biblioteka Kombëtare, dhe shpresoj se kjo do të zbatohet e përkrahur me burime (mjete) të mjaftueshme. Por le të kalojmë tani në tri sfida të tjera për të cilat ju paralajmërova më parë.

Sfida e tretë: Roli udhëheqës ndër Biblioteka

Bibliotekat kombëtare i udhëheqin dhe i koordinojnë bibliotekat e tjera në mbarë rajonin. Çfarë është mirë për Prishtinën është mirë edhe për Pejën, Prizrenin dhe Prekazin, dhe me zhvillimin e një rrjeti më të fortë bibliotekar, secila bibliotekë do të bëhet më e fortë. Do të shtoja se burimet më të zhvilluara informative do t'i sjellin dobi ekonomisë së çdo qyteti, edhe pse, nganjëherë, në mënyrë indirekte. Kërkoj nga ju që t'i inkurajoni dhe të punoni me bibliotekat rajonale, edhe pse tash për tash bibliotekat rajonale janë nën juridiksionin e Ministrisë së Kulturës.

Sfida e Katërt: "Mbledhja e të gjitha Pikëpamjeve"

Bibliotekat kombëtare në vendet e zhvilluara përpiqen të mbledhin të gjitha materialet, të cilat përbëjnë informata lidhur me kombin, pa marrë parasysh se a janë materialet që ofrojnë informacione pozitive apo negative, pa marrë parasysh a mbledhen ato informacione nga grupet etnike shumicë apo pakicë. Bibliotekat Kombëtare në vendet e zhvilluara i injorojnë shpesh pikëpamjet e kundërta apo të pakicave. Ju nxis që të veproni si vend i zhvilluar në këtë aspekt. Do të vijë një kohë kur studiuesve në bibliotekën tuaj do t'u nevojiten t'i konsultojnë pikëpamjet e kundërta apo të pakicave, dhe ju duhet të planifikoni tash për t'i lënë për më vonë në dispozicion këto informacione.

Kur ne sot në Bibliotekën e Kongresit mbledhim materiale, mundohemi që të kemi parasysh nevojat e studiuesve të pasnjëshekulli. Në çfarë do të jenë të interesuar studiuesit e ardhshëm? A jemi duke e mbledhur materialin e duhur që do t'u shërbente edhe studiuesve të nesërm edhe të atyre pas një shekulli?

Sfida e Pestë: "Mbledhja e Burimeve"

Bibliotekave Kombëtare iu nevojiten burime më të mëdha sot sa asnjëherë më parë, duke filluar që nga stafi, trajnimi, pajisjet dhe mjetet e tjera lehtësuese.Ato i mbledhin këto burime në mënyra të ndryshme. Së pari, ato i bindin qeveritë e tyre për misionin zgjerues të bibliotekave, nevojën për të mbledhur materialin që ka të bëjë me vendin, dhe po ashtu përdorimin e Internetit për arsim dhe për ta promovuar kulturën kombëtare brenda dhe jashtë vendit. Së dyti, bibliotekat kombëtare po punojnë në ngritjen e fondeve. Për shembull, Biblioteka e Kongresit e ka krijuar *Medison Council* (Këshillin Medison) – një grup i amerikanëve të njohur, në përbërje të afaristëve, aktorëve, shkrimtarëve dhe të tjerëve – për ta informuar bibliotekën për një numër të çështjeve dhe për ta ndihmuar në ngritjen e fondeve për projekte të veçanta, duke filluar nga sigurimi i librave të rrallë e deri në digjitalizimin e hartave. Kjo nuk është unike për Bibliotekën e Kongresit: pothuaj çdo bibliotekë kombëtare në vendet në zhvillim kërkon përkrahje edhe nga jashtë – nga organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, madje edhe nga sektori privat i vendeve të tjera. Mbajtja e kontakteve me bibliotekat e tjera kombëtare është një mënyrë e tërheqjes së vëmendjes te të tjerët ndaj bibliotekës suaj dhe gjendjes së saj.

Përfundimi

Burimet që i posedojnë bibliotekat perëndimore i kanë vendosur ato në qendër të Epokës së Informacionit. Në shoqëritë perëndimore, bibliotekarët janë ndër të parët që aftësohen dhe kanë qasje në kompjuter. Në shoqëritë e Evropës Lindore, bibliotekarët shpesh janë ndër të fundit që aftësohen dhe kanë qasje në kompjuter. Do të dëshiroja që Kosova ta thyejë këtë model. Para se gjithash bibliotekarët perëndimorë, por gjithnjë e më shumë bibliotekarët në mbarë botën, e përdorin teknologjinë e informacionit për t'i ndihmuar qeveritë e tyre, studiuesit dhe shoqërinë në gjetjen e informacionit të duhur në këtë oqean të të dhënave. Dhe siç kemi parë, bibliotekarët e përdorin Internetin gjithnjë e më shumë për t'i promovuar kulturat e vendeve të tyre.
Tani dëshiroj që t'ju informoj se kam informacione për përpjekjet që tashmë i keni bërë. Për sfidat dhe mundësitë për të cilat fola, në fakt, ato nuk janë të reja

për ju. Shumica prej jush tashmë keni filluar që të planifikoni në këtë drejtim, dhe drafti “Ligji mbi Bibliotekat në Kosovë” është një provë e përparimit tuaj. Dr. Sali Bashota është për t’u lavdëruar për përpjekjet e tij të shpejta në përcaktimin e një date për ngritjen e fondeve dhe përmirësimin e pajisjeve të Bibliotekës Kombëtare. Ne të Bibliotekës së Kongresit ju dëshirojmë sukses dhe shpresojmë që të punojmë së bashku. E di se nuk keni mundësi që t’i zbatoni të gjitha menjëherë; asnjë bibliotekë nuk mund ta bëjë këtë. Biblioteka juaj tashmë është një simbol i kulturës dhe e tëra kjo është një gjë e mirë. Se çfarë jam duke sugjeruar është se çdo bibliotekë kombëtare përpiqet që ta forcojë dobishmërinë, relevancën dhe kuptimin e bibliotekave kombëtare – këtyre institucioneve kryesore – në këtë milenium të ri.

Përktheu: Besim J. Kokollari

Mr. Ibrahim Berisha

Fëmijët në ditarët pa mure

Janë 22 fotografi ku fëmijët zotërojnë mesazhin kryesor në këtë ekspozitë, e cila mbërrin në Kosovë, pas Pragës. Dy krijuesit e njohur të artit të fotografisë, Ridvan Slivova dhe Ferki Çitaku, në mënyrën më të mirë, shprehin potencialin e hijes dhe kolorit, ku përmbajtja estetike nuk dominohet asnjëherë nga etika e përmbajtjes. Fëmijët qofshin në misionin tragjik që ua dhuroi koha e keqe e Kosovës, apo në mesazhin lumturor, që do t’ua dhuron ëndrra e së ardhmes së Kosovës, janë vizioni artistik i fuqishëm, ekspresiv, por i detajuar deri në intimitete ekzistenciale.

Krahas fëmijëve, një botë e tërë të moshuarish, veçmas pleq, ballafaqohen me atë që në jetë mund të ishte vetëm pamundësi e kapërcimit. Përvoja artistike e një krijuesi dhe përvoja jetësore e një plaku, kanë diç thellësisht të përbashkët. Nuancën e kërkimit dhe të pësimit të përhershëm. Mendimin dhe përsosjen.

Pastaj, një kronikë artistike e trishtueshme duket përpara, me gjithë atë që bota e njohu si qëllim për të shkatërruar jetën, pikërisht në këtë tokë, që është edhe mal, edhe rrugë, edhe qytet edhe djegie, edhe hutim edhe pritje edhe dëshmi. Por, dëshmia artistike është, tashmë e fuqishme sa dëshmia jetësore. Sa vetë vizioni i saj. Fare vonë, më ka rrëfyer publicisti Skënder Blakaj, kur në një kolonë shqiptarësh gjatë luftës që lëvizte nga Gollaku drejt Prishtinës, rrethuar nga policët dhe ushtarët serbë që ndanin se, cilin do ta vrisnin dhe, shiu nuk pushonte, në atë trishtim jetësor, kisha dalluar në një traktor, nën një copë çadre, një aparat të vogël se si lëvizte për të bërë dëshmi arti - jetën. I frikshëm por profesional, ky ishte ai trill që nuk e përballoi Ridvan Slivova në atë rrugëtim fanitës, në këtë rast

edhe artistik. Andaj, duhet besuar shumë në fotografinë dhe artin që kemi përpara, sepse të dy këta artistë të fotografisë, paraqesin veçanti të këtij arti të bërë në kushte dhe gjendje, që nuk dëshirohet të përsëriten më.

8 prill 2003

Akademik Rexhep Ismajli
Kryetar i ASHAK-ut

Studimet për shqipen dhe aktualiteti

Në një fjalë si kjo nuk më është dukur e mundshme të flisja në mënyrë relativisht të përmbledhur dhe shteruese si raport të llojit "rezultate dhe probleme". Dhe aq më pak më është dukur e mundshme të flisja kështu kumulativisht për gjuhësinë, pra shkencat për gjuhën, që bëhet nga shqiptarët në Shqipëri dhe në Kosovë, në Maqedoni dhe gjithandej. Jo vetëm se gjerësia e interesimeve të tilla është aq e madhe, sa nuk është e lejueshme t'i përmbledhësh të gjitha në një fjalë rasti si kjo, po edhe dispersioni i qendrave që merren me këto çështje ka ndryshuar ndjeshëm. Është thënë shumë herë deri tash se, në pjesën e dytë të shekullit 20, përnga intensiteti, përnga gjerësia, përnga serioziteteti dhe sistematiciteti i punës së tyre, qendra të rëndësishme të studimeve të gjuhës shqipe ishin bërë Tirana dhe Prishtina. Veprimtari jashtëzakonisht të dobishme kishin zhvilluar qendrat si Shkodra, Mynihu, Roma, Palermo, Berlini, Parisi, Leningradi/ Peterburgu, Chicago, San Diego, etj.

Studimet e organizuara në Tiranë dhe në Prishtinë, si veprimtari hulumtuese, si jetë shkencore, si veprimtari mësimdhënieje, kanë dhënë rezultate me peshë të paparë më herët në historinë e shkencës dhe të kulturës shqiptare. Institucione si fakultetet e filologjisë në Tiranë dhe në Prishtinë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Tiranë, Instituti Albanologjik në Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti Pedagogjik në Shkodër, Shkollat e larta në Gjakovë e Prizren, në Shkup, dhe

fakultetet e filologjisë në Shkup e në Tetovë, kanë realizuar një varg hulumtimesh individuale dhe ekipore, projektesh studimore, monografish dhe botimesh nga më të ndryshmet dhe nga më seriozet në fushën e shkencave gjuhësore.

Dua të përmend me këtë rast disa prej fushave në të cilat në këtë kohë janë arritur me të vërtetë rezultate të shënueshme:

- tudimet për historinë e gjuhës shqipe, përfshirë çështje të ndërlikuara të parashqipes me gjuhët e Ballkanit të lashtë
- studimet për tekstet e vjetra të shqipes dhe për gjuhën e tyre
- studimet etimologjike për shqipen
- studimet për raportet e shqipes me gjuhët e Ballkanit
- studimet për fonetikën dhe për gramatikën e shqipes së sotme
- studimet e dialekteve të shqipes
- studimet për leksikun, vjelja e leksikut popullor dhe krijimi i kartotekave, hartimi i fjalorëve të shqipes dhe dygjuhësh
- studime për kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera
- studime për shqipen standarde
- studime për gjuhën e autorëve të ndryshëm shqiptarë, etj.

Studime me vlerë për gjuhën shqipe u zhvilluan dhe jashtë këtyre suazave shtetërore, në diasporën shqiptare – në Mynih, në Romë, në Palermo, në Napoli e gjetiu, ku vepruan dijetarë të shquar të kësaj fushe si Camaj, Ressuli po dhe shumë arbëreshë. Gjuha shqipe ishte bërë e njohur mjaft herët në atë shkallë që të dukej me interes edhe për indoevropianistët, për romanistët, për sllavistët, për ballkanologët e të tjerët gjithandej.[3]

Në studimet shqiptare të kësaj periudhe mbisundonin kryesisht metodat tradicionale, ndërsa sa u përket risimeve që po sillte gjuhësia teorike nuk kishte rrethana optimale të përhapjes. Kufizimet ideologjike, që imponoheshin, ndonjëherë dhe nga gjuhëtarët, dhe kushtëzimet e tjera që burojnë nga pamundësia e qarkullimit të tyre të lirë, po edhe të ideve, kishin bërë që kjo gjuhësi të zhvillohej në rrethana të komunikimit jooptimal me zhvillimet në fushën e gjuhësisë teorike. Metodat e sofistikuara të studimit gjuhësor, arritjet e periudhës së strukturalizmit, rezultatet e zbatimit të metodave eksperimentale dhe të informatikës,

[3] Referencat nuk janë vënë për shkak të natyrës së tekstit.

aporti i studimeve sintaksore të transformacionalizmit, hapjet e mëdha drejt soci-, psiko-, etno-lingvistikave apo drejt pragmatikës, gjuhësisë së tekstit e fushave të tjera, të cilat bënë që lingvistika të konsiderohej 'shkencë pilot' ndër shkencat shoqërore, më së shpeshti kanë mbetur zhvillime që kanë kaluar pranë nesh, duke lënë gjurmë fare të vogla në studimet për shqipen. Nuk është bërë një gramatikë strukturale për shqipen, një studim themelor transformacional për sintaksën e saj, ka pak analiza semike, ka gjithnjë pak interesime sociolingvistike, aspak psikolingvistike, jemi në fillim të zbatimeve të rezultateve të informatikës, etj.

Shtrohet menjëherë pyetja: institucionet janë po ato, madje qendrat janë përhapur më shumë, pos Tiranës e Shkodrës, studime për shqipen sot kemi në Elbasan, në Korçë, në Gjirokastër, Tetova është bërë një qendër tjetër, tek arbëreshët janë shtuar mundësitë, nga po shkojnë këto studime?

Pikërisht për shkak të shtrirjes, ndonjëherë ndoshta dhe me shkallë më të ulët përqëndrimi, del e vështirë të bëhen bilance të sakta për problemet dhe diskutimet aktuale në studimet për shqipen sot. Kanë ndodhur, porse, pas viteve '90, ndryshime që mund të sjellin një kapërcim cilësor në një fazë të re të këtyre studimeve. Pas rënies së sistemit komunist, në Shqipëri pati për një kohë stagnim të hetueshëm në studimet për shqipen, madje ikje studiuesish dhe të rinjsh potencialisht të interesuar për këto studime jashtë vendit. Kjo ikje nuk ishte ssesi vetëm negative: shumë të rinj, studentë apo studiues, vijuan interesimet e tyre në mjediset e reja, por tani me mundësi dhe horizonte të tjera. Qysh tash kanë nisur të botohen rezultate të studimeve të tyre dhe mund të shpresohet që në një të ardhme jo të largët do të kemi një brez studiuesish të shqipes me përvojat e studimeve gjuhësore në vendet e tjera. Kjo po ngjet tani dhe në vend, sepse nuk ekziston më kontrolli i dikurshëm.

Në Kosovë, ndërkaq, vitet '90 kanë sjellë stagnime edhe më të mëdha, kështuqë institucionet shkencore dhe universitare duan një kohë për ta rimarrë veten tërësisht në këtë drejtim. Zhvillime shpresëdhënëse vërehen në interesimet e të rinjve për azhurnim sa më të madh informacionesh për zhvillimet teorike në fushën e gjuhësisë. Ndërkaq tek arbëreshët bie në sy ndjekja sistematike e një synimi të përcaktuar mirë: vjelja e materialeve të gjuhës popullore, krahas përshkrimit që tani bëhet me metoda të kohës, shpesh madje me studime eksperimentale. Në Universitetin e Kalabrisë janë bërë dhe hapa të rëndësishëm në fushën e përpunimit mekanik të teksteve.

Ndër të rinjtë tani po vërehen interesime për hulumtimet e mirëfillta sociolingvistike, për studimet e stilit, për çështje tekstore e pragmatike.

***

Duke mos dashur të vijoj më tej lidhur me raportime të këtilla, po lejohem të përqëndrohem për pak në dy pika për mua të rënëdësishme për gjuhësinë shqiptare sot.

1. Standardizimi i shqipes dhe kontestimet
2. Kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera.

Dijetarë, letrarë, hulumtues të opinionit publik dhe të skenës politike, ankohen përditë e më shumë për uljen e cilësisë së përdorimit të shqipes si gjuhë standarde dhe përgjithësisht e kulturës, duke theksuar sidomos shkallën e ulët të përdorimit të saj në shkollë e në universitet, për pasojë në jetën publike, madje me parashikime jo të ndritshme për të ardhmen.

Jo vetëm për shqipen, po edhe për gjuhë, ta zëmë si frëngjishtja, qysh në fillim dalin vështirësi rreth përcaktimit të termave si *gjuhë standarde* dhe *gjuhë popullore*. Gjuha standarde nuk mbështetet në një korpus të dhënash të mbledhura dhe të verifikuara empirikisht. Po citoj lidhur me këtë një autor frëng, sipas të cilit: "detyrohemi të pranojmë se, megjithë disa shekuj që na ndajnë nga *Remarques sur la langue françoise*, të dobishme për ata që duan të flasin mirë dhe të shkruajnë mirë (1647), ajo që quhet frëngjishte standarde mbetet një abstraksion, një ideal".

Po shqipja standarde? Duhet të themi se ne kemi një normë relativisht mirë të

elaboruar përsa i përket gjuhës së shkruar. Dhe në këtë kuptim shqipja standarde është varietet autonom i shqipes i ndryshëm nga varietetet e tjera dialektore ose societale, është mbiregjional, i normuar, i mësuar në shkollë, me stile dhe regjistra të diferencuar për hapësirat përkatëse të komunikimit. Në këtë plotni shqipja standarde dhe jo vetëm ajo, del më shumë në formën e shkruar, prandaj standardi i folur varet nga i shkruari, drejtohet sipas tij.

Por komunikimi nuk bëhet vetëm me shkrim, madje më tepër me gojë. Prandaj del krejt normale që standradi empirik të ndryshojë sadopak nga standardi preskriptiv, sepse ka ndryshim notor midis gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur. Por ato forma të ekzistencës dhe të manifestimit të standardit janë të lidhura midis tyre, marrin e japin prej njëra tjetrës. A mund të flasim në rrethana të tilla për një gjuhë standarde identike dhe unike në të gjitha hapësirat ku ajo funksionon, është ajo vërtet realitet?

Shqipja standarde empirike, pra e folur, nuk mund të jetë identike dhe unike në hapësirat ku flitet. Faktorët që e shpjegojnë këtë janë: raportet shoqërore/shtetërore në mjedise të ndryshme, ndarja e hapësirës komunikative dhe vështirësitë në komunikim midis hapësirave të ndryshme, realitetet e ndryshme shoqërore-kulturore, raportet me gjuhët e tjera përreth dhe me gjuhët ndërkombëtare, trashëgimia e gjatë e një statusi të gjuhës së defavorizuar në ish-Jugosllavi, e që vazhdon në Luginën e Preshevës, në Mal të Zi, në Maqedoni, mungesa e statusit fare në Greqi, etj.

Njerëzit kanë kërkuar shpjegime lidhur me pyetjen: prej nga këto dallim? Pse e gjithë kjo çështje nuk u aktualizua më parë?

Nuk është vendi ta zgjasim me shpjegimet për historinë e organizimeve shoqërore në Shqipëri e në ish-Jugosllavi apo gjetiu. Mjafton të themi se në tërësi politika gjuhësore në të dy anët ka qenë dirigjiste, ndërsa tash po kalojmë në shoqëri me synime liberale, prandaj ndryshojnë kërkesat. Shkalla aktuale e anarkisë dhe e anomisë në shoqërinë shqiptare nuk e abrogon nevojën për një politikë liberale dhe për
synime të tilla. Rënia e sistemit dirigjist dhe hapja e mundësisë për zhvillime demokratizuese, rritja e numrit të pjesëmarrësve në hapësirat e komunikimit që më parë rezervoheshin për shqipen standarde, ndryshimet jo të vogla, ndonjëherë përmbysëse demografike, kanë bërë që jo vetëm të rritet numri i folësve në publik, po njëherësh të ketë dhe ndryshime pasojat e të cilave në këtë fushë ende nuk jemi në gjendje t'i shohim në tërësinë e tyre.

Sido që të jetë, shumëkush ka vërejtur se shkalla aktuale e zotërimit të standardit është e pakënaqshme. Për këtë jo rrallë fajësohet shkolla dhe niveli i saj rela-

tivisht i ulët në këto kohë, mënyra e vjetruar e mësimdhënies së gjuhës, zhvillimet e parregullta në shoqëri në 2 dekadat e fundit, mënyra e krijimit të standardit të mbështetur në toskërishten dhe mësimi i gjuhës në rrethana që e veçojnë atë nga konteksti i natyrshëm, etj. Nuk ka dyshim se problemi ekziston dhe se e gjithë çështja është më komplekse se kaq.

Në hartë shihet se ndarjet dialektore shkojnë përtej dhe përmbi kufijtë aktualë shtetërorë: gegërishtja shtrihet në Shqipëri në veri të lumit Shkumbin, në pjesën më të madhe të Maqedonisë, në Kosovë, në Luginën e Preshevës, në Mal të Zi në një kontinuum, ndërsa toskërishtja në Shqipëri në jug të lumit Shkumbin, në një pjesë të Maqedonisë (Strugë, Ohër, Prespë) dhe në Çamëri bashkë me Atikën, Beotinë, ujdhesat dhe Peleponezin në Greqi, ku jeton një popullatë shqiptare së paku nga sh. 14. Është po kështu përgjithësim që nuk i shpreh realitetet në tërësi të thuash në veri kemi gegërishten, në jug toskërishten, sepse këto etiketa përfshijnë vetëm disa tufa izoglosash të kohëve më të hershme, ndërsa të tjera vijnë e nyjtohen ndryshe në këto hapësira.

Tani të kthehemi tek vështrimi i përgjithshëm dhe të rikonstatojmë se çfarëdo variantëzimi që do të ushtrohej mbi bazë të hapësirave dialektore do të dështonte: kufijtë dialektalë nuk përputhen me kufijtë shtetërorë. Kompleksi i fenomeneve të përfshira kështu do të hapte mundësi reale për rritjen e varianteve të krijuara ashtu në gjuhë të ndryshme për shkak të rrethanave të tjera.

Thjesht, duhet të konstatojmë se gjuha shqipe paraqet një shumësi kodesh të ndryshme, si çdo gjuhë tjetër. Këto kode të ndryshme bëjnë variacion në funksion dhe në lidhje me situatat konkrete sociokulturore e historike të projektuara dhe në hapësirë. *Shqipja standarde* dhe *shqipja popullore* (më mirë shqipja e folur) janë abstraksione, idealizime dhe shprehin një kontinuum si dy skaje të një realiteti.

Shqipja popullore vazhdon më tej të folmet e masave fshatare e punëtore brenda gjuhës vernakulare; të dyja kanë mjete të veta të shprehjes: popullorja pasqyron modalitete të gjuhës së folur në situatat e të thënit; standardja më tepër të shkrimit; në aspektin stilistik, popullorja mbulon më tepër situatat e të thënit më spontan dhe nuk u referohet rregullave preskriptive; shqipja popullore ushqehet nga të folmet regjionale dhe nga zhargonet; shqipja standarde ushqehet nga stilet e ndryshme të shqipes së shkruar e gjuhët e huaja.

Shqipja standarde ka karakter të një korpusi preskriptiv, prandaj legjitimohet si mbiregjionale dhe mbidialektore.

Shqipja regjionale është diçka tjetër: është realizim i shqipes standarde me tipare regjionale dialektore të përgjithësuara. Shqipja regjionale definohet ndaj shqipes

standarde si varietet i shtresave të larta, por me shumë elemente të realizimit regjional. Ka karakter gojor, krahinor, regjional, margjinal, etj. Jo shqipja e Kosovës, po e Prishtinës, e Tetovës, e Shkodrës, e Tiranës (ndryshe nga tironçja dialektore), etj.

Situata, pra, është komplekse.

Kur jemi te shkrimi, kemi një normë më konsistente. Kur kalojmë te realizimi gojor, punët ndryshojnë.

Nuk bën të ngatërrohet kultura e të folurit apo të shkruarit me gjuhën e drejtë, korrekte, kjo do t'ishte diçka si manifestim i kompleksit të analfabetizmit.

Kultura e të folurit mund të realizohet në çdo dialekt, apo varietet regjional. Standardi është vetvetiu akt kulture. Shqipe standarde nuk është toskërishtja, sepse dialekti nuk mund të jetë gjuhë standarde vetvetiu. Kemi të bjëmë me manifestimin e kulturës si veprim dhe jo si qenie. Kulturë gjuhe kemi aty ku bëhet diçka për amenazhimin e gjuhës. Bëhet dallimi i qartë midis idiomës organike dhe idiomës standarde gjithandej.

Idiomë organike, gjë që dihet, është idioma amtare, e para, ajo që nxihet përmes imitimit; idiomë në aspektin shoqëror homogjene, e mbyllur, me fizionomi të caktuar qytetëruese: një fshat, një rreth, një fis, pra një dialekt, një e folme; mund të jenë edhe jolokale, si në qytet; pranohet nga anëtarët e komunitetit vullnetarisht si formë identifikimi; është e nuancuar dhe njihet nga çdokush, kështuqë kur nuk arrin të socializohesh me njerëzit e afrët e të dashur në këtë pikë, ndryshe nga standardi, bëhesh defektual. Idioma organike është e drejtë që i përket çdo individi, sepse e ka dhe sepse përmes saj identifikohet me mesin që do. Mohimi është i palejueshëm. Këto janë të njohura për gjuhë të ndryshme të botës gjithandej dhe janë përsëritur shpesh, ashtu sis dhe fakti se standardi është autonom, i normuar, polivalent, ndërlidh me komunikimet ndërkombëtare, është tejetnik; psikologjikisht jospontan, i kontrolluar e me vetëdije metagjuhësore.

Identifikimi i këtij kodi me elemente të ndonjë të folmeje është i rastit dhe vetëm sa u përket elementeve të kodit, por jo funksionimit. Fjalitë e krijuara përmes kodit standard verifikohen nga folësit njohës; mësohet nga tekstet; është jolokal, s'dihet në të nga je; pra është jolokale, e sajuar, e shkolluar, ka për funksion marrëveshjen dhe krijimin brenda veprimtarive zyrtare e kulturore, është i njëjtë dhe identik për bartës të idiomave të ndryshme organike; nuk ka rëndësi denduria e shfaqjes së një fenomeni, po përshtatshmëruia e tij; prandaj tiparet që nuk mësohen mirë në të vërtetë paraqesin normim të keq.

Standardi shpesh shoqërohet me vlerësime si karakter klasor, superioritet kulturor, elitizëm. Por ka dhe letërsi dialektore të cilësisë së parë: Lasgushi, Mjeda,

Fishta, Pashku e Shkreli në dy versionet, De Rada, Xukaro, Camaj, etj.
Duke dashur që sa më shpejt ta bëjmë të pranueshme shqipen standarde kemi pasur reagime të ndalesës dhe të ndjekjes së dialekteve në përdorime për hapësira tëndryshme komunikimi. Duke ia marrë lëngjet jetësore që vijnë nga gjuha e gjallë, e cila për disa mbetet vetëm dialektore, shpesh kemi përfunduar në një diasistem jokoherent, jokonsistent, ose në normim të ngushtë, që për tipar kryesor të standardit ka jospontanitetin.
Tendenca për t'ua mohuar njerëzve të drejtën për përdorimin e idiomës natyrore mund ta shndërrojë përdorimin e standardit në tirani gjuhësore. Kjo sjell reagime, disa nga të cilat po i jetojmë ne. Prandaj ka mbitheksime të aspekteve të lirisë dhe të spontanitetit, të karkaterit lokal, të thyerjes së tabuve përmes lokalizmave dhe vulgarizmave, përmes zhargonit të stisur vonë e me të shpejtë, etj.
Prej këndej mund të nxirret përfundimi se kriza e standardit, që është evidente dhe nuk kapërcehet dot vetëm përmes mësimdhënies së konceptuar si dresurë në shkollë. Më duket e domosdoshme të thuhet se në jetën publike të gjithëve na duhet standradi, ndërsa në jetën e përditshme idioma organike, që mund të jetë dialekti apo variacioni regjional. Pra, hapësirat e komunikimit nuk janë unike dhe për hapësira të ndryshme janë të nevojshme varietetet përkatëse gjuhësore.
Del e nevojshme që në shkollë shqipja standarde të mësohet më tej mbi bazë të idiomës organike që kanë sjellë me vete fëmijët, por si një kod i veçantë, i dalluar mirë: fëmijëve duhet t'u tregohet se burimet, funksioni dhe zbatimi i standardit janë të ndryshëm nga atë të idiomës organike. Nuk duhet të merremi me përputhjet më të mëdha apo më të vogla midis dy idiomave. Nuk mund të verifikohet standardi përmes idiomës organike. Pra, t'u thuhet se standardi është varietet i ri, por jo gjuhë e huaj, gjuhë në të cilën e kemi humbur karakterin e folësit autokton, por prandaj duhet ta shtojmë dijen për të.
Duke kërkuar rreth përgjigjes për pyetjen: çfarë gjuhe të mësohet? Pamë se variacionet në gjuhë varen nga faktorë të ndryshëm, gjeografikë, shoqërorë, situacionalë, etj. Pamë gjithashtu se njësia gjuhësore vlen pak a shumë për gjuhën e shkruar, ndërsa në të folurën, sa i përket normës, dalin më shumë mundësi. E rëndësishme për funksionin e komunikimit është gjithsesi të kuptuarit e ndërsjellë: elementet e përbashkëta për varietetet e ndryshme dhe elementet e repertuarit të njësive të këmbyeshme që di një folës ose që së paku kupton, kanë rëndësi të dorës së parë.
Tradicionalisht janë zhvilluar dy vija të rëndësishme lidhur me mësimdhënien e gjuhës amtare. Në njërën anë është e ashtuquajtura mësimdhënie e kodit gramatikor, e gramatikës, ndërsa në tjetrën pedagogjia e përdorimit të kodit. Kjo lidhet me konceptimet lingvistike të hershme për kodin si objekt të studimit të gjuhësisë, ndërsa për realizimet e atij kodi në të folur si diçka efemere, jokonstante, etj.

Prandaj del e nevojshme të merren parasysh funksionet komunitare, pra edhe të identifikimit, dhe funksionet individuale të gjuhës, kështuqë të zhvillohet qëndrimi i hapur ndaj regjistrave të ndryshëm të gjuhës dhe të varieteteve që ndeshen në të; të zhvillohen shkathësitë e të dëgjuarit dhe të lexuarit, por jo si përkthim me zë i tekstit, brenda varietetit të gjuhës që fëmija tashmë zotëron dhe përmes familjarizimit sa më të madh me regjistrat gjithnjë e më formalë.
Mësimdhënia e gjuhës amtare është dhe bartëse e veprimtarive të shkrimit e të leximit, e mjeteve me peshë për mësimin e materieve të tjera. Duke ua mësuar fëmijëve dallimin midis fjalëve përrua, she, lumë, bëjmë dhe gjeografi. Mësimdhënia e gjuhës amtare synon alfabetizimin e popullatës dhe transmetimin e vlerave tradicionale, të letërsisë dhe të kulturës së trashëguar, të njohjeve, synon të përgatisë individë për ta ushtruar funksionin e komunikimeve të institucionalizuara përbrenda bashkësisë kombëtare dhe jashtë saj. Prandaj është e nevojshme të mos harrohen varietetet e gjuhës që lidhen me këto funksione, duhet të zotërohet një shqipe e zgjedhur gojore.
Prandaj si detyrë me rëndësi del rritja e repertorit gjuhësor të fëmijëve në atë mënyrë që të jenë në gjendje të përdorin variantet që duhen për situatat konkrete të komunikimit.
Në përpjekjet për të ngulitur sa më shumë normat e standardit që kemi, kam parë që në tekstet shkollore autorë të traditës së shekullit 20 të përkthehen në shqipen e sotme standarde. Një prosede i tillë mund të lejohet për autorë si De Rada apo arbëreshë të tjerë, për shkak se distanca e të kuptuarit është e madhe (ka shumë italianizma e greqizma dhe forma gramatikore që për 4-5 shekuj janë zhvilluar ndaraz). Nuk mendoj se kjo mund të lejohet për autorë si Mjedja apo Fishta. Përkundrazi: Mjedja, Fishta, Lasgushi, Naimi kanë një gjuhë letrare që për bazë ka kodin dialektor njësoj, pavarësisht se mund të duket që Naimi e Lasgushi kanë më shumë tipare të përbashkëte me kodin e shqipes së sotme standarde. Tërësia e mjeteve shprehëse dhe e atitudës është dialektore. Ata duhet të mësohen dhe të shijohen si të tillë. Me këtë ne ndihmojmë thelbësisht zgjerimin e aftësive komunikative të fëmijëve për varietete të ndryshme të shqipes.

***

Të kthehemi tani edhe pak tek realiteti.

Së pari anekdota e vitit 2002. Në një prej departamenteve të UNMIK-ut po kërkoja dokumentacionin që rregullon çështjen e gjuhës në nivele të ndryshme. Në të hyrë të korridorit ku duhej të paraqitesha rrinte një burrë i shëndoshë dhe me pamje benjine.

- *You speak English*? më tha ai i pari.

- *Yes, I do speak some English, but I am in a Kosova Ministry and I would like to speak Albanian*, ishte përgjigja, ndërsa veten e zura të inatosur.

Burri me qetësi shembullore nuk foli më. Me një lëvizje dore tregoi drejt sportelit të madh prapa xhamit të të cilit rrinin dy gra të reja pranë telefonit. Njëra me uniformë.

- *Jam filani. Kam një lutje: ka mundësi të shikoni te zyrat e Z. N. N. një dosje me materiale që është rezervuar për mua*?

- *Ajo ka me t'i jae:p ty*?, ishte pyetja e gruas me uniformë prapa xhamit.

- *Po*, u përpoqa të buzëqeshja.

- *Nuk ãsht aty*.

Bëra dhe një përpjekje të vogël duke shpjeguar se materialet që duhej të merrja personi i caktuar i kishte bërë gati dhe i kishte ndarë anash për filan institucionin dhe se ndoshta mund t'i gjente shërbimi edhe pa praninë e saj. Prapë mora përgjigje negative:

- *Nuk ka sekretar?sh. S'p'i jæpin*.

Sot kuadri në raport me UNMIK-un ka ndryshuar, atje kontakton më shumë vendës, por disa prej problemeve persistojnë.

Duke harruar ndodhinë, u përpoqa pas kësaj të nxirrja ndonjë përfundim lidhur me gjuhën që duhet të përdorë qytetari në komunikimin e tij me shtetin aktualisht në Kosovë.

Kontakti dhe komunikimi i parë bëhej anglisht, paçka se në një anglishte dyanshëm të rrëgjuar dhe të stërkequr. Kisha përshtypjen se ashtu mund të kryhej puna relativisht më shpejt dhe më mirë. Gjuha shqipe në komunikimin me shtetin përdorej në mënyrë të pandërmjetme në kontaktet me strukturat bashkëdrejtuese; në rastet e tjera përmes përkthyesit, më shpesh të improvizuar.

Komunikimi me zyrtaren shqiptare me uniformë ishte poashtu interesant. Ajo më drejtohej në një gjuhë që për mua nxirrte në pah dy çështje :

Shqipja e saj ishte jostandarde, me shenja të pafshehura dialektore, të cilat mtonin të shprehnin jo vetëm identitetin e saj, po edhe karakterin e afruar, për të mos thënë familjar, komunitar të komunikimit.

Niveli i komunikimit ishte joformal: në dukje dallimi në moshë midis nesh ishte nja 30 vjet, nuk ishim parë ndonjëherë më parë dhe ajo pa të keq dhe as pa hetuar më drejtohej me ti.

Reagimi i parë ishte: personi zyrtar që ka marrë dhe një trajnim ndërkombëtar për shërbimin publik duhet të ketë një formim adekuat të komunikimit me distancë të nevojshme dhe me manifestim të respektit formal për bashkëbiseduesin në një stil që këtu identifikohet si evropian. Edhe për ata që e dinë se në profesione të ndryshme njerëzit vijnë nga shtresa dhe hapësira të ndryshme, pra me shprehi të nxëna gjatë socializimit, është e qartë se supozojmë që duam shoqëri dhe rend me gjuhë standarde, me shprehi që duhet të nxihen gjatë shkollimit, me një kulturë të foluri.

Përtej këtij reagimi të parë dhe mbase jo fort të menduar, del e nevojshme ta shohim më hapur realitetin, vetë reagimet tona dhe ndërlidhjen e tërë kësaj situate me çështje me peshë poashtu të dorës së parë, si: identiteti dhe shprehja e tij përmes gjuhës, shkalla e përvetësimit të shqipes standarde në raport me nivelin që ka arritur shkolla jonë në këto momente dhe raporti shqipe (standarde apo komunitare)/ anglishte (pavarësisht se çfare).

Problemet, pra, janë të natyrës juridike, të statusit të shqipes; të natyrës së kulturës së gjuhës, të formimit kulturor që duhet të ketë personi zyrtar; të natyrës së raporteve dhe të roleve të pjesëmarrësve në komunikim, të natyrës sociolingvistike dhe të elementeve që supozohet se mbrujnë identitetin e (bashkë)folësit; të respektimit të standardeve komunikative të zyrtarit dhe të palës, etj.

2. Sa u përket çështjeve që mund të konsiderohen si të kompleksit identitar, dua të theksoj disa elemente të natyrës më të përgjithshme me ndikime vendimtare në situatën konkrete. Është konsideruar zakonisht se individi, subjekti i të folurit, ka identitet stabil me tipare të brendshme që ia sigurojnë atij veçantinë, pra individi ka identitet stabil dhe koherent. Në të njëjtën kohë, edhe pse është individi ai që prodhon thënie dhe le gjurmë gjithsesi të hetueshme të vetat në to, është theksuar vazhdimisht identiteti kolektiv dhe jo individual gjuhësor i tij.

Derisa identiteti i folësit lëviz varësisht nga elementi që mbisundon në momentin e caktuar, do theksuar gjithashtu se secili prej elementeve të përmendur identitarë i ka hijet dhe dritat e veta, porozitetin e vet, kështuqë del e vështirë të mendosh farë stabiliteti aty.

Në këtë mënyrë, ndoshta dhe fare implicite, sikur vihet në dyshim ajo që merrej e vërtetë e padiskutueshme më herët për identitetin stabil dhe koherent të individit dhe sikur bëhet me dije që kjo gjë mund të ketë një impakt me peshë në relacionet ku hyjnë standardizimet, pra edhe gjuhësore dhe në hapësirat e rezervuara për to.

Paralelisht me këtë po rritet gjithnjë e më shumë vetëdija për faktin se gjuha standarde dhe kombëtare janë elementet e parme dhe përcaktuese kolektive të mani-

festimeve në thëniet e prodhuara në një bashkësi.

Në lidhje të drejtpërdrejtë me këto dua të përmend faktin se përdorimi publik i shqipes sot, i shqipes standarde, është në ndërlidhje të drejtpërdrejtë me një gamë realitetesh – shoqërore, politike, shtetërore, ndëretnike, ndërkombëtare, etj., në njërën anë, dhe me elementet që e përcaktojnë identitetin konkret, në anën tjetër. Thyerja e modelit centralist dhe dirigjist të shtetit dhe të shoqërisë, për pasojë e modelit të ndërtimit të politikës, të politikës gjuhësore, nxori në sipërfaqe realitetin e kapshëm në çdo anë për identitetet shumësore: kudo i kemi në publik tani elementet fizike, gjeografike, statusore, kontekstuale, stilistike e të tjera dhe veprimet e tyre zinxhirore në rirrafshimet gjuhësore dhe shprehjore: ndryshimet demografike po ndikojnë dhe do të ndikojnë gjithnjë e më ndjeshëm në ndryshimet e vetë standardit empirik të arritur deri tash, ndërsa këto do të pasqyrohen herët a vonë dhe në standardin preskriptiv. Në fakt, po ngjet ajo që duhej të pritej në rrjedhat e kohës sonë gjithandej: pavarësisht nga rritjet në fushën e standardizimit dhe paralelisht me to, në komunikimet publike kemi dhe zvogëlime të peshës së faktorëve kryesorë kolektivë të identitetit dhe rritje të elementeve jo të standardizuara: në mediume, në internet, ndërsa regjionalë dhe dialektorë në radio, në tv. Njëkohësisht vërehet rritje e ndjeshme e elementit mbinacional – përdorimi i anglishtes në format më të ndryshme.

Nuk ndjehem i sigurt ta shtroj pyetjen: a është e mundshme një politikë pa trysni ideologjike, në saje të së cilës elementet jokolektive të identitetit në fushë të gjuhës të njiheshin të barabarta me ato shoqërore dhe kombëtare? Natyrisht që nuk jam ithtar i teorive që apriori dyshojnë për mundësinë e gjëllimit të elementeve të mëdha kolektive, pra edhe për mundësinë e funksionimit të gjuhëve standarde në kuptimin klasik, por as mund t'i mbyll sytë para realiteteve të reja..

Po flasim për identitetin të parë së brendshmi, pra për aspektet ku pritet të reflektohen diversitetet e brendshme, ndërsa kemi lënë anash aspektin tjetër të identitetit – atë të përcaktimit të tij në raport me të tjerët, me gjuhët e tjera. Dhe pikërisht këtu vjen e merr peshë çështja e statusit. Gjatë gjithë shekullit 20 folësit e shqipes kanë qenë në situatë të luftojnë vazhdimisht për dy aspekte të gjuhës së tyre: për

standardizimin e gjuhës dhe njëkohësisht edhe për statusin e saj në jetën shoqërore. Kjo, ndërkaq, e ka përcaktuar ndjeshëm edhe rrugën e zhvillimit të standardit të ndërlidhur drejtpërsëdrejti me kulturën e gjuhës. Eshtë e vërtetë se në Shqipëri nuk ka përbërë problem statusi juridiko-politik i gjuhës, porse çështja e planifikimit të statusit, të bazës për ndërtimin e standardit, me vetë faktin se kufizohej brenda hapësirave londineze, ka qenë e ndërlidhur me statusin e shqipes në pjesët e tjera, konkretisht në ish-Jugosllavi, ku shqipja mund të arrinte maksimalisht statusin e një gjuhe zyrtare krahinore, madje bashkë me një gjuhë tjetër. Në një situatë të tillë edhe mundësia e preokupimit dhe e marrjes me një palë të problemeve apo me një palë tjetër ishte e përndarë në mënyrë joproporcionale, çka lente gjurmë dhe krijonte resentimente më vonë. Eshtë e njohur që derisa në ish-Jugosllavi luftohej për të siguruar një status sa më të lartë juridik-shoqëror për shqipen, çfaredo që të ishte ajo, natyrisht, pa lënë pas dore as aspekte të planifikimit të korpusit në ato rrethana, në Shqipëri zhvillohej vetëm procesi i planifikimit të korpusit, madje pavarësisht nga viset e tjera. Intensiteti i veprimtarive të përqendruara në këtë fushë, energjia shoqërore e investuar për ta arritur qëllimin, vendimet dhe mbështetja qeveritare, ishin elemente që u bënë vendimtare në vijën tjetër të planifikimit të statusit të varietetit të zgjedhur për Shqipëri edhe në ish-Jugosllavi, sepse zhvillimet shoqërore-politike atje ishin të tjera.

Cili është statusi i shqipes në hapësirat e sotme shqiptare?

Eshtë krejt normale të kujtohet se çështja e statusit të shqipes pas largimit të Serbisë nga Kosova për një pjesë të madhe të jetë zgjidhur në Ballkan. A është ashtu?

Pa dashur ta zgjas me dokumentacionin provizor dhe zgjidhjet e propozuara apo të munguara atje, do të them se statusi i shqipes sot në Kosovë është i lidhur me statusin e institucioneve bashkëdrejtuese. Gjuha zyrtare e UNMIK-ut, që ushtron pushtetin e funtmë, është anglishtja, dokument zyrtar në rast kontesti është versioni anglisht, ndërsa shqipja është gjuhë në të cilën kryesisht përkthehet, apo vetëm mund të përkthehet. Dhe në këtë rrafsh statusor trajtohet edhe serbishtja. Posaçërisht të ndjeshme janë fushat e përdorimit të shqipes në marrëdhëniet me botën, në komunikimet mes distrikteve, po edhe në polici, në ushtri, etj, fusha në të cilat institucionet vendëse janë të pranishme në shkallë të caktuar. Formulimet me fuqi ligjore të UNMIK-ut janë anglisht, madje në anglishte të përthyer përmes gjuhës bazë të zyrtarit (nuk mund të mos ketë nuanca ndryshimi midis anglishtes së një francezi dhe të një danezi apo jordanezi, sepse këtu ndikojnë jo vetëm konceptimet e ndryshme joridike-shoqërore, po edhe strukturat e gjuhës së parë të folësit konkret). Mjafton të shikohen shpalljet në dy gjuhë në gazeta për punë, për të parë se kjo gjendje mund të lërë pasoja në cilësinë e gjuhës së përk-

thyer (pra të shqipes), deri dhe moskuptime.
Nga ana tjetër, stimulohet vetëdija se për sukses në punë të zgjedhura, të paguara mirë, mjafton njohja e anglishtes, ndërsa shqipja dhe niveli i zotërimit të saj kulturor e tjetër është çështje e vullnetit shtesë të individit. Ky është një nga elementet që shpjegon faktin se 4 vjet më vonë në strukturat që drejtojnë në këto instanca ka shumë pak zyrtarë që e kanë nxënë shqipen.
Në përgjithësi duhet të thuhet se shqipja sot është në një situatë shumë dinamike si sa i përket statusit ligjor të përdorimit të saj në hapësira dhe funksione të ndryshme, ashtu dhe sa u përket kontakteve me gjuhët e tjera përreth: brenda në vend, ndonjëherë madje me status më të ulët se ç'do të supozonte realiteti përkatës sociolingvistik, ndërsa jashtë gjithnjë në pozitë pa status. Në këto kontakte sundon një dinamikë e hierarkizuar. Kjo nuk mund të mos shprehet në gjendjen dhe cilësinë e gjuhës.
Nga ana tjetër kemi dinamizmin e brendshëm sociolingvistik në raport me realitetet e hapësirave dhe të kodeve të ndryshme dhe të shtresëzuara përdorimore të shqipes, të cilat me ndryshimet demografike të dekadës së fundit planifikuesit dhe standardologët e shqipes i kanë vënë para sprovave jo të vogla. Nuk jam i sigurt nëse konceptimet tona janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme, ndërsa organizimi ekzistues fare, për t'u qëndruar karshi sfidave kështu përmbysëse. Rënia e modeleve centraliste politike, me këtë edhe në politikën e gjuhës, mosndërtimi i modeleve të përshtatshme liberale për politikën e gjuhës në situatën kur synojmë jetë shoqërore e politike me vlera liberale, policentrizmi me raporte të papërkufizuara midis qendrave të ndryshme të rrezatimit, gjendja në pritje dhe pezull në zhvillimet lidhur me statusin e shqipes në shumë hapësira, në një anë, zgjerimi shumë i madh i nevojave të komunikimit standard me hapjen e horizonteve të reja të lirisë së fjalës dhe të shprehjes dhe të përfshirjes së tërë popullatës në jetën publike, ashtu si dhe me daljen nga izolimi i gjatë dhe ngërthimi gjithnjë e më i madh në proceset globalizuese ndërkombëtare, nga ana tjetër, kanë shkaktuar zhvillime që kërkojnë angazhime plotësuese institucionale me mbështetje përkatëse financiare në të gjitha mjediset për zgjidhjen e këtyre problemeve.

8 prill 2004

Akademik Rexhep Ismajli

Kryetar i ASHAK-ut

Fjalë me rastin e hapjes së ekspozitës së dokumenteve për Jeronim de Radën

Më 28 shkurt të këtij viti u mbushën 100 vjet qysh kur në këtë jetë nuk është më Jeronim de Rada (Girolamo de Rada), një nga të mëdhenjtë e kulturës sonë në tërësi, poeti, gjuhëtari, gazetari, studiuesi, veprimtari i zjarrtë, Rilindësi i madh. Atë ditë në Shën Mitër të Kalabrisë arbëreshë nga të gjitha fshatrat e tyre, zyrtarë lokalë dhe krahinorë, studiues, veprimtarë të kulturës dhe përfaqësues të Universitetit të Kalabrisë me fjalime të ngrohta dhe mallëngjyese shënuan solemnisht vitin e de Radës. Po atë ditë në Tiranë, në një konferencë shkencore, dy akademitë tona, studiues nga të gjitha trojet shqiptare, arbëreshë, shënuan 100-vjetorin e vdekjes së poetit dhe të Rilindësit të madh. Në të dy këto veprimtari u tha hapur se në këtë vit e tërë bota shqiptare do të bëjë veprimtari për të nderuar figurën e de Radës: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë, bashkë me ASHAK, do t'ia kushtojnë sesionin e sivjetëm shkencor, ndërsa në Kalabri në muajin tetor do të mbahet një tjetër konferencë shkencore për de Radën.
Jeronim de Rada lindi në Maqi të Kalabrisë më 1814. Mbaroi kolegjin e Shën Adrianit, ndërsa studioi letërsi në Universitetin e Napolit. Më 1836, pra në kohën e romantizmit në Evropë, botoi kryeveprën në vargje Milosao. Pastaj veprimtaria e De Radës ishte shumë e begatshme, qoftë me vepra origjinale, qoftë me ndërmarrje nga më të ndryshme për afirmimin e çështjes shqiptare, apo për idetë e tij politike. Veprat më të shquara, pos Milosaos, janë: Këngët e Serafina Topisë, Numidët, Poesie albanesi, Principi di estetica, Antichita della nazione albanese, Rapsodie, Skanderbegu i pafaan, Pellasgi e albanesi, Autobiologia, Testamento politico, Sofonisba, Caratteri della lingua albanese, Quatro storie o l'Albania, La caduta della Reggia d'Albania, etj.
Më 1844 nisi botimin e fletores L'Albanese d'Italia, ndërsa më 20 korrik 1883 Jeronim de Rada botoi numrin e parë të Fiamurit të Arbërit, fletore letrare e politike italisht e shqip.

Në tërë veprimtarinë e tij Jeronim de Rada u mor me fatin e arbëreshëve, me Motin e madh të Skanderbegut, me botën prej nga kishin shkuar arbëreshën në Itali në sh. 15 – me Arbërinë dhe me botën shqiptare të kohës, ku po zienin idetë e Rilindjes kombëtare.

Jeronim de Rada shkëlqeu mbi të gjitha si poet me kryeveprën Milosao. Poezitë e tij, lirikat e freskëta, të ngjeshura dhe çuditërisht të thjeshta, të botuara arbërisht dhe italisht mahnitën jo vetëm bashkëkohësit e tij, e bënë të përjetshme figurën e tij dhe na mahnisin gjithnjë. Për ta kujtuar vlerësimin e lartë që kishin bashkëkohësit e tij, do të ricitoj këtu fjalët e poetit oksitanas Frederik de Mistral: "Krijimet tuaja janë plot magji. 'Dita e kaltër qesh', çfarë tabloje e mrekullueshme! Është aroma e idilave biblike dhe lëngu i gjuhëve të virgjëra... Nëqoftëse gjuhët e mëdha zyrtare ofrojnë një numër më të madh lexuesish nga ata që shkruajnë në këto gjuhë, gjuhët natyrale përmbajnë burimet e poezisë së vërtetë. Duhet të jeni i lumtur që ju ka rënë shorti të hartoni psalmet e Shqipërisë suaj të dashur. Poezitë tuaja plot freski janë monumente të atdheut tuaj".

Në këto pak radhë jepet vlerësimi i ngjeshur i poezisë së de Radës nga një bashkëkohës romantik me koncepcione të ngjashme me të de Radës sa i përket krijimit dhe gjuhës. Në këtë pikën e fundit, de Rada ishte në vijën e frymëzuesit të të gjithë romantikëve – Herderit.

Poezia dhe në tërësi vepra e de Radës jeton vazhdimisht në kulturën tonë, lexohet, komentohet, rilexohet dhe vazhdimisht na sjell mesazhe.

Sivjet tashmë kanë dalë vepra me interes për de Radën: në SHBA u botua vepra e J. Kastratit për de Radën, ndërsa në Tiranë Alfred Uçi botoi një përkthim të strabilizuar të Parimeve të estetikës të de Radës. Gjatë vitit pritet të botohen vepra të tjera nga arbëreshët, ku ka paralajmërime për një botim të plotë dhe kritik.

Sonte këtu kemi rastin të shohim një ekspozitë me dokumente për de Radën, që për herë të parë për publikun e Prishtinës e ka përgatitur Muzeu i Shqipërisë në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës.

8 prill 2003

Akademik Sabri HAMITI

Letërsia shqipe
-Rikujtesë-

"Forma kushton shtrenjtë , thoshte Pol Valeri kur e pyesnin pse nuk i botonte kurset e mbajtura në College de France. Në këtë mënyrë mjeshtri i ligjërimit e stilisti i madh shprehte dallimin ndërmjet ligjërimit (gojor) dhe shkrimit letrar, natyrisht, duke i bërë nderin e veçantë shkrimit.
Biblioteka, si shtëpi e shkrimeve, madje Dita e Bibliotekës, na japin Vendin e Kohën, madje Rastin, të shfaqim nderimin për *letërsinë shqipe,*duke rikujtuar shfaqjet dhe format e saj të mëdha, qoftë duke e lakuar nëpër universalitetin (Kudo e Përherë), qoftë duke e lakuar nëpër autenticitetin (Sot e Këtu).
Meqë jemi tani në shoqërinë e shkrimeve, për ta ringjallur shkrimin (formën) do ta shfaqim në trajtën e leximit në kontakt (të folurit).
Dijetari i madh shqiptar, Eqrem Çabej, më 1938, duke shkruar për gjenezën e literatures shqipe, kishte arritur te disa përfundime për këtë letërsi, të cilat duhet t'i ketë parasysh secili mendim përgjithësues që shfaqet pas tij. Që letërsia shqipe në vështrimin e përgjithshëm universal bëhet nacionale vetëm në shekullin 19: që letërsia shqipe, si dhe letërsitë e tjera të Evropës Juglindore, është e lidhur fort me letërsinë gojore; që këtu është tepër e dukshme ngjyra politike në shkrimtari. Me që Çabej ishte zbatues i kulturuar (sistematik) i metodës kulturo- historike, ai merrej me *gjenezën* dhe jo me *strukturën* e letërsisë.
Prandaj, kushdo që niset kah *strukturat letrare*, domosdo do të niset një udhe tjetër të kërkimit.

1.
Letërsia shqipe, ndryshe nga artet e tjera që kanë këtë përcaktim, paraqet apo shfaq një gjendje të kulturës, për të mos thënë edhe shpërfaq një identitet nacional të shqiptarëve. Me historinë e vet të shfaqjes në kohë e në hapsirë, si dhe me variantet e veta strukturore, kjo letërsi do të bëhet domosdo e krahasueshme me lakimet e zhvillimet e tundjet shpirtërore të kombit. Prandaj, në gjirin e saj, do të strukturohet detyra përtejletrare, që nuk është karakteristikë e parë e letërsisë në vështrim universal të këtij arti.
Po u nisëm nga qarku themelor i thurjeve dhe komunikimeve letrare që përmban Autorin, Veprën e Lexuesin, ne do të njohim një komunikim kur e kur specifik ndërmjet faktorëve të këtij qarku. Pamjet do të dalin here të drejta, here të përmbysura. Autori, jo vetëm krijues letrar, por edhe bartës intencional i një ideje, duke u shfaqur edhe vetë misionar i saj si në jetë ashtu edhe në literature. Jo pak autorë të mëdhenj të shqipes janë njëherësh protoganistë të zhvillimeve kulturore, shoqërore, madje historike të kombit. Vepra letrare, jo vetëm strukturë e mjaftueshme më vete që shprehë një botë, por shpesh mes njohjeje, edhe më tepër medium për të artikuluar *porosinë* për jetën shoqërore.
Lexuesi duke qenë rreptësisht i përcaktuar nga një zhvillim konkret kulturor e shoqëror padashur nuk do të jetë më vetëm harxhues i kuptimeve, por edhe përcaktues i ndërmjetshëm i një tipi të krijimtarisë. Dihet çfarë literature mund të receptohet në ambientin ku mezi është bërë alafabetizimi.
Prandaj, njohja e strukturave letrare e të komunikimit letrar në shqip të shpie kah njohja e strukturave të zhvillimeve shoqërore e historike të shqiptarëve.

2.
Një kulture antike me një shkrimtari të vonë, është një formulë e paradoksit kulturor, që përsëritet, jo pa dhembje në botën shqiptare, madje edhe nga dijetari brilant i letrave, Faik Konica.
Thellimet për kërkime në këtë temë, nëse deri më sot nuk kanë dhënë rezultate spektakulare, së paku kanë krijuar vetëdijen mbi trashëgiminë kulturore e letrare, që në forma të ndryshme, qoftë paraletrare, popullojnë shekujt deri në kohët e mugëta. Këto kanë të bëjnë me nënshtresimet apo mbishtresimet kulturore në tokën ku priten Lindja e Perëndimi. Në kakofoninë e Marrjeve e të Dhënieve, patjetër që janë të artikuluara qartë idetë që letërsia shqipe ushqehet nga trashëgimia vendëse e rajonale dhe nga arqipelagu syzheor e mitologjik antik i Homerit.
Letërsia shqipe në anën tjetër, po në nivelin syzheor, ashtu dhe strukturor, madje

të moralitetit do të mbështetet në kulturat e tri besimeve, që do të bëhen vendëse; krishtërimin katolik, krishtërimin ortodoks dhe islamin. Një topikë mbretërore e kësaj letërsie kap më vete Jerusalemin, Qerbelanë e Romën. Shkrimtari e dijetari Ernes Koliqi madje tre shkrimtarët e mëdhenj të letërsisë shqipe: De Radën, Naimin e Fishtën, i sheh të lidhur përgjithnjë me shtresimet kulturore e letrare gjegjëse.



Është punë tjetër kur diskutohet çështja e autencitetit. Atëherë sekush bëhet i rreptë në mënyrën e vet: Konica niset ta përmbysë levantinizmin shqiptar, Fishta trenohet krejt nga dhënia që në Shqipëri ka qytete të tëra levantine, kurse Krist Maloki, në këtë pikë më licidi, levantinizmin e sheh si gjendje shpirtërore e shoqërore e jo si anë të horizontit.

Po të gjithë e dinë që thelbi autentik është i gjallë se ndryshe do të shkonim në asimilim.

3.

Ideja për qaqet letrare të letërsisë shqipe, njëherë të hetuara si parakombëtare, mandej të trajtuara si ahistorike, duket të jenë shumë më substanciale, duke pasë prekur pikërisht strukturat letrare. Jo vetëm në kuptimin sa një ambient i veçantë kulturor a shoqëror kushtëzon format letrare, por edhe në nivelin si ndodhin ndryshimet e formave letrare mbrenda sistemit. Çështja ishte hapur moti, por ajo është e gjallë edhe tani dhe ka të bëjë me komunikimin përgjithësisht dhe me komunikimin letrar.

Kurrë nuk ka pasur një komunikim të hapur letrar në gjithë arealin shqiptar. Arsyet mund të jenë, në varshmëri nga kohët: herë gjeografike, herë kulturore, herë ideologjike e madje politike. Kjo vështirësi e komunikimit natyrisht ka pasojat e veta në strukturat letrare, si në kohërat parakombëtare ashtu më vonë. Problemet janë edhe në nivelin e gjuhës, të shprehjes. Kjo letërsi është shkruar në tri dialekte, që nëse nuk janë çështje për lexuesit e kulturuar, të letrarizuar, atëherë janë probleme që nuk zgjidhen lehtë nga lexuesi i rëndomtë.

Çështjet kanë prekur edhe sistemin e madh të letërsisë, atë që është ndërkomunikim letrar, madje ndërmejt të krijuesve. Preokupimin tonë mund ta shtrojmë këtu vetëm në trajtë të pyetjeve: Cilët romantikë tanë të midhenj e njihnin letërsinë e Pjetër Bogdanit; A e njihte Naimi krijimtarinë letrare të De Radës; Cilët nga krijuesit e mëvonshëm e shijuan në origjinalin arbërisht qoftë De Radën, qoftë Seremben?

4.

Letërsinë shqipe, si kudo, e kanë shkruar individët, qofshin këta të pagëzuar urtakë apo kokëkrisur, por edhe misionarët e ideve të mëdha. Prandaj, kjo letërsi me vështërsi të mëdha është ndarë nga idetë dominante ose kolektive për të kaluar në nivelin e ideve individuale e të stileve të veçanta.

Nis me idenë kolektive a universale të krishtërimit, dhe duke qenë autorët e parë edhe vetë misionarë, është domosdo që kjo letërsi të zotërohet qoftë nga idetë themelore, qoftë nga suzhetë madje edhe stili dominant i rrafshuar për t'u bërë letërsi shqipe filobiblike. Rriskat e ideve kombëtare apo figurimi gjuhësor nuk janë veçse plasje në sistem.

Vijimi me letërsinë nacionale romantike është vetëm bartje te ideja tjetër e madhe kolektive, ideja nacionale. Kjo ka bërë forcimin e idesë dominante dhe stilin e rrafshuar të epokës në një anë dhe afrimin e misionit nacional në idenë, strukturën e domethënien e letërsisë. Këtu hyn një normë e pashpallur letrare: mitizmi e himnizmi. Himnizohet e lavdohet atdheu e heroi (Shqipëria e Skënderbeu), posi në herën e parë Krishtërimi e Krishti.

Stuhia e modelit kritik (kundër modelit himnizues pararendës) e Faik Konicës do të prodhojë ndryshime të mëdha në letërsinë shqipe, për të kaluar në modernitet. Kjo është shkallë kur tretet ideja kolektive në dobi të ideve individuale dhe kur vlera letrare përfundimisht përcaktohet nga individualiteti nga stilet e veçanta, që nuk mund të quhen stil i epokës. Janë këtu Lasgushi e Koliqi, Kuteli e Migjeni.

Kthimi i idesë kolektive, tanimë si ideologji sociale apo politike në letërsi, letërsia si shërbëtore e idesë bashkë me rrafshimin e stilit, është avantura e funtme në letërsinë shqipe, e panatyrshme, prandaj me dhembje e humbje të mëdha.

5.

Nëse kërkojmë një mbështetje, një referencë autentike të letërsisë shqipe (si dhunti e thesar të vetëvetes), atëherë dalin përpara gjithnjë si evidenca të pakapërcyeshme: *Historia* e Barletit, *Kangët e Kreshnikëve* dhe *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Këto referenca të mëdha të jetës sociale e nacionale të shqiptarëve kanë pasur lakimet më të llojllojshme te autorë e te vepra të kohëve e të brezave të ndryshëm.

Kangët e Kreshnikëve kanë përcaktuar përgjithnjë një universum letrar ku jeta shtrihet përtej kufijve të reales, ku fantazia njerëzore lulëzon duke prodhuar situata të ëndërruara dhe ku gjuha e shprehja ikin nga kufijtë e përditshmërisë për të prodhuar mite e mitologji, figura e metafora për të pushuar gjithnjë në krah të hiperbolës.

Te *Historia* e Barletit është krijuar përgjithnjë model i heroit (madje heroit nacional) bashkë me shkrimin që provon identitetin nëpër lavdërime e fitore dhe këtij modeli tematik e stilistik s'i ka shpëtuar askush nga shqiptarët që është nisur në pyllin e literaturës për të gjetur yllin e identifikimit nacional të afishuar. Heroika barletiane e ka përcaktuar heroikën letrare shqipe.

Nga ana tjetër *Kanuni i Lekës*, duke qenë prodhim i parë i empirisë e jetës sociale, njëherësh i kodifikuar si të folur që del nga situata përgjithnjë ka krijuar përmasat e moralitetit autentik të letërsisë shqipe që del nga kjo jetë. Formulësimet si elipsa apo si alegori të shprehjes së *Kanunit* kanë mbetur si modele shkrimore, që edhe pse të derivuara në vepra të sojeve të ndryshme, mund të identifikohen lehtë nga lexuesi shqiptar. Kjo është trashëgimia e barazimit fatal të gjuhës me veprimin.

6.

Letërsia shqipe, në vështrimin e zhvillimit e të komunikimit universal, si dhe letërsitë e tjera kalon nëpër tri shkallët, që po i quaj: 1. Letërsi në shkallën Zero, 2. Letërsi në shkallën e parë dhe 3. Letërsi në shkallën e dytë. Këto shkallë të letërsisë janë karakterizuese e jo vlerësusese, prandaj janë njësoj të larguara nga qendra dhe duhet të vendosen në rreth e jo në rrafsh. Shkallët e letërsisë nuk përfaqësojnë shkallë të zhvillimit: ato nuk lidhen me stile të epokave; me mosha të krijuesit; as me kultura të veçanta.

Shkalla Zero e letërsisë (termi është analog me të Rolan Bartit: shkalla Zero e shkrimit) karakterizohet nga *imitimi* (mimesis). Paramodeli i saj është në Natyrë e në Jetë, shkrimi i saj don ta përkthejë këtë model në modelin letrar. Mënyra e

imitimit bazohet në krahasim e në vërtetdukshmëri. Suksesi i saj matet me mundësinë që t'i afrohet modelit. E karakterizon gjuha e dëftimit, format e shkrimit i afrohen të të folurit, që shpien kah shkrimi veridik e aseriv. Qëllimi i saj është njohja. Me kontratën e vet të pashpallur kjo letërsi jep Vendin e identifikuar, Ngjarjen të ndodhur e Kohën të shpallur, Personazhin të njohur. Shembuj në shqip: *Bardha e Temalit* e Pashko Vasës, *Lumi i vdekur* i Jakov Xoxës, *Malësorja* e Nazmi Rrahmanit.

Shkallën e parë të letërsisë e karakterizon *krijimi* (poiesis). Kjo letërsi nuk ka model paraprak. Shkrim i saj është njëherësh fakt, esencë e procedurë, që krijon modelin e parë, vetanak. E pushton subjektiviteti e fantazia e pakufizuar, nuk do t'i ngjajë askujt, prandaj e ngrit në vete kultin e autenticitetit e të origjinalitetit. Qëllim ka Vetënjohjen dhe zbuliminn e Esencës. Shkrimi i saj personal e pasional ngritet mbi trajta të reja, duke iu shmangur formulave idiomatike. E zotëron shkrimi që çrëndomëson, shikimi i parë i habitshëm, si i Adamit. Koha, Vendi, Ngjarja, Personazhi janë të krijuara e të figuruara. Kjo letërsi ka një kontratë të pashpallur me vetëveten. Shembuj: *Kronikë në gur* e Ismail Kadaresë, *Oh* e Anton Pashkut, *Sheshi i unazës* e Zejnullah Rrahmanit.

Shkalla e dytë e letërsisë karakterizohet nga *rikrijimi* (metapoiesis). Ajo njeh modelet e përparshme, që janë modele të letërsisë. Përpiqet të rikrijojë modelet

duke i transformuar nëpër sprova. Shkrimi i ri mbi shkrimin e vjetër. Një *palimpsest* (të përdorim termin homolog të Zherar Zhenetit). Kjo letërsi kërkon metoda e procedura dhe paragjykon një njohje të madhe letrare. Dija e lidhur më tepër me kohët moderne, por jo: Homeri rikrijon mite poashtu si Xhojsi rikrijon tekstin e Homerit. Shembuj në letërsinë shqipe: Mitrush Kuteli, *Tat Tanushi*, Anton Pashku, *Nën qarr po rrinte vasha*, Ismail Kadare, *Prilli i thyer, Kush e solli Doruntinën.*

Shembuj përkujtues po sillen nga proza, si zhanër referencial, për të provuar shkallët e procedurave letrare. Në anën tjetër nuk po përmendim shembuj nga poezia, e cila është personale e universale duke i ikur referencialitetit, ashtu si dhe shembuj nga dramatika e cila e mban më vete iluzionin e imitimit total të modelit jetësor.

7.

Tani le ta kujtojmë rishtas Çabejnë e fillimit, me dy evidencat e tij për letërsinë shqipe, të cilat, mirë apo keq, dolën edhe si parashikime.

Letërsia e shkruar shqipe kurrë, as sot, nuk është liruar nga ndikimi i madh i letërsisë gojore. Ky ndikim ka rrokur shprehjen e saj, shumëherë subjektet, madje edhe mënyrën e strukturimit më të thellë letrar. Kjo ngjet edhe pse në shqip letërsia gojore në gjithë shekullin e kaluar ishte e gjallë e produktive përballë letërsisë së shkruar.

Në anën tjetër ky model i letërsisë popullore i rimarrë me variante në letërsinë e shkruar, në një pikë më të largët ka prekur gjithë ligjërimin letrar duke e shpënë në teh kah *ligjërimi legjendar. Legjenda e hiperbola* sikur bëhen shenja dalluese jo vetëm të literatures, po edhe të kulturës shqipe. Diçka që rri në teh, pak si larg reales. Dhe këtu duket pak si i lehtë kapërcimi nga fakticiteti në fiksion.

Në anën tjetër, problemet e thella sociale e nacionale, por edhe politike që i përcjellin shqiptarët edhe në shekullin 20 të modernitetit, nuk kanë mundur të mos e përshkojnë letërsinë duke nisur nga tematikat deri te strukturat. Ky fenomen e ka tundur letërsinë nga shenja dalluese *meditans* kah shenja dalluese *militans*, siç i tha në kushtesen e vet Lasgush Poradeci Gjergj Fishtës, kur shkoi ta takonte në Shkodër më 1938.

Po shihet që gjërat shpirtërore janë kaq të lidhura në jetë e në letërsi.

Furtunat që rrokën botën shqiptare në decenien e fundit në shekullin 20 duke rrëzuar totalitarizmin në Shqipëri dhe duke e çliruar Kosovën nuk kanë si nuk ndikojnë në letërsi dhe në ligjërimin e saj. Së paku do të shtrohet çështja e mënyrës tjetër të komunikimit me të dhe brenda saj. Dhe kjo vetvetiu shtron

pyetjet: a do të vijohet me legjendën e hiperbolën e fiksionalitetin; a do të zotërojë diskursi i ri që do të mbështetet në të dhënën empirike, në përvojën e rëndë? A janë ndalur krismat dhe a janë zgjuar muzat nga gjumi?

Në ndërkohë rikujtoi përvuejtninë e Pjetër Bogdanit, Fantazitë e De Radës, Shkrirjen e Naim Frashërit, kursimet e fjalës së Ndre Mjedës, të gjitha tërmetet shpirtërore të Gjergj Fishtës, përmallimet e mbrendshme të Lasgush Poradecit dhe njat asketizëm letrar të Anton Pashkut.

Unë nuk dua të parashoh asgjë, aq më pak të paragjykoj, këtë nuk do të ma lejonte të menduarit racional, që në të vërtet e do sprovën dhe dyshimin.

Vetëm mund të artikuloj një pyetje në vend të përfundimit: Athua do të jetë letërsia shqipe edhe në të ardhmen letërsi e rrethanave e letërsi qëllimore?

9 prill 2003

Dr. Musa Ahmeti

Dorëshkrime dhe informacione shkencore me vlerë të veçantë nga fusha e albanologjisë

Studiues të shumtë nga shtete të ndryshme, të specializuar dhe të profilizuar në fusha të ndyshme, janë marrë me studimet për origjinën, kulturën, traditën, gjuhën, religjionin dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me shqiptarët dhe trojet e tyre etnike.

Thellësia dhe serioziteti i këtyre studimeve, në disa raste, edhe sot e kësaj dite është i patejkaluar dhe një nga pikat më të prefuara në fushën e albanologjisë, burimologjisë dhe historisë kombëtare shqiptare. Debatet e shumta të mirëfillta me bazë shkencore, botimet e korpuseve të dokumenteve, analizat studimore dhe librat e shumtë, të botuar që nga zbulimi i shtypëshkronjës së Gutenbergut e deri sot, janë një nga dëshmitë më të forta, për një interes të veçantë që kishin të huajt, për popullin shqiptar, fatin dhe rolin e tij gjatë furtunës shekullore mesjetare, por edhe gjatë zhvillimeve të vrullshme të rilindjes dhe iluminizmit evropian dhe atij shqiptar.

Nuk mbeten asgjë prapa botimeve serioze dhe voluminoze as dorëshkrimet e shumta, të autorëve të ndryshëm apo ato anonime, që për temë bosht trajtimi kanë pasur popullin shqiptar dhe trojet e tij etnike. Zbulimet e këtyre

dorëshkrimeve, janë një thesar i vërtetë ngase pasurojnë shumë herë zbraztësitë e krijuara në epoka të caktuara kohore ose plotësojnë e saktësojnë njohuritë që kemi deri tashi për ngjarje, personalitete dhe data të rëndësishme historike.

Kur flitet për traditën e shkrimit të gjuhës shqipe dhe lashtësinë historike të burimit të fjalës së shkruar shqipe, zbulimi i çdo materiali të ri që ka arritur t'u shpëtojë rrebesheve të kohës, sado i vogël që të jetë, ka një rëndësi të veçantë, për të kaluarën kulturore dhe historike të kombit tonë, ngase na mundëson që të krijojmë njohje të reja, për shkrimin e gjuhës së tij dhe ruajtjen e traditës shumëshekullore, edhe gjatë kohërave të vështira të së kaluarës historike.

Në një hapësirë ku vërtetohet se shkolla e shkruesve vendës, qoftë të traditës helene, qoftë të traditës latine, ka një të shkuar të largët, *konteksti kulturor për shkrime të hershme edhe në gjuhën amtare jo vetëm që ekziston, por është inkurajues*. Nëse në mjedisin shqiptar të periudhës prej paleokrishtërimit deri në Rilindjen Evropiane kishte traditë të shkrimit në përgjithësi, siç provohet prej tipologjisë së dorëshkrimeve kishtare, [kodikëve] ky është një fakt që favorizon edhe besueshmërinë e një tradite të shkrimit në gjuhën shqipe.[4]

I. Dorëshkrimi shqip i Teodor Shkodranit nga viti 1210

Pas një pune studiuese dhe hulumtuese disavjeçare, kemi pasur fatin e mirë të kishim në dorë, një dorëshkrim të lidhur me kopertina të forta druri, nga viti 1210, titulli i të cilit në regjistrat e Vatikanit nuk ishte i shënuar komplet dhe në formën origjinale. Shfletimi i kujdesshëm, që nga faqja e parë, ishte shenjë se teksti nuk ishte në gjuhën latine, greke, sllave, arabe, hebreje apo ndonjë gjuhë tjetër, por ishte i tëri në gjuhën shqipe.

Vëllimi i tëri është në pergamen, gjë e zakonshme për kohën kur ishte shkruar. Përbëhet nga 208 fletë të shkruara dhe 12 të tjera të zbrazëta. Paginimi [numërimi] i fletëve është vetëm *recto*, dmth. është shkruar vetëm në njërën anë të fletës, atë të djathtë.

Fletët kanë rreshta të njëjtë, çdonjëra nga 43, pos fillimit të kapitujve, ku çdo faqe ka nga 28 rreshta, ndërsa kur përfundon kapitulli, faqja ka nga 31 rreshta.

Dimensionet e dorëshkrimit në pergamen janë: 28 x 39.5 cm; ndërsa kopertinat

---

4 Shaban Sinani, *Në hapësirën shqiptare ka ekzistuar një shkollë shkruesish qysh prej paleokrishtërimit. [Pjesë nga debati mbi dorëshkrimin e hershëm në gjuhën shqipe të Teodor Shkodranit, zbuluar në Arkivin Sekret të Vatikanit, nga dr. Musa Ahmeti*. Identiteti. Prishtinë. Viti I, 27 nëntor 2002, nr. 4, f. 18-19.

janë diçka më të mëdha dhe kanë dimensione: 29.5 x 42 cm.

Komplet vëllimi, është i ruajtur shumë mirë, nuk ka fare dëmtime, pos që në disa vende ka filluar të fshihet ngjyra dhe kjo në fletët 188, 189 dhe 192. I gjithë dorëshkrimi është i shkruar me grafema [littera-shkronja] latine; pos për tre grafema të shqipes janë përdorur grafemat greke, për shkronjat: "dh" "th" dhe "y"; në dialektin e veriut, që si i tillë paraqet mjaft vështirësi për t'u lexuar.

Në fillim të çdo kapitulli, por edhe në disa vende brenda dorëshkrimit, kur fillon një ngjarje e re apo e rëndësishme, ka iniciale të cilat janë shumë të bukura.

Tre inicialet e fillimit, të tre pjesëve [kapitujve] janë të praruara me flori. Inicialet tjera janë me ngjyrë të kuqe, pjesa dërmuese, ndërsa dy janë me ngjyrë blu të hapur. Në dorëshkrim ka edhe tre miniatura kryesisht të punuara nga floriri të cilat paraqesin momente biblike, të cilat janë shumë të bukura si për nga dekorimet, puna mjeshtërore dhe artistike, por edhe nga porosia logjike që paraqesin.

I gjithë dorëshkrimi është autograf, i shkruar nga një dorë. Ndërsa në fund fare, në f. 208, autori është firmosur vetë me emrin e tij: Teodor Shkodrani, duke shënuar: "**Me ndihmën dhe dëshirën e fort të lumturit Zot, përfundova në vitin 1210, ditën e 9 të marsit -:- Teodor Shkodrani"**. [*"Mee nihemmen ??e dessirnnee e phortee t'Lummnumittee ?OT – e mbaronjj n'vittee MCCX – ditnee e ix - t'Marxxittee. -:- Theoodor Scodraanitee"*].[5]

Dorëshkrimi ndahet në tre kapituj, në f. 1^{r} – 97^{r} mbi *teologjinë*; f. 98^{r} – 146^{r} mbi *filozofinë* dhe 147^{r} – 208^{r} mbi *historinë*. Secili nga kapitujt mund të jetë edhe libër në vete. Duke mos mohuar vlerën dhe rëndësinë e dy kapitujve të parë, kapitulli i tretë ka tërhequr më shumë vëmendjen tonë ngase pos të dhënave me interes të veçantë, autori citon edhe vepra të tjera që ka konsultuar dhe më shumë se një herë, thirret në kronikat shqiptare të qyteteve të ndryshme. Ngjarjet kronologjikisht renditen deri në dhjetorin e viti 1209, dëshmi kjo e fortë për të përforcuar edhe më shumë vitin e përfundimit të dorëshkrimit.

Është e sigurt se ky dorëshkrim nuk është përshkrim apo kopje e ruajtur. Mendime të vlerëshme për një gjë të tillë kanë dhënë shumë specialistë, por dorëshkrimi ka kaluar edhe në disa prova të tjera për vlerësim të vjetërsisë, duke analizuar ngjyrën, shkronjat, inicialet dhe miniaturat, pastaj ngjarjet historike, por edhe emrat e disa autorëve apo prelatëve kishtarë që përmend autori, për të cilët ruhen të dhëna biografike në Arkivin Sekret të Vatikanit dhe në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit.

Pas një pune disavjeçare, kemi arritur të bëjmë transkriptimin dhe transliterimin e dorëshkrimit. Ishte kjo një punë shumë e mundimshme, ngase ne nuk kishim tekste [dokumente apo dorëshkrime] të ngjashme nga kjo kohë apo kohë më e afërt, për të konsultuar e krahasuar: grafemat, fjalët, fjalitë dhe strukturën e përgjithshme gramatikore. Jemi të vetëdijshëm se mund të ketë lëshime, por mbetet që specialistët e fushave përkatëse, pas studimeve të tyre, të nxjerrin përfundimet e duhura shkencore.

Pra, nëse e shikojmë kronologjikisht, që nga viti 1284, kur për herë të parë përmendet gjuha shqipe, dorëshkrimi i Teodor Shkodranit, e shtyn edhe për 74 vjet më herët jo vetëm përmendjen e gjuhës, por edhe e dëshmon se shqipja ishte e shkruar; ndërsa kur bëhet fjalë për dokumente të shkruara, siç është "Formula e pagëzimit" nga viti 1462, ky dorëshkrim është më i hershëm për 252 vjet, dhe më i hershëm se "Meshari" i Buzukut për 345 vjet.

Dihet se të shkruarit e një gjuhe nuk varet nga dëshirat e këtij apo atij autori, por nga rrethanat historike dhe kulturore në të cilat ajo gjuhë përdoret. Vetë të shkruarit është një lloj komunikimi, ndoshta jo i drejtpërdrejtë, por i destinuar për një

[5] Për herë të parë informacioni për këtë dorëshkrim është botuar në revistën: "Ekskluzive", Dr. Musa Ahmeti, *Dorëshkrimi shqip i Teodor Shkodranit nga viti 1210*. Ekskluzive, 2002, tetor, nr. 30, f. 88-91.

publik të shtrirë më tej në hapësirë e në kohë; kjo edhe ngaqë një vepër e shkruar nuk mund të përligjet, qenësisht, veçse nga lexuesi.

Shpesh të shkruarit e një gjuhe nuk është pa lidhje edhe me përvijimin e një vetëdijeje të komunitetit si shtrat i një kulture a qytetërimi të caktuar, për të mos thënë feje, prandaj edhe gjuhë të ndryshme të Evropës dokumentohen me shkrim në periudha historike të ndryshme.

Autorët që kanë studiuar "Mesharin" e Buzukut, si Petrotta, Resuli, Camaj dhe Çabej, kanë vënë re se zgjidhjet e grafemave të atij shkrimtari janë aq konsekuente sa të lënë shteg të mendohet për një traditë të shkrimit të shqipes, të mëhershme, edhe pse Buzuku vetë e thekson se është i pari që po merret me të shkruarit e kësaj gjuhe, ndërkohë të tjerë studiues kanë vënë re ngjashmëri, po në trajtimin e grafemave të tingujve të shqipes, midis teksteve të autorëve të Veriut nga njëra anë, dhe autorëve të hershëm arbëreshë, nga ana tjetër. Prandaj edhe albanologët në përgjithësi nuk e kanë përjashtuar mundësinë që shqipja të ketë qenë shkruar përpara Buzukut, në periudhën paraosmane.

Mirëpo, dorëshkrimi i Teodor Shkodranit, vështirë se mund të gjejë vend brenda kësaj paradigme; përkundrazi, ky dorëshkrim e bën të domosdoshëm një rivështrim rrënjësor jo vetëm të historisë së shkrimit e të kulturës shqiptare, por edhe të asaj ballkanike e më gjerë; si dhe të dinamikës së ndërveprimit të kulturave të tjera ndaj latinishtes në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë në Evropë; sepse, kjo traditë është përfytyruar gjithnjë si në trajtë tekstesh relativisht të shkurtra e të shkëputura, ose këngësh religjioze e folklorike, prokurash tregëtare; por jo në trajtë librash, dorëshkrimesh dyqindfaqëshe sikur që është dorëshkrimi i Teodor Shkodranit.

II. Disa toponime në gjuhën shqipe nga viti 1407 që ruhen në ASV

Kolegia dhe studiuesja shqiptare mr. sc. Etleva Lala[6] e cila po bën studime në ASV, na ka dërguar një dokument, nga viti 1407[7], ku gjejmë disa toponime në gjuhën shqipe.[8]

Dokumenti i datës 23 maj 1407, ka 35 rreshta dhe në të papa Gregori XII (1406-1415) i është drejtuar kryeipeshkvit të Tivarit. Emri i kryeipeshkvit nuk është dhënë, por nga Eubel[9] mund të mësojmë që quhej Martinus de Dulcigno, [Martini nga Ulqini] dhe shërbeu si kryeipeshkv i Tivarit nga viti 1395 deri në vitin 1420.

Ky dokument duket se është përgjigje e një suplike që i është bërë papës nga Gjergji, ipeshkvi i Arbanisë, (*quare pro p[ar]te eiusdem Georgij ep[iscop]i nobis fuit humiliter supplicatum ut sibi super hoc providere paterna diligentia curaremus.*),[10] por regjistrat e suplikave të kësaj periudhe kanë humbur gjatë transportit të arkivit nga Napoleoni.

Në këtë dokument bëhet fjalë për një mosmarrëveshje midis ipeshkvit të Arbërisë dhe ipeshkvit të Lezhës, dhe konkretisht për suffraganitë e Shën Premtes së Balldrenit, Shën Nikollës në Blinisht, Shën Salvadorit në Majëmali, Shën Gjonit në Bregdet, Shën Eufemisë në Kallmet, Shën Premtes dhe Shën Salvadorit në Vello, Shën Gjergjit në Sito, Shën Vlashit në Solomundo, Shën Dhimitrit të Spanit, Shën Aleksandrit të Bokës, Shën Nikollës në Soimo, Shën Barbarës në Pedana, Shën Venerës në Re, Shën Marisë në Soesa, Shën Mikelit në Kastineto dhe Shën Helisë në Guimal, të cilat i janë marrë pa të drejtë ipeshkvisë së Arbërisë nga Ndreu, ipeshkvi i Lezhës. Ipeshkvi i Arbërisë kërkon ndihmën e papës për këtë çështje dhe papa ngarkon kryeipeshkvin e Tivarit që të vendosë drejtësi.

III. Katekizmi në gjuhën shqipe nga viti 1584

Studiuesi, historiani dhe teologu i njohur kroat, Miroslav Vanino [D. I], në një studim të tij me titull: *Aleksandar Komuloviq /1548-1608/*[11], na ofron një

6 Etleva Lala, *Biblioteka Apostolike e Vatikanit dhe dokumenti papnor me onomastike arbënore*. Ekskluzive. Prishttnë, 2003, maj, nr. 37, f. 81-85

7 Dokumenti ruhet në: Arkivin Sekret të Vatikanit në fondin: *Regjistri Laterani,* vëll. 128, f. 159^{v}-160^{r} [olim, 158^{v}-159^{r}].

8 E. Lala, *Biblioteka Apostolike...,* f. 84-85.

9 Conrad Eubel, *Hierarchia Catholica medii aevi sive summorum Porntificum, S. R..E.Cardinalium, Ecclesiarum antistitum*. [Sumptibus et typis, Librariae Regensbergianae]. Monasterii. 1901.

10 ASV. Reg. Lat. V. 128, f. 159; E. Lala, *Biblioteka Apostolike...,* f. 84.

11 Miroslav Vanino, *Aleksandar Komulovi? (1548.-1608.)*. /Hrvatsko kulturno društvo «Napredak». Sarajevo/. [«Nova Tiskara»Vr?ek i dr.]. Sarajevë, 1935, f. 44. Shiko edhe: Musa Ahmeti "*Dorëshkrime dhe informacione shkencore me vlerë të veçantë nga fusha e Albanologjisë*". Ekskluzive. Prishtinë, 2003, mars, nr. 35, f. 97-99.

infromacion shumë të rëndësishëm për shkencën e albanologjisë kur pohon: "*Në vitin 1584, A. Komuloviqi së bashku me rektorin e Kolegjit Ilirk të Loretos, Tomë Ragjen, kishte urdhëruar: shtypjen e 500 /pesëqind/ katekizmave në gjuhën shqipe, të cilat i mori me vete dhe i shpërndau gjatë udhëtimit apostolik që bëri po në këtë vit [1584] në Shqipëri, i shoqëruar edhe nga* prifti *shqiptar*, Amano Duka, *një nxënës i Kolegjit Ilirik të Loretos dhe një* shqiptar i shkolluar."[12] Kjo e dhënë është informata e parë që kemi deri tash se ka ekzistuar dhe është shpërndarë një katekizëm i tillë në gjuhën shqipe, 29 vjet pas "*Mesharit*" të Gjon Buzukut [1555] dhe 8 vjet para veprës së Lekë Matrangës *"E Mbsuame e Chraestere"* [1592]. Vetë sasia e madhe e katekizmit, lë shumë mundësi për një gjykim se kush dhe cilët ishin ata persona që lexonin në gjuhën shqipe në shekullin XVI.

Me këtë mund të nënkuptojmë se kishim, tashmë në këtë kohë, një shtresë të mirëfilltë intelektualësh që lexonin dhe shkruan shqip, përndryshe, Komuloviq, nuk kishte asnjë arsye që të sillte një numër kaq të madh të këtij libri me vehte. Ne kemi konsultuar studiues dhe njohës të shkëlqyer të kësaj fushe, si p.sh. akademik Dhimitër Shuteriqin, dr. Moikom Zeqon, dr. Shaban Sinanin, dr. Sali Bashotën, dr. Aleksandar Stipçeviqin, dr. Françesk Altimarin, dr. Matteo Mandala, dr. Robert Elsie... etj, dhe asnjëri nga këta nuk kishte ndonjë njohuri për ekzistencën e një katekizmi të tillë nga ky vit. Për këtë informacion që kemi nga M. Vaninon, kanë shkruar ose botuar dokumente, por pa e theksuar këtë moment edhe studiuesit Franjo Raçki dhe O. Pirling,[13] pastaj O. Pirling[14], Euzebije Fermexhin[15], etj. Këta, autorët e fundit, shënojnë edhe vendndodhjen e shumë dokumenteve dhe relacioneve që kanë të bëjnë për shqiptarët dhe Shqipërinë e që ruhen në Arkivin Sekret të Vatikanit dhe në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit.

Ne kemi bërë kërkime në Biblioteken Apostolike te Vatikanit, por edhe në bibioteka dhe arkiva të tjerë dhe deri me sot, nuk kemi arritur të gjejmë asnjë exemplar të origjnalit. Por, në Biblioteken Apostolike te Vatikanit, kemi zbuluar një numër të konsiderueshëm dokumetesh të pabotuara, që ruhen në disa fonde[16], të cilat hedhin dritë mbi këtë katekizëm si dhe mbi vizitën apostolike të Komuloviqit nëpër Shqipëri.

Lidhur me katekizmin e vitit 1584, është edhe një e dhënë e tërthortë, por mjaft interesante. Kjo ka të bëjë me emrin e Tomë Ragjes.[17] Në fund të dorëshkrimit[18] të tretë të veprës së Lekë Matrangës, që ruhet në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit Tomë Ragja është personi i cili e aprovon botimin e veprës: "E mbësueme e kërshterë". Pos kësaj, nga studimi që i kemi bërë origjinalit, kemi vërejtur se dallohet shumë qartë, se T. Ragja ka bërë edhe korrekturë dhe ndërhyrje në tekstin e dorëshkrimit të tretë, duke bërë edhe paginim tjetër të faqeve nga numër 1 deri numër 15, që i korrespodon paginimit 73-87. Sipas kësaj, mendojmë se katekizmi i vitit 1584, edhe pse më i ri se vepra e Lekë Matrangës për 8 vjet, ka një vazhdimësi logjike, të paktën në personin e Tomë Ragjës[19].

12 M. Vanino, *Aleksandar Komulov?...* f. 44; M. Ahmeti, *Dorëshkrime...*, f. 99.

13 Franjo Ra?ki – O. Pierling, *L. Komulovi?a izvještaj i listovi o poslanstvu njegovu u Tursku, Erdelj, Moldavsku i Poljsku*. Starine. [Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti]. Zagreb. 1882, lib. XIV, f. 83-124.

14 O. Pirling, *Novi izvori o L. Komulovi?u*. Starine. [Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti]. Zagreb. 1884, lib. XVI, f. 209-251.

15 Eusebije Fermend□in, *Prilozi k poznavanju diplomatskoga poslanstva Alesandra Komulovi?a medju Slovene od godine 159. do 1597*. Starine. [Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti]. Zagreb. 1918, lib. XXXVI, f. 7-30.

16 Në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, sektori i dorëshkrimeve, në këto fonde ka të dhëna për katekizmin e vitit 1584: Archivio Borghese, ser. III, nr. 5, vëll. 124; Barberini Latini, 8479; Barberini Latini, LVIII, vëll. 33; Casanatese Cod. Mss. X, vëll. 6; Codex Ottobanianus, 1941, vëll. I dhe II.

17 Sipas Matteo Mandales, prof. Carmelo Capizzi shkruan: "gi? nel 1584, il primo rettore del Collegio Illirico, P. Tommaso Raggio, preparandosi alla visita apostolica dell'Albania e di altri Paesi balcanici, insieme col suo compagno, il canonico Comuleo, aveva proposto che si traducesse un catechismo in albanese. Tale proposta non cadde nel vuoto. Nel 1592, l'italo-albanese Luca Matranga, alunno del Collegio Greco, tradusse in albanese il ca-techismo (Dottrina cristiana breve) del gesuita spagnolo Giacomo Ledesma (+ 1575)."

18 Tri dorëshkrimet e veprës së Lekë Matrangës "*E mbësueme e kërshterë*" ruhen në sektorin e dorëshkrime të BAV-it, me signaturë: Mss. Barb. Lat. 3454.

19 Një mendim tjetër ka një studiues arbëresh, prof. Matteo Mandala, i cili na shkruan: "*Edhe unë jam i bindur se Ragius ndërhyri në tekstin e Matrangës, por ndryshe nga mendimi juaj, ai redaktoi tekstin e dytë (drsh. B), ndërsa korrigjoi variantin e tretë (drsh. C), të cilin e kishte shkruar materialisht një kopistë tjetër dhe që më vonë u dorëzua në shtyp. Ka shumë të dhëna filologjike që vërtetojnë këtë. Për atë që ju mendoni për numërimin në drsh. C, kam këtë mendim: 1) numërimi i parë që lexohet në krye të faqeve është i pari që u bë sipas tekstit në dorëshkrim për t'i shërbyer tipografit në fazën e shtypit; 2) kur në tipografi morën vesh që radhitja nuk ishte e përshtatshme, u bë një numërim tjetër që lexohet në mes të faqeve, duke qenë i shënuar me një dorë tjetër. Ky numërim i fundit është ai që del edhe në kopjen e ekzemplarit të shtypur*."

IV. "Çeta e Profetëve" – Dorëshkrimi nga viti 1675

Dorëshkrimi i "*Çetës së Profetëve*" [*Cunueus Prophetarum*] i Pjetër Bogdanit, nga viti 1675,[20] ruhet në një nga Arkivat e Dubrovnikut. Bogdani, kur kishte udhëtuar për në Romë, për të shtypur librin e tij, kishte lënë një kopje të dorëshkrimit që të ruhej në Dubrovnik, ndërsa kopjen tjetër e kishte marrë me vehte. Na janë të njohura peripecitë dhe pengesat që i dolën Bogdanit për të shtypur librin.

E veçanta e këtij dorëshkrimi, që është autograf, është, se ai paraqet komplet veprën "*Çeta e Profetëve*" variantin e pashkurtuar dhe të pacenzuruar, i cili është botuar.

Gjatë një krahasimi që i kemi bërë dorëshkrimit autograf me librin e botuar, kemi vërejtur dallime të theksuara. Mendojmë se ka rreth 35-40% tekst më shumë dorëshkrimi se sa libri i botuar, duke shtuar se hyrja e dorëshkrimit është krejt tjetër nga ajo e cila është botuar.

Njoftimin e parë për ekzistencën e këtij dorëshkrimi e kemi nga Nikolla Çollak,[21] studiues me origjinë nga Janjeva e Kosovës, i cili në vitin 1941, e kishte studiuar këtë dorëshkrim.

V. Fjalor i shprehjeve të terminologjisë detare nga viti 1693

20 Ibrahim Rugova, *Vepra e Bogdanit*. 1675-1685. *Cuneus Prophetarum*. Tiranë, 1990, f. 45, "*del se vepra u paraqit më 1675";* pastaj, f. 46, 48... etj; Shefik Osmani, *Pjeter Bogdani*. Tiranë, 1996, f. 20, "*Në bazë të të dhënave të vetë P. Bogdanit njofrohemi se më 1675 ai kishte përfunduar së shkruari veprën"*; Engjell Sedaj, *Mbi veprën e P. Bogdanit dhe ndërtimin e e saj*. Në: Pjetër Bogdani, "*Çeta e profetëve*", vëll. I. Prishitnë 1990, f. 24, "*Historia e veprës... fillon... mbase nga data 25. VI. 1675"*; Zija Xholi, *Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë* kombëtare. Tiranë, 2003, f. 154, "*Veprën Bogdani e kishte mbaruar së shkruari dhe e kishte gati për botim më 1675*"; pak më ndryshe mendon: Odette Marquet, *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumete nga Arkivi i Kongregatës "de Propaganda Fide" si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*. Shkodër, 1997, f. 297, nr. i dok. 174, kur në regestin e dokumentit shkruan: *."ani do t'i përvishet punës për ta shkruar veprën"*.

21 Nikola ?olak, *Na ?emu smo s pisanjem povijesti Janjeva*. /Da se utvrdi istina/. «Zvono». Janjeva?ki godišnjak. [Udruga "Janjevo"]. Zagreb, 1997, f. 38: *"i një rëndësie të veçantë ishte dorëshkrim (autograf) i kryeipeshkvit të Shkupit, Pjetër Bogdanit, "*Cunueus Prophetarum de Salvatore mundi.*" Vepra është përfunduar në Janjevë në vitin 1685".*

Në vitin 2000, mr. Natasha Bajiq-Zharko, dr. Arsen Duplançiq dhe dr. Aleksandar Stipçeviq, më kanë tërhequr vërejtejn për ekzistencën e një dorëshkrimi në Split, më saktë, të një fjalori të shprehje dhe terminologji detare,[22] mjaft voluminoz, i pregatitur në gjuhët: shqipe,[23] greke, kroate, italiane dhe turke, me autor Julija Baloviqin.

Dorëshkrimi është përfunduar në vitin 1693[24]. Kjo gjë vërehet në fund të dorëshkrimit. Në hyrje të fjalorit, autori ka radhitur gjuhët dhe alfabetet e tyre. Autori Baloviq, që është me origjinë shqiptare,[25] nga Perasti, ka përdorur 24 grafema *latine*, një *sllave* dhe tri *greke* për fjalorin e tij. Dorëshkrimi është në gjendje shumë të mirë.

VI. Një fjali në gjuhen shqipe nga Arkivi i Propaganda Fide nga viti 1752

Në vazhdim do të flasim edhe për një dokument të zbuluar para disa kohësh,[26] i cili ruhet në dorëshkrim dhe është i pabotuar deri tashi, në të cilin ndodhet një fjali e shkruar shqip, me dorë, pra është autograf, nga prifti shqiptar Pal Zogaj,[27] më 20 shtator të vitit 1752.[28] Dokumenti është betimi i Pal Zogajt dhe përmban

22 Lirak Dodbiba, *Leksiku detar i shqipes dhe etnogjeneza e popullit tonë*. Studime Filolegjike. [Universiteti Shtetëror i Tiranës-Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë]. Tiranë, 1972, viti. XXVI (IX), nr. 4, f. 55-61.

23 Radoslav Tomi?, *Umetni?ke prilike u Perastu u 17. i 18 stolje?u*. Në: *Hrvatska pomorska obitelj Balovi? iz Perasta i njezin arhiv*. [Dr□avni Arhiv u Splitu]. Split, 1999, f. 5-10.

24 Vinko Malaj, *Petojezi?ni rije?nik brodskog škrivana Julija Balovi?a peraštanina iz 1693 godine*. Godišnjak Pomorskog Muzeja u Kotoru. 1993'1994, viti XLI-XLII.

25 Nataša Baji?-□arko, *Hrvatska pomorska obitelj Balovi? iz Perasta i njezin arhiv*. [Dr□avni Arhiv u Splitu]. Split, 1999.[26] Këtë dokumet, por edhe disa të tjera, në gjuhën shqipe, ju kemi huazuar disa kolegëve studiues shqiptar, por edhe të huaj, për studimet e tyre që kanë të bëjnë me albanologjinë.

27 Për priftin shqiptar, Pal Zogaj, në Arkivin e Propagandës Fide në Romë, ka njoftime të shumë dokumetare. Po sjellim vetëm disa nga fondet ku ruhen dokumentat që kanë të bëjnë me P. Zogaj: Archivium Collegi Urbani, [ACU]. Reg. VII, vëll. 1, f. 406; ASCPF, SC. Servia, vëll. 2, f. 47-48; 81-82; 147-148; vëll. 6, f. 195-196; ACU, Lib. I, f. 541; ASCPF, Acta, Albania, vëll. 90; 92; 98, ASCPF, CP. Vëll. 133, etj.

28 Ky dokument ruhet në arkivin e Propagandës Fide në Romë dhe mban signaturën: *Archivium Collegi Urbani, Giuramenti. Liber 1, f. 541[olim 327].*

këtë tekst: "Pal Zogaj, e kam shkrue me kanib ket be, jam prej Zogajve". [Ose në origjinal*: Paulus Sogagni, Ecam scrue mbe canib chet bee, jam prei Sogagni*].
Me këtë rast do të theksojmë se Pal Zogaj në vitin 1775 kishte shkruar një gramatikë në gjuhën shqipe.[29] Dorëshkrimi i gramatikës ka humbur, mirëpo ne gjejmë të dhëna për të në disa burime të tjera. Mbretëresha austro-hungareze, Maria Teresia, kishte dhënë lejën për botim. Dorëshkrimi i dorëzohet botuesit të oborrit mbretëror Trattner[30] nga Varazhdini. Por ne nuk kemi asnjë të dhënë nëse është botuar apo jo. Kemi të dhëna se grafemat e veçanta që kishte përdorur Pal Zogaj për gramatikën e tij, ishin marrë nga pesë tekstet shqipe të imzot Pal Skiroit nga viti 1767[31].

VII. Pesë tekste në gjuhën shqipe nga viti 1767

Gjatë hulumtive tona të bëra në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, kemi hasur në pesë tekste shqipe të botuara, por të panjohura deri tash në historinë e gjuhësisë shqiptare. Tekstet i takojnë shekullit XVIII. Në këtë shekull zgjerohen në mënyrë të theksuar përpjekjet për shkrimin e gjuhës shqipe, si dhe përkthimet e shumta, si në Shqipëri, e poashtu edhe në disaporën shqiptare.
Këtu në rend të parë duhen përmendur arbëreshët e Italisë, nga ku kanë dalë burra dhe personalite të nderuara të kulturës sonë kombëtare. Nga ky mes rrjedh edhe kryeipeshkvi arbëresh, Zef Skiroi. Kryeipeshkvi Zef Skiroi vazhdon traditën e gjatë që kishte qyteti i Durrësit, si qendër e rëndësishme kulturore-historike, politiko-shoqërore, por edhe si një nga qendrat më të lashta të krishtërimit në Shqipëri. Sipas të dhënave arkivore, nga arkivat e etërve Dominikanë në

29 Në vitin 1775 kërkon lejën për botimin e gramatikës së gjuhës shqipe, të cilën e kishte përgatitur sipas shebmbullit të gramtikës së Marija da Leçes: "*Osservazioni gramaticali della lingua albanese, Roma 1716.*" 20 shkurt 1923, viti, IV, nr. 42 (755), f. 2. Emil Laszowski, *Arbanasi (Klemendtinci) u Hrtkovcima i Nikincima, i Saganijeva gramatika arbanaškog jezika*. Në: "Hrvatski List". Osjek, 20 shkurt 1923, viti, IV, nr. 42 (755), f. 2; nr. 43, (756), f. 2 dhe nr. 44 (757), f. 2; shiko edhe HDA, Katalogu nr. 9, *Repertorium Consili Croatici 1775. Gramatica: Pauli Sogagni imprimendi. A. 218. oct. 62.*

30 Më 13 maj 1776, shtypëshkronjësi i oborrit mbretëror, Trattner, në formë të shkruar merr obligim se do të shtyp, në shytpëshkronjën e tij në Varazhdin, gramtikën në gjuhën shqipe të Zogajt, E. Laszowski, *vep. cit*... f, 2, nr. 44 (757).

31 Ipeshkvi greko-katolik, Basilje Bozhiçkoviq, tërheq vëmendjen për katër grafema të veçanta të gjuhës shqipe, të cilat i vë në një letër të veçantë dhe shenon se ato i kishte nxjerrë nga vepra e Papës Benedikti i XIV, vëll. 7, në f. 81, 121a, 143, 166 dhe 190. E. Laszowski, *vep. cit*... f, 2, nr. 44 (757).

Romë, Dubrovnik dhe Zarë, në qytetin e Durrësit, deri më 14 qershor të vitit 1396 ka qenë e hapur "*Qendra e studimeve të përgjithshme teologjike*", në kuadrin e së cilës ndodhej edhe dega e filozofisë. Këtë qendër e kishin hapur etërit e rregullit Domenikan. /Tashmë është mëse e njohur se etërit e dy rendeve, atij Benediktin dhe Dominikan, kudo që kanë shkuar kanë themeluar vatra kulture e shkrimi/. Pra, sipas dokumenteve, në vitet e fundit të veprimtarisë së saj "*Qendra e studimeve të përgjithëshme teologjike*", në gjirin e saj, kishte njëzet e pesë doktorë të shkencave, të fushave të ndryshme, me renome evropiane. Dokumentet e shfrytëzuara na mundësojnë që të përcjellim veprimtarinë e "*Qendrës së studimeve të përgjithëshme teologjike*" si dhe rolin kulturoro-historik që ka luajtur në atë kohë. Rrethanat e pafavorshme politiko-shoqërore, që ekzistonin në atë kohë, në qytetet bregdetare, por edhe më gjerë, e kishin detyruar udhëheqësin gjeneral, të etërve rregulltarë, Dominikan, Raimondin nga Kapua, që të jipte urdhër për shpërnguljen e "*Qendrës së studimeve të përgjithëshme teologjike*" në qytetin dalmatinas, të *Zarës*, dhe kështu të largohej njëherë e përgjithmonë kjo vatër e dijes dhe e kulturës nga qyteti i Durrësit.
Në veprën e Papës Benedikt i XIV[32], *"Opera Omnia"* e botuar në vitin 1767[33], ndodhen pesë tekstet e shkruara në gjuhën shqipe[34]. E tërë vepra është e shkruar në gjuhën latine, pos teksteve në gjuhën shqipe dhe njërit nga këto edhe në

32 Benedikti XIV-të, ishte papë në vitet: 1740-1758, [ose: Prospero Lambertini, lindi në Bolonjë në vitin 1675 dhe vdiq në Romë më 1758].

33 Titulli në origjinal është: **BENEDICTI XIV**. /PONT. OPT. MAX./ OLIM/ PROSPERI CARDINALIS/ DE LAMBERTINIS/ **OPERA OMNIA**/ IN UNUM CORPUS COLLECTA,/ ET NUNC PRIMUM IN QUINDECIM TOMOS DISTRIBUTA/ EDITIO NOVISSIMA/ ANTE ACTIS OMNIBUS AUCTIOR, CASTIGATOR,/ ET MELIORI ORDINE DISPOSITA,/ ADDITIS PRÆTEREA TRIBUS INTEGRIS VOLUMINIBUS,/ QUÆ NUNC PRIMUM PRODEUNT,/ Et pluribus aliis factis luculentissimis accessionibus, quas Præfatio Tomo/ prima præfixa melius docebit./ TOMUS SEPTIMUS/ CONTINENS/ *ACTA CANONIZATIONIS SANCTORUM FIDELIS A SIGMARINGA,/ CAMILLI DE LELLIS, PETRI REGALATI, JOSEPHI A LEONISSA,/ ET CATHARINÆ DE RICIIS/ A BENEDICTO XIV. CELEBRATÆ;/* Una cum Apostolicis ejusdem Pontificis Litteris, & Vaticanæ Basilicæ ornatus/ descriptione; adjectis etiam plurimis æneis Tabulis elegantissimus./ IN TYPOGRAPHIA BASANENSI,/ MDCCLXVII./ SUMPTIMUBUS REMONDINI VENETI./ SUPERIORUM PERMISSU, AC PRIVILEGIO.

34 Një informacion për këto tekste së bashku me ilustrimet e tyre u botua në revistën: "Ekskluzive", Zürich-Tiranë-Prishtinë, 2000, shtator, nr. 7, f. 63-70; Musa Ahmetil: "*Zbulohen pesë tekste të vjetra në gjuhën shqipe të panjohura deri me tash*".

gjuhën greke. Autor i këtyre teksteve të cekura është imzot Zef Skiroi, kryeipeshkv i Durrësit dhe Vikar Apostolik i Himarës.

Teksti i parë në gjuhën shqipe ndodhet në f. 81, kolona e majtë:

Scium i lumuri at.

Tæ bæmet, lævdimet, edhe ato Kyæ caa pæsuanæ præ feenæ tæ Chrisctit robby i tyn Zoti Fidheli caa Sigmaringa na dæftognanæ me aft, se ay Kyun caa i ver tet, i miræedhe i besæs ndæ sctæpiit tyn Zoti, edhe stolisænæ meta ggith lævdimet tæ Apostollyet. Ktæ tæ vertet desc vet Zotyn te defton me scegnet Kyæ caa bæn gner sod præ tæ falurit, e præ te luturit atiy vet tæ lumurit gnerii. Tasc po duhet, vece saa scnuhet emæny i tiyh me sceitænat. Asctu e martenæ me mbndemia tæ paa diiturat, a asctu thom paa fare frik.

Josefi Schirò Arçbiscupu i Durrsit, edhe Vicar Apostolycu i Hymarrs ndæ Abænit.

Teksti i dytë në gjuhen shqipe ndodhet në f. 121, kolonat majtas e djathtas:
SCIUMÆ ILUMURI AT.

Pse tæ ggith ato caffsc Ky'duhenæ præ tæ scietænuanæ tæ lumænæ Camil de Lellis yan bænæ gner tasct fort Miræ me hijr tæ tynæ Zoti, e me tæ Madhenæ urtesij tænde. Gnæ punæ vetæmæ duhet, saa scnuhet æmbni i thih me tæ tiera scetæna. Kæiò ndeer i tucon me ggiggæ, pse pat scium lævdime, e scium tæ dasciunæ præi tynæ Zoti, o prei sciocunæ, e schignanæ. Kayò edasciunæ duron sod, e ggith monæ præ tæ madhenæ sciokærij, ayò kiæ scær ben ta sæmurturit. Zotyn caa scium dæstuaræ tæ madhenæ scietnii e tiyiæ me scium scegne. Andai i lumuri At tæ lutemi, e tæ falemi ggith saa iemi, edhe une præ pies tæ Arbænit tæ scruasc edhe kætæ ndæ tæ ticræ scietana.

Josefi Schirò Arçbiscopu i Dursit, e Vicar Apostolicu i Hymarrsæ ndæ Arbænit.

Teksti i tretë në gjuhën shqipe ndodhet në f. 143-144, kolonat djathtas e majtas:
TLUMURI PIETR' REGALAT CAA SPÆGNA,

SCIUM I LUMURI AT

Kyænæ caa, edhe cuur isc i ggyal. Kak imath sciet, saa ggith bota, egneræ ia rith, e veyæ tek' ay'ty truhey, e ty luteyæ po si cuur t'isctenæ i madh sciet e scium i diitunæ Profet. Ayò vet fratænia e scietit Frangisk, egneh, edhe elæv don sod, e ggith monæ, se ay e caa mbæsuanæ, e nderkyunæ mbæ udhæ maæ tæ Miræ. Zot n'i madhi e caa nderturæ ndæ ktæ yet me scium, e tæ mbædhaa sciegne. Præ andai loyas se mændæ thomi paa frik, se præpara tyn Zoti isct gnaæ imath sciet.

Josefi Schirò Arçbiscæpu i Durrsit, e Vicar' Apostolicu i Hymarrs ndæ Arbænit.

Teksti i katërt në gjuhën shqipe ndodhet në f. 166-167, kolonat djathtas e majtas:
NA I LUMURI AT

Gnæ tietræ tæ skælkiem xompl hæ na dæfton præ tæ ndiecuræ scieta Fratnij e Capuccinet me tæ lumurinæ Josif caa Leonissa. Præ tæ vertet se ggith ggela e tiyh na bie gnæ eeræ scium tæ miræ ndæ hundæt tona. Pse Zotynæ caa derdhuræ mbij tæ me doræ hapt po si vaggh, gith hiret; e ggith dhunetiit scpiertit sceint. Edhe e caa bæænæ po si zæmbra e tiih. Unæ nænc e mar me mænd'e mia, tæ thom, e tæ nu muroga tascti ggith lævdimet. Kityæ robby tyn Zoti. Vec e cam me aft se Kyscia sceinte i caa gnohunæ præ tæ mbædhaa, tæ mira, edhe tæ verteta. Asctu thom, edhe præ scegnet, e mbrecullij, me se Zotyn caa ndertunæ Ktæ robbin' e tiyh. Tascti duhet vetæmæ. Saa ty scium i lumuri At. Tæ haps, e tæ deftosc Ktæ tæ bucur', e Ktæ tæ lævduam sceint ne rii, saa te ndekgnæ ggith bota, e ggith Krisctærymi.

Josifi Schirò Arçbiscupu i Dursit, e Vicari Apostolicu ndæ Arbænit.

Teksti i pestë në gjuhën shqipe ndodhet në f. 190, kolonat majtas dhe djathtas:

SCIUM I LUMURI AT

E lumura Caterinæ tæ Riccevet Eberdh asc e Kalogree e sceitit Domenikæ, gnera saa roi mbaiti fert, fakienæ, e scemæliynæ ætyn Zoti Kyè Kriivoi, me pastriminæ e saayæ. Pashisi, e u mændua saa mænbi tæ scæmæteneg ede Zotit Chrisctæ Kyæ na scpræblei me vet mundimet e tiy. Ma pte me fukiynæ e say nænc mundi tæ Kiscktæ te Madhe hiir. Yia dhuroi vet Chriscti Zotyn me scegnet e mundimevet kyæ i tiposi mbæ tæ kriominæ Kufomæ tæ asay Adha gnæ vasc asctu e kriuræ, asctu e munduaræ, edhe kakoe scium e dæsciuræ caa Zotyn, edhe ascti e nderturoe me scium seegne tæ sceitæriis. Isct e ggiiggsæ tæ ndeersc edhe ti scium i lumuri At. E tæ scruasc

embrin e saay me tæ tierat scietæra vascia. Asctu se tæ yeet, embri e se madhes sciet Katerinæ kaa Siena, edhe ay i asay, kiæ isct caa Fiorenza.

Josefi Schirò Arçbiscupu i Durrsit, edhe Vicar Apostolycu i Hymarrs ndæ Arbænit Tekstet fillimisht janë të shkruara në gjuhën shqipe, pastaj pason përkthimi në gjuhën latine, përjashtim bënë teksti i pestë, ku pas përkthimit në gjuhën latine pason edhe përkthimi në gjuhën greke. Tekstet në gjuhën shqipe fillojnë me shkronjën e parë, e cila është zakonisht, inicial. Brenda inicialeve në dy raste kemi dy figura, ndërsa në tre të rastet tjera kemi vetëm dekorime. Edhe teksti greqisht fillon me një inicial, por në të nuk ka ndonjë figurë të veçantë, pos që është i dekoruar.
Gabime të shumta ka në tekstet në gjuhën shqipe, të cilat mund t'i cilësojmë si *lapsus calami*.
Janë përdorur edhe pesë grafema apo shenja të veçanta në tekstet shqipe, për: ***dh***; ***th***; ***z***; ***y***; dhe ***ë***. *[Të cilat siç cekëm edhe më parë, i kishte shfrytëzuar prifti shqiptar Pal Zagoj për gramatikën e tij]*. Kjo na bën të konkludojmë se imzot Skiroi, shumë më parë ka shkruar dhe ka botuar në gjuhën shqipe, por për fat të keq deri me tashi nuk kemi arritur të zbulojmë ndonjë nga veprat e tija, qofshin origjinale apo përkthime.
Për personalitetin Zef Skiroit, deri tashti kemi të dhëna të pakta. Na është i njohur një relacion të cilin Skiroi ia dërgon Propagandës Fide në vitin 1729 nga Himara, ku thekson se fëmijëve iu mëson "*Doktrinën e Krishterë*", shqip e greqisht.[35] Nuk kemi të dhëna të sigurta, se me çfarë teksti shërbehej Skiroi, "ndonjë tekst i përkthyer më parë, si ai i Matrëngës, i Budit apo dhe i Rodinoit", apo ishte një nga përkthimet e tij origjinale, që është më afër mendsh.
Zef Skiroi ka lindur në vitin 1690. Pasi mbaron studimet teologjike, më 9 shtator të vitit 1719 emërohet misionar në Himarë, ndërsa me 28 shkurt të vitit 1736 emërohet kryeipeshkv biritual i ritit romak dhe atij bizantino-lindor për Durrës, e më 15 prill të vitit 1736 emërohet edhe Vicar Apostolik për Himarë. Vdes në Romë më 2 dhjetor të vitit 1769. Për veprimtarinë e tij, pos relacionit të përmendur dhe pesë teksteve të shkruara në gjuhën shqipe, latine dhe njërin në greqishte, nuk dimë gjë.
Duhet veçuar se të gjitha tekstet që janë në gjuhën shqipe, korrespodojnë me ato në gjuhën latine; përjashtim bën teksti i dytë, /f. 121/, i cili në gjuhën latine është më i gjatë se sa ai në gjuhën shqipe.
Të gjitha tekstet e tjera janë përafërsisht të njëjta dhe kanë të njëjtën përmbajtje, me ndryshime të vogla dhe pak të rëndësishme. Situatë e njëjtë është edhe me tekstin në gjuhën greke, i cili është përkthim besnik i tekstit nga gjuha shqipe me disa ndryshime shumë të vogla nga teksti në gjuhën latine.

35 Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. [Akademia e RPSH-Instituti i Historisë]. Tiranë, 1976, f. 106, nr. 77.

VIII. Dorëshkrimi nga kolonia shqiptare e Hërtkovcit dhe Nikincit nga viti 1781

Një dorëshkrim tjetër i rëndësishëm është ai i Adam Borovacit, që ruhet në sektorin e dorëshkrimit dhe librit të rrallë, në Bibliotekën Universitare Kombëtare të Zagrebit.[36] Ky dorëshkrim është nga kolonia e shqiptarëve kelmendas të Hërtkovcit dhe Nikincit, i cili është datuar në vitin 1781. Përbëhet nga 12 fletë dhe kryesisht janë lutje kishtare, dy këngë popullore dhe disa fjalë të urta.
Disa nga këto lutje janë:
Pr emnit Attit, e Brit e Shpirtit shehnt. Amen! Shtukjoft;
E me besna shpirti Shent;
Mos me mar Emni tin Zott pr goj kafsh mrazta, etj.

IX. Dorëshkrimi i fjalorit italisht shqip

Dorëshkrimi i fundit për të cilin do të bëjmë fjalë me këtë rast është fjalori italisht shqip, nga viti 1848,[37] i cili ruhet në bibliotekën e qytetit të Todit në Itali, me autor Luca di Monte Giove[38]. Autori ishte misionar në Shqipëri, ndërsa më vonë ka dhënë mësim në Kolegjin e San Pietro di Montorio të Romës. Dorëshkrimi përbëhet nga 328 faqe, format folio.
Duke argumentuar me dokumente dhe fakte të gjalla, dëshirojmë të tregojmë, se populli shqiptar, edhe në periudhat më të vështira dhe më të errëta të historisë së tij, edhe atëherë kur ka luftuar të mbijetojë, nuk e ka hedhur anash kulturën, traditën, historinë dhe besimin, por çdoherë ka menduar e vepruar, ka lënë gjurmë të shkruara, duke u kujdesur që të ruajë atë që është më e vlershmja, gjuhën amtare, e cila ia mundëson zhvillimin e kulturës dhe rimëkëmbjen kombëtare. Shpresojmë se këto gjurmë do të pasurohen me hulumtime dhe kërkime shkencore të reja, duke begatuar edhe më shumë historinë e traditës së shkrimit shqip.

Dr. Musa Ahmeti - Zagreb

36 Šime Juri?, *Katalog rukopisa Nacionalne i Sveu?ilišne Biblioteke u Zagrebu.* [Nacionalna i Sveu?ilišna Biblioteka /NSK/]. Zagreb, 1994; Adam Borovac, *Klimentinci u Sriemu*. *Katalog rukopisa Nacionalne i Sveu?ilišne Biblioteke u Zagrebu.* [Nacionalna i Sveu?ilišna Biblioteka]. Zagreb, 1994, vëll. III, nr. 4954.

37 Shiko edhe: Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. [Akademia e RPSH-Instituti i Historisë]. Tiranë, 1976, f. 266, nr. 420.

38 Autori ishte misionar në Shqipëri. Një kohë ishte mësimdhënës për lëndën e gjuhës shqipe në Kolegjin e Shën Pjetirit të Montorios, në Romë.

Grant Harris
Biblioteka e Kongresit Amerikan

Komponentet digjitale në Biblioteka

Sistemet e integruara bibliotekare (ILS)

Sistemi i integruar bibliotekar është një sistem i automatizuar që përmban në vete një numër të elementeve të tilla inter-operacionale, si: pasurimi i fondeve, qarkullimi, katalogimi, seritë e botimeve dhe qasja në Katalogun Publik përmes faqes së Internetit (Online Public Access Catalog). Sistemi i integruar bibliotekar e zvogëlon dyfishimin e përpjekjeve; i zvogëlon gabimet nëse të dhënat janë krijuar më parë; dhe lejon që ndryshimet të bëhen në tërë sistemin me vetëm ca goditje të tastiereve. Stafi i bibliotekës dhe klientët e rregullt mund të kenë qasje në të gjitha informacionet përkatëse nga mjedise të shumta. Në ditët e sotme, bibliotekat më tepër e blejnë Sistemin e Integruar Bibliotekar se sa që e krijojnë një të tillë. Sistemet e krijuara bibliotekare përshtaten në Internet.

Interneti i hapur: Gjetja e informatave falas

Shumica e organizatave perëndimore me më shumë se 25 anëtarë, i kanë faqet e tyre të Internetit, po ashtu ka edhe një numër të mirë të individëve që kanë krijuar faqe personale në Internet. Udhëzuesit dhe mekanizmat kërkues janë dy burime për gjetjen e informatave.

Udhëzuesit- udhëzuesit e përgjithshëm shpiejnë në shumë burime. Shembuj të mirë janë:
Yahoo http:// www.yahoo.com
Lucos http:// www.lycos.com
Indeksin e bibliotekave në Internet http://www.lii.org
Portat për botën http://www.loc/gov/rr/ international/portals.html
Biblioteka e Kongresit është duke zhvilluar porta gjithëpërfshirëse të shënimeve (udhëzues special në faqe të Internetit) për secilin vend të botës. Shumica e portave do të shtohen kah fundi i vitit 2003, përfshirë këtu edhe portën shqiptare.

Mekanizmat kërkues

Search Engine Watch (Mekanizmi Kërkues Watch) siguron raporte të reja në të gjitha aspektet e mekanizmave kërkues. Njëri raport, "Mekanizmat kryesorë kërkues", ka informacione për më shumë se dhjetë mekanizma kryesorë kërkues, që të gjithë ata i mbulojnë vendet e Evropës Lindore. Google kontrollon më shumë faqe të Internetit se sa ndonjë mekanizëm tjetër kërkues. Konkurrues i afërt me të është AllTheWeb. Megjithatë, jo të gjithë mekanizmat kërkues e mbulojnë tërësisht faqen e Internetit, dhe mekanizmat kërkues kryesorë nuk i fusin në treguesin e tyre të gjitha faqet të cilat kontrollohen nga mekanizmat më të vegjël, ose së paku nuk i kontrollojnë në një shkallë të njëjtë me ta.
Kështu që, secili mekanizëm ka formula të ndryshme lidhur me relevancën e faqes së Internetit të cilën e kërkon. Për këto arsye është mirë që të përdoret më shumë se një mekanizëm kërkues.

Mekanizmat multimedial të kërkimit

Në të njëjtin mekanizëm kërkues të përmendur më lart, Search Engine Vatch është një faqe që jep informacione për "Mekanizmat multimedial kërkues," faqe e cila është e specializuar në fajle të pamjeve, të zërave apo të videove. Mekanizmat kërkues të pamjeve janë të vlefshëm në gjetjen e hartave, fotografive, pikturave, etj. Ato, në të njëjtën kohë, i shfaqin disa pamje në ekran, kështu që ju mund t'i shihni dhe ta krahasoni zgjedhjen tuaj në mesin e këtyre pamjeve pa qenë nevoja ta shikoni secilin veç e veç.

Udhëzime kërkimore

Mekanizmi kërkues Watch-Udhëzime kërkimore në faqe të Internetit:
ttp:// searchenginewatch.com/facts/index.html
Mekanizmi kërkues Watch i sqaron po ashtu teknikat themelore të kërkimit. Një teknikë e mirë është kërkimi me fraza, i krijuar në shumicën e mekanizmave

kryesorë kërkues ashtu që vendosen citate rreth frazave. Një veçori e shumicës së mekanizmave kërkues është se e lejon përdoruesin që ta specifikojë që termi kërkues të gjendet në emrin e lëmisë (pjesë e URL-së) ose në titullin e faqes së Internetit. Disa mekanizma kërkues, i tillë si Google dhe Allthe Web kanë një meny të gjatë të gjuhëve; zgjedhja e gjuhës do t'i kufizojë kërkimet e mëtutjeshme në tekste të shkruara vetëm në atë gjuhë. Shumë mekanizma kërkues bëjnë që këto veçori të përdoren më lehtë në sistemin "Kërkim më i përparuar".

Marylaine Block htpp://marulaine.com
Merylaine Block është një bibliotekare e Internetit, e cila siguron në faqen e saj të Internetit shumë udhëzues të thjeshtë, por të shkëlqyeshëm, se si të gjinden informacionet në Internet. Kliko në pjesën " Workshon Notes and Qutlines" për t'i gjetur këto udhëzime.
Keni kujdes të konsideroni besueshmërinë e çfarëdo informate që gjeni në faqe të
Internetit. A vjen ajo prej ndonjë organizate apo individi që ju i besoni? Gramatika e dobët apo drejtshkrimi mund të jenë një shenjë që atij informacioni nuk mund t'i besohet.

Burimet komerciale elektronike

Shumica e bibliotekave perëndimore paguajnë për blerjen e burimeve komerciale elektronike, posaçërisht revistave elektronike (e-revistave) dhe të dhënave bibliografike të artikujve të revistave. Këto materiale të vlefshme mund të sigurohen nëpërmjet teknologjisë së Internetit, por ato nuk kanë qasje falas në Internet. Buxhetet e bibliotekave për burimet komerciale elektronike radhiten nga 10.000 deri në 500.000 dollarë amerikan në vit, e kjo varet prej mundësisë dhe nevojës së bibliotekës.

Biblioteka e Kongresit në shek 21- një strategji digjitale për Bibliotekën e Kongresit

Më 1998, drejtori i Bibliotekës së Kongresit, Xhejms Billington, e autorizoi Akademin Kombëtare të Shkencave për të bërë një raport për praktikat dhe iniciativat teknologjike të Bibliotekës. Teksti i plotë i raportit doli në korrik të vitit 2000 dhe mund të shihet në këtë faqe të Internetit

http://www.nap.edu/books/0309071445/html. Ky raport me gjatësinë e një libre e lavdëronte Bibliotekën e Kongresit për krijimin e një programi kombëtar digjital, përmes së cilës u digjitalizuan disa miliona artikuj. Megjithatë, pjesa më e madhe e raportit e kritikonte ashpër bibliotekën. Ndër të tjera, në raport ishin edhe këto:

1) Edhe pse biblioteka i kishte digjitalizuar miliona artikuj, ajo kishte dështuar së qeni lider, për arsye se biblioteka nuk po përpiqej ta koordinonte digjitalizimin me bibliotekat e tjera ose të krijonte standardet e digjitalizimit.
2) Biblioteka kritikohej për arsye se nuk e kishte një specialist të trajnuar të teknologjisë së informimit (kompjuterit) në mesin e tre administratorëve të saj kryesorë, raporti rekomandonte emërimin e një specialisti në teknologjinë e informimit në një post të lartë të bibliotekës.
3. Raporti po ashtu nxiste, që i gjithë stafi të trajnohej për të mësuar më shumë shkathtësi kompjuterike, që stafi shtesë të pajtohej me teknologjinë informative, dhe që biblioteka të gjente një mënyrë për t'i paguar specialistët e tillë me një pagë që do të ishte e mjaftueshme për t'i tërhequr dhe mbajtur ata në bibliotekë.
4. Biblioteka e kishte injoruar faktin që disa faqe të Internetit po zhdukeshin; Akademia Kombëtare rekomandonte që biblioteka të përpiqejë t'i ruante ato faqe të Internetit që kishin të bënin me materiale amerikane dhe t'i koordinonte përpjekjet e saja me institucionet e tjera. Si rrjedhojë, Biblioteka e Kongresit i bëri dy përpjekje të rëndësishme për ruajtjen e faqeve të tilla të Internetit – shih pjesën e mëposhtme rreth ruajtjes së faqes së Internetit.
5. Raporti në mënyrë të qartë i bënte thirrje bibliotekës që të bënte më shumë projekte të digjitalizimit, mirëpo biblioteka nuk mund ta braktiste librin apo përgjegjësitë e tjera.

Kështu, raporti i bënte thirrje Kongresit të Shteteve të Bashkuara që të siguronte fonde shtesë në atë mënyrë që Biblioteka e Kongresit të mund t'i zbatonte rekomandimet e shumta të bëra në raport. Si rrjedhojë, Kongresi i siguroi fondet e rekomanduara.

Ruajtja e faqes së internetit
http;//www.locgo/minerva

MINERVA. Këto informata kulturore dhe shkencore, të cilat janë gjithnjë në rritje, tash për tash, janë të krijuara vetëm në formate të digjitalizuara dhe nuk ekzistojnë në ndonjë formë tjetër fizike. Materiale të tilla në gjuhën e përditshme quhen "të lindura në formë digjitale." Kjo mbretëri e këtyre materialeve të lindura në formë digjitale ka qasje të lirë përmes Internetit. Për shkak se periudha

kohore e zgjatjes së informatave në faqe të Internetit është më pak se 50 ditë, MINEVRA, projekti i ruajtjes së faqeve të Internetit, u themelua për të filluar një program të gjerë të mbledhjes dhe ruajtjes së materialeve kryesore para se ato të zhduken. Një ekip në përbërje të anëtarëve nga disiplina të ndryshme prej stafit të bibliotekës po studion metodat për vlerësimin, zgjedhjen, mbledhjen, katalogimin, sigurimin e qasjes dhe ruajtjes së këtyre materialeve për gjeneratat e ardhshme të studiuesve.Vetëm burime të zgjedhura të Internetit mund të ruhen në këtë mënyrë, dhe për këtë arsye, Biblioteka e Kongresit ka ndërmarrë nismën e dy bibliotekave digjitale:

http://web.archive.org/collections/e2k.html

Zgjedhjet 2000: Internet biblioteka është një koleksion i zgjedhur i afër 8000 faqeve të futurave në arkiv, çdo ditë nga 1 gushti 2000 deri më 21 janar 2001, e cila e mbulon periudhën e zgjedhjeve kombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

http://september 11.archive.org

Faqja arkivi i 11 shtatorit i ruan, në faqe të Internetit, pasqyrimet individuale, të grupeve, shtypit, institucioneve në Shtetet e Bashkuara dhe atyre nga mbarë bota sa i përket periudhës pas sulmit të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara. Faqja e arkivit është e rëndësishme për arsye se kontribuon në mbledhjen e të

dhënave historike, duke mbledhur informata, të cilat mund të kishin humbur. Me rritjen e rolit të faqes së Internetit si medium me ndikim, të dhënat e ngjarjeve historike do të mund të konsideroheshin të pa plota pa materialet në faqen e quajtur " të lindura në formë digjitale" (born digital), të cilat asnjëherë nuk u shtypën në letër.

Intranetet

Burimi i plotë i Internetit http://www.intrack.com/intranet

Në faqen e mësipërme mund të gjeni një hyrje të vlefshme sa i përket intraneteve. Intraneti është shfrytëzim i teknologjive të internetit brenda një organizate për të arritur rezultate më të mira se sa qasja dhe dërgimi i të dhënave në mënyrë tradicionale.

Intraneti ndryshon prej internetit në aspektet sa vijon:

Intraneti është një rrjet brenda organizatës, ndërsa Interneti është një rrjet në mbarë rruzullin.

Intraneti ka qasje në Internet, por jo edhe anasjelltas. Ekziston një "mur ndarës" që e mbron intranetin e organizatës nga përdoruesit e jashtëm.

Intraneti ndihmon në zvogëlimin e shpenzimeve. Intraneti e kursen kohën e punëtorit duke bërë të mundur vënien në dispozicion të dokumenteve të brendshme, udhëzuesve dhe materialeve të tjera që u nevojiten çdo ditë punëtorëve, duke përfshirë këtu edhe informatat e reja. Biblioteka e Kongresit e ka intranetin për stafin, i cili përfshin: listën e kurseve të trajnimit, orarin e ngjarjeve, një orar për autobus të vaçantë, gazetën javore të bibliotekës, shpalljen e vendeve të punës, informata emergjente, burime elektronike komerciale, të cilat biblioteka ka mundësi t'i blejë si provë për qëllime të vlerësimit, informata administrative për secilin divizion të bibliotekës, një udhëzues për të gjithë të punësuarit, informata për shërbimin shëndetësor, informata për shërbimin e sigurisë, një udhëzues për shoqatat e veçanta, etj. Po ashtu, përmban edhe një numër të formularëve administrativë, që disa prej tyre mund të plotësohen dhe të dorëzohen me anë të Internetit.

Të krijosh për internetin

Bibliotekat i krijojnë faqet e Internetit për të siguruar një gamë të gjerë të informacionit. Divizioni evropian, në të cilin punoj, e ka faqen e vet të Internetit, e cila siguron këto informacione: informata sa i përket divizionit, orari i Dhomës së Leximit të Divizionit Evropian, koleksioni referal dhe shërbimet, pyetjet e

bëra më së shpeshti, përshkrimin e koleksioneve të bibliotekës, të cilat e mbulojnë secilin vend të Evropës, librat e adresave dhe telefonave për disa nga vendet e Evropës, porta (udhëzues të faqeve të Internetit) për vendet e Evropës, tabela transliterimi prej alfabetit çirilik në atë Latin, përshkrimi i disa të dhënave komerciale të cilat janë në dispozicion në Sallën e Leximit të Divizionit Evropian, një kalendar i ngjarjeve publike të divizionit, interpretime, ligjërata dhe konferenca; projekte të veçanta, botime dhe ekspozita evropiane në Bibliotekën e Kongresit. Ne, po ashtu jemi duke digjitalizuar pamje për faqen e quajtur "Takim Kufijsh," e cila ka të bëjë me marrëdhëniet e kahmotshme ndërmjet Siberisë dhe Alaskës. Me sigurimin e këtyre lloj informacionesh iu mundësohet përdoruesve të Internetit që t'i gjejnë përgjigjet e veta dhe kështu ne jemi të liruar që të mos i përgjigjemi së njëjtës pyetjeje në mënyrë të përsëritur. Në anën tjetër, kjo të jep atë përshtypje se ne jemi profesional në një qendër informacioni, e cila ka interes për studime të mëtutjeshme. Kjo, po ashtu, i inkurajon studiuesit që të na kontaktojnë dhe ta përdorin dhomën e leximit si dhe koleksionet tona. Ju mund të mendoni se sigurimi i këtyre informacioneve do të sjell me shpresë shumë studiues në bibliotekën tuaj, por kjo nuk ka qenë përvoja e jonë.

Referencat digjitale

Qysh nga mesi i viteve të 90-ta, numri i amerikanëve që i përdornin bibliotekat hulumtuese u zvogëlua pasi që në Internet ata mund të gjenin përgjigje për disa prej pyetjeve të tyre. Bibliotekat i janë përgjegjur kësaj në shumë mënyra: si blerja e burimeve komerciale të Internetit, të cilat mund të përdoren vetëm në institucionet të cilat i blejnë ato; krijimi i faqeve të Internetit me informacione të dobishme për hulumtuesit; dhe sigurimi i referencave digjitale. Referencat digjitale janë zgjerim i shërbimeve tradicionale referale që ofron në shumicën e bibliotekave, por në këtë rast hulumtuesit mund të bëjnë pyetjet që nga larg. Në shumicën e rasteve kjo kryhet përmes Internetit dhe adresës elektronike (E-mail). Shumica e bibliotekave i kanë faqet e Internetit, të cilat ia mundësojnë hulumtuesit që të bëjë pyetjen, ndërsa bibliotekarët referalë kryesisht iu përgjigjen atyre që pyesin përmes adresës elektronike. Përgjigjja e bibliotekarit mund të përmbajë përgjigjjen ose pyetjen për sqarim, ose bibliotekari mund t'ia referojë hulumtuesit ndonjë libër të veçantë, periodik, faqe të Internetit, ose ndonjë bibliotekë/institucion më të përshtatshëm për dhënien e përgjigjjes së caktuar. Nganjëherë bibliotekarët përgjigjen përmes telefonit ose duke i dërguar me faks informatat deri te pyetësi. Dhe nganjëherë bibliotekarët u tregojnë hulumtuesve

që të vizitojnë ndonjë bibliotekë për të bërë hulumtime më të thella që iu nevojiten për të gjetur përgjigjen e duhur. Tradicionalisht, një bibliotekar referal siguron udhëzime sa i përketë metodologjisë së blerjes së hulumtimeve dhe iu referon hulumtuesëve materiale që mund t'i ndihmojnë ata. Bibliotekari referal nuk hulumton vet, vetëm nëse përgjigjja gjindet shpejtë. Unë jam bibliotekar referal dhe detyra ime është që ta dij metodologjinë e hulumtimit, ta njoh koleksionin e bibliotekës, burimet digjitale, madje edhe institucionet dhe specialistët e tjerë.

Referencat digjitale të ofruara nga bibliotekat publike janë falas. Biblioteka e Kongresit dhe ndoshta 100 biblioteka të tjera në SHBA dhe në vende të tjera kanë hyrë në një shërbim të përbashkët të referencave digjitale të quajtura QuestionPoint (PikëPyetje), përmes së cilës pyetjet referale të bëra nga një anëtar biblioteke mund të përcillen deri te anëtari i bibliotekës tjetër, i cili mund të ofrojë një përgjigje më të mirë. Bibliotekat që janë pjesë e këtij shërbimi të quajtur QuestionPoint (PikëPyetje) përdorin programe të veçanta të cilat e bëjnë të mundur përpunimin e lehtë të pyetjeve. Referenca digjitale ende është në fazën e saj të parë.

9 prill 2003
Përktheu: Besim J. Kokollari

Mr. Behxhet Brajshori
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Shuflaji për shqiptarët

Ekspozita që hapet sot, i lidh dy emra: Shqiptarët dhe Milan Shuflajin. Burimologjia e historisë së shqiptarëve, pa Shuflajin dhe Ferlatin do të humbte çdo ekuilibër. Në këtë ekspozitë, ju mund të gjeni fondet e mbledhura nga ky dijetar i jashtëzakonshëm të mbështetura në burime dokumentare.
Shuflajin shpesh e kanë quajtur një dijetar albanofil. Në fakt, suksesi i veprës së tij nuk lidhet me ndonjë albanofil. Te Shuflaji fitoi kulti i dijes mbi etnocentrizimin e ngushtë, që shpesh në Ballkan ka bërë dëme mendore. Këtë vlerë të mbrendshme të tij, sigurisht e inkurajoi edhe shkolla austro-gjermane e albanologjisë të cilës i ka qëndruar pranë, gjithnjë me dinjitet, edhe shkolla kroate e sllovene. Ne nuk mund të përjashtojmë që deri diku mund të ketë ndikuar edhe origjina e tij fisnike, e cila e lidhte fort me periudhën e ndritur të fisnikërisë arbërore.
Milan Shuflaji ishte një figurë enciklopedike, i cili punoi me fuqinë e një instituconi. Ai ka mundur lirisht të shmanget nga albanologjia, sepse njëherësh ishte edhe latinist, helenist, orientalist, sllavist, ballkanolog, etj. Por dija për Shqipërinë dhe shqiptarët i dha kënaqësi intelektuale atij, madje i dha edhe ndjesi krijuese. Roman i tij, "Konstandin Balsha" nuk u nënshkrua rastësisht me emrin letrar >> Alba Limi<<. Për Shuflajin historia e shqiptarëve ishte kryesisht historia e një etniteti etnokulturor të dalluar me rrënjë të lashta autoktone dhe me aftësi të mëdha regjeneruese. Shuflaji, sipas akademikut kroat, dr. Darko

SAGRAK, ishte historian me një stil të mrekullueshëm që e njihte shumë mirë gjuhën shqipe. Shkenca shqiptare i detyrohet shumë modelit të Shuflajit. Fundi i tij, është një fund që shpesh u ka ardhur rrotull " Modeleve të rrezikshme" që u përfshin punë të tjerëve me vështrime ndryshe. Milan Shuflaji monumentalizoi gjendjen e Shqipërisë në periudhën e fillimit të Rilindjes Evropiane, duke u bërë një dëshmitar gjëmimtar për fytyrën evropiane të këtij vendi, deri në pragun e pushtimit osman.
Familjet patronomike, qytetet dhe kështjellat, kishat dhe manastiret, vulat dhe emblemat, letrat dhe marrëveshjet e familjeve arbërore, përmes dokumenteve që mblodhi, botoi dhe studioi Shuflaji, dalin nga legjenda dhe hynë në histori.
Unë e kam ndjekur me shumë kënaqësi bashkëpunimin e Arkivave të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Kroacisë, sidomos sa i përket iniciativës së tyre për ta ringjallur Shuflajin.
Dijetarët e mëdhenj, të përmasave të Milan Shuflajit, na bëjnë të ditur se tradita për pavarësi dhe shtetformim te shqiptarët ka rrënjë të thella ndër shekuj.
Akademikë, historianë, arkivistë, të gjithë sa jeni mbledhur këto ditë, dijetarë të zotë nga Kosova, Shqipëria dhe Kroacia, nga Italia dhe Maqedonia, si dhe nga aleatë tanë strategjikë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të keni rastin që, përmes lidhjeve të Shuflajit me Shqipërinë të vëni re edhe lidhjet e shëndosha të shqiptarëve me fqinjtë e tyre dashamirës. Ky është një kontribut kulturor e shkencor, por është edhe një kontribut për të kërkuar bashkërisht mendësinë evropiane të pasurimit të njëri – tjetrit me vlerat e botës shpirtërore.
Kosova brenda vetës ndjen detyrimin për të shprehur mirënjohje ndaj një modeli të albanologjisë ballkanike, por edhe për të inkurajuar këtë frymë të konvergjencës që vetëm kultura dhe shkenca mund ta bëjnë.
Edhe një herë i uroj mbarësi kësaj veprimtarie, u uroj mirëseardhje organizatorëve të saj.
Ne po promovojmë me këtë ekspozitë një pjesë të identitetit kulturor shqiptar.

9 prill 2003

Dr. M.Panxhiq
Arkivi shtetëror i Kroacisë

Shuflaji për shqiptarët

Të gjithëve ju përshëndes, në radhë të parë në emër të drejtorit të Arkivit Shtetëror të Kroacisë, dr. Josip Kollanoviqit, i cili nuk kishte mundësi të vijë për shkak të obligimeve zyrtare, prandaj luteni që t'i pranoni përshëndetjet e tij të përzemërta për punën e suksseshme dhe për bashkëpunim.

Ju përshëndes gjithashtu në emrin tim personal, dhe sinqerisht ju falënderoj për ftesën miqësore dhe të përzemërt, për pjesëmarrje në këtë manifestim me rëndësi, në radhë të parë për këtë ekspozitë të bukur, të përgatitur në mënyrë profesionale dhe shkencore, ekspozitë me rëndësi për jetën dhe veprimtarinë e prof. dr. Milan Shuflajit me titull: "Shuflaj për Shqiptarët"

Para se gjithash, këtu duhet të përqendroheni në risitë, që për herë të parë para publikut paraqiten si dokumente nga fond i Millan Shuflajit, i cili ruhet në Arkivin Shtetëror të Kroacisë, të pranuar nga familja, përkatësisht nga motra e M.Shuflajit. Këto para se gjithash, janë dokumentet personale për lindjen, shkollimin, studimet historike nga M.Shuflaji, njërit ndër doktorët më të rinj të shkencave të historisë në Universitetin e Zagrebit. Pastaj, këtu janë dokumentet, dorëshkrimet dhe punimet e M.Shuflajit për historinë e Shqipërisë, artikujt e shumtë të gazetave dhe lëndë të tjera nga fond i tij personal në Arkivin Shtetëror të Kroacisë.

Po ashtu, këtu për herë të parë prezentohen në opinion dokumentet për veprimtarinë e Shuflajit, për historinë e shqiptarëve dhe të Shqipërisë, të cilat ruhen në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë. Me rëndësi është të theksohet se përveç dokumenteve të tjera

të Arkivit Qendror të Shqipërisë, këtu për herë të parë prezantohen regestat për botimin e tretë të "Acta Albaniae…", ku mendohej se kanë humbur, përkatësisht, janë konfiskuar, pas atentatit, nga policia e Mbretërisë Jugosllave - për të cilët deri më tani nuk është ditur asgjë. Ato janë dorëshkrime, të cilat personalisht i ka shkruar M.Shuflaj, dhe të cilat s'ka dyshim, personalisht ia ka dorëzuar mbretit shqiptar, Zogut, me rastin e vizitës së tij në Tiranë, në fillim të vitit 1931, gati para vdekjes së tij.

Këtu gjithashtu, për herë të parë opinionit i prezentohen letrat të cilat M.Shuflaj ia ka dërguar historianit Lajosh Thalloczyju, në gjuhën hungareze dhe gjermane, dhe që kishin të bënin për historinë e Shqipërisë. Këto letra ruhen në Bibliotekën Universitare **Szclhenyja** në Budapesht.

Këtu gjithashtu për herë të parë eksponohen dokumentet me rëndësi për historinë e Shqipërisë nga fond i M.Shuflait, si psh: Statuti i qytetit të Danjës më 1319, i cili në origjinal ruhet në Arkivin historik të Palermos, si dhe shumë dokumente të tjera më rëndësi për historinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar të grumbulluara me veprimtarinë e gjatë të M. Shuflajt.

Kjo është koha e nxitjeve të reja që të vazhdohet puna në ndriçimin e veprës së Milan Shuflaj për shqiptarët, nga ana e vet shqiptarëve në bashkëpunim me ne, në një anë kur kemi pritur gjatë që përfundimisht të krijohet mundësia dhe liria intelektuale dhe njerëzore, por edhe të krijohen vlerat shkencore, ajo veprimtari, e cila do t'i lëvizë shumë krijimtari të filluara nga punëtori i shkëlqyer dhe shumë i madh, por edhe vizionar, M.Shuflaji.

Në punën e tij, ka pasur shumë kundërshtar, duke i përfshirë këtu edhe ata që në fund e kanë mbytur. Mirëpo, kishte edhe të tillë, të cilët e kanë përkrahur, ata të cilët ishin miq të tij, dhe i kanë ndihmuar në krijimtarinë dhe veprat e tij. Të tillë në të vërtetë kishte shumë, në mes të shumë popujve fqinj, mes kroatëve, serbëve, hungarezëve, austriakëve dhe të tjerëve – nga historiani beogradas dhe profesori i Universitetit, Stojan Stanojeviq, i cili e ka shkruar pozitivisht parathënien në librin e M. Shuflajit " Serbët dhe Shqiptarët", e cila ishte botuar në Beograd – deri te Lajosh Tholczyja, Konstantina Jericveka, Truhole, Vanina dhe shumë të tjerë.

Sot mund të gëzohemi, sepse ka ardhur koha dhe po vazhdon puna të cilën Shuflaji e kishte filluar. Po vazhdon edhe po thellohet bashkëpunimi i Arkivit Shtetëror të Kroacisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, dhe tani me Arkivin e Kosovës.

Ju falenderohem për të gjitha.

9 prill 2003

Dr. Shaban Sinani
Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë

Fondi i kodikëve të AQSH

Për herë të parë një katalog i kodikëve të Shqipërisë, dorëshkrime të letërsisë ungjillore, u përgatit nga Pierre Batiffol, në veprën "Les manuscrits grecs de Bérat d'Albanie et le Codex Purpureus Φ", *botuar në vitin 1886 në Paris dhe ribotuar një vit më pas në një revistë periodike shkencore. Në veprën e tij Batiffol bëri të ditur se kishte mundur të njihej drejtpërsëdrejti me 16 dorëshkrime shumë të vjetra të mitropolisë së Beratit, ndër të cilët edhe me* "Liturgjinë e Shën Gjon Gojartit", *që me kohë më vonë u zhduk. Batiffol përmend se në mitropolinë e Beratit kishte parë edhe shumë dorëshkrime të tjera, të cilat autoritetet kishtare nuk ia kishin lejuar t'i lexonte. Për këto dorëshkrime në librin e tij nuk ka të dhëna.*
Anthim Aleksudhi, (Alexuodes), një peshkop-dijetar i Beratit, botoi të dhëna të shkurtra për disa prej dorëshkrimeve ungjillore të fondeve që ruheshin në kishat e atij qyteti deri në fund të shekullit të 19-të. Titulli i plotë në origjinal i veprës, me karakter informues, është: "Κατολογοσ του εν ταισ ιεραισ εκλισιασ τισ σψνοικιασ καστρου, πολεωσ Βερατιου τισ μιτροπολεωσ Βελεγραδων ευρισκομενων αρχαιων χειρογραφων", i Anthim Alexoudes. Ky studim u botua më 1900 në revistën shkencore etnologjike-historike "Deltion tis Istorikis kai Etnologikis Etairias tis Ellados", në nr. 5 të saj, f. 352-369. *Aleksudhi pati shkruar për kodikët e Beratit qysh në vitin 1868, në veprën* "Përshkrim i shkurtër i historisë së mitropolisë së shenjtë të Beratit ...".

Në periudhën mbretërore dhe në vitet që pasuan u bënë përpjekjet e para për të njoftuar shqip studiuesit për vlerën e jashtëzakonshme të dorëshkrimeve më të vjetra ungjillore, kryesisht duke iu referuar burimeve të shkruara (jo vetë dorëshkrimeve).
Ilo Mitkë Qafëzezi njihet si studiuesi i parë vendës që shkroi për "Beratinus-1" dhe "Beratinus-2" në shqip dhe për lexuesin shqiptar. Në vend të termit "manuscript" *ai përdori kalkun* "shkresëdorë". *Më shumë u mor me "Kodikun e Kostë Beratit", por shkroi edhe për dy dorëshkrimet më të vjetër. Në fondin e Ilo Mitkë Qafëzezit në AQSH ruhen përshkrimet e tij bibliografike për kodikët, si dhe artikuj polemikë për autorësinë e dorëshkrimit të jeromonakut Kostantin Berati dhe për alfabetin e Teodor Haxhifilipit (veçohet një artikull i Namik Ressulit). Në Fondin 426 të AQSH, që i përgjigjet emrit të Ili Mitkë Qafëzezit, gjendet edhe një* "katalog dorëshkrimesh", *që lidhet me punën e tij për njohjen e kodikëve më të rëndësishëm brenda vendit.*
Posaçërisht për kodikët e Shqipërisë përgatitën një katalog me të dhënat themelore informuese për të mundësuar integrimin e tyre në fondin botëror të dorëshkrimeve të krishtera austriakët Johannes Koder dhe Erich Trapp, të cilët, në vitin 1968, botuan "Katalogun e dorëshkrimeve greqisht në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë në Tiranë" - "Katalog der Griechischen Handschriften in Staatsarchiv zu Tirana", *i cili i u bë i njohur përmes periodikut shkencor* "Jahrbuch der Österreichischen Byzantinischen Gesellachaft" *17 (1968), f. 196-214. Johannes Koder iu rikthye më vonë të njëjtit argument, por në mënyrë të përveçme, me artikullin* "Zur wiederentdeckung zweir Codices Beratini", *botuar në* "Byzantinische Zeitschrift" *65 (1972), f. 327-28, artikull që u kushtohet dy kodikëve të purpurt që ruhen në Shqipëri.*
Në kuadër të studimeve bibliologjike për historinë e mendimit të krishterë, kryesisht për rrugën e formimit të "Testamentit të Ri" si tekst i shkruar, me dorëshkrimet ungjillore të Shqipërisë, posaçërisht me "Beratinus-1", që përmban "një prej varianteve më të vjetra të Testamentit të Ri", u mor C. R. Gregory në veprën "Textkritik der Neuen Testamentes", *I-III, botuar në Leipzig, më 1900-1907 /* "Studim kritik për Testamentin e Ri". *Kjo punë u vazhdua prej Kurt Aland, i cili ribotoi disa herë, me plotësime dhe saktësime, inventarin e plotë të dorëshkrimeve më të rëndësishme të letërsisë ungjillore, punë e kurorëzuar në vitin 1994, me veprën* "Kurzgefasste Liste der Griechischen Handschriften des Neuen Testaments", Berlin - Walter de Gruyter - New York, 1994 - "Inventar i dorëshkrimeve greqisht të Testamentit të Ri". *Në këtë botim dorëshkrimet e traditës kishtare në Shqipëri zënë një vend më të merituar. Një numër kodikësh,*

rreth 35, marrin numër reference në listë dhe përshkruhen shkurtimisht në përmbajtje. Studiuesi britanik Roderic L. Mullen, i cili ka përgatitur për botim një listë të re të këtyre dorëshkrimeve, ka vënë re disa pasaktësi dhe mungesa në mënyrën e paraqitjes së kodikëve të Shqipërisë në traditën botërore të kodikëve.
Katalogu më i plotë i dorëshkrimeve ungjillore në Shqipëri është ai i përgatitur nga Theofan Popa, në vitet 1980, gjatë kohës që punoi pranë Arkivit Qendror Shtetëror. Ky katalog u përgatit nga autori si mjet informimi arkivistik. Në këtë kohë në AQSH vëllimi i dorëshkrimeve ungjillore ishte shtuar mjaft, jo vetëm për shkak të politikës ateiste të shtetit, por edhe sepse një pjesë e klerikëve, shumë vite më herët, qysh në vitet 1960, duke vënë re vështirësitë e ruajtjes së tyre, vepruan ashtu siç qenë këshilluar përmes një letre-qarkore të kryepeshkopit Paisi: ua dorëzuan ato në ruajtje arkivave.
Në ***"Katalogun e kodikëve mesjetarë të Shqipërisë"****, që u përgatit nga Theofan Popa, përshkruhen 100 kodikë, të cilët u bashkuan në një fond, që mori numrin e referencës "488". Për tre kodikët që përmbyllin listën pasaportat u përgatitën gjegjësisht nga: Zef Simoni, Sh. Sinani dhe Llambrini Mitrushi. Sipas një rregulli të brendshëm të shërbimit arkivor në Shqipëri, çdo fond ka pasur dy numra reference: një për identifikim dhe një tjetër për citim. Deri në dekadën e fundme fondi duhej të citohej vetëm me "numrin publik" të referencës, për të ruajtur "fshehtësinë e burimit". Numri publik i referencës formohej duke i shtuar dyfishin e qindësheve të numrit real, "të brendshëm", të referencës. Për këtë arsye, "Fondi 488", që përmban 100 kodikët e Shqipërisë, pothuajse gjithnjë është njohur më shumë si "Fondi 888". Në këtë fond, me kalimin e viteve, u bashkuan edhe 17 fragmente kodikësh. Por një numër i madh kodikësh, ndoshta po kaq, gjenden jashtë këtij fondi, në koleksione të dokumenteve të institucioneve të tjera kishtare, si dioqeza e Shkodrës, mitropolia e Gjirokastrës (Drinopolit), manastiri i Shën Gjon Vladimirit. Një prej kodikëve të "mitropolisë së Drinopolit", siç është njohur në gjuhën e administratës kishtare mitropolia e Gjirokastrës, është përshkruar në botimin "Albanica" I të Bibliotekës Kombëtare (Tiranë, 1998, f. 475, përgatitur nga Shpëtim Mema dhe Afërdita Sharrëxhi). Autorët e këtij botimi e paraqesin këtë dorëshkrim si* "kodik me njoftime për veprimtarinë e kishës ortodokse në krahinën e Gjirokastrës në vitet '60 të shekullit të 18-të". *Kodikë ka edhe në fonde personale, si ai i Ilo Mitkë Qafëzezit. Kodikë origjinalë ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë, në kisha e manastire të vendit, si dhe në biblioteka familjare. Kosta Naço, në shënimet e tij përgatitore për një katalog të plotësuar e të shkencorizuar të kodikëve të Shqipërisë, nga fundi i viteve 1980, vërente se kodikë në gjendje*

dorëshkrimi dhe studime rreth tyre kishin edhe biblioteka e Akademisë së Shkencave, biblioteka e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, biblioteka e Institutit të Historisë.
Nga kodikët e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar mund të përmenden: ***1.*** *Një ungjill me përmasa mjaft të mëdha (59 cm x 38.5 cm), me kapakë prej argjendi të larë me flori, të punuar me mjeshtëri të rrallë artistike* nga Filip e Argjir Athanasi, *në vitin 1755. Ky kodik mban numrin 6325 në inventar.* ***2.*** *Një ungjill tjetër, burimi i të cilit përcaktohet "Shqipëria juglindore", ruajtur* në një kishë në Dishnicë, *me format të mesëm (36.5 cm x 25 cm), i shekullit të 18-të, me kapakë prej argjendi të larë me flori, që shquhet për zbukurimoren elegante. Ky*

kodik ka numrin 5168 në inventarin e muzeut. ***3.*** *Një ungjill tjetër pothuajse me të njëjtat përmasa (36 cm x 26 cm), si* burimi i të cilit përcaktohet kisha e Leusës në Përmet. *Kodiku i takon shekullit të 18-të, ka kapakë të zbukuruar me motive biblike-ungjillore, punuar me ar dhe argjend dhe mban numrin 6687 në inventar. Më hollësisht për këta ungjij informojnë Drishti-Naslazi në librin* "Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri", *2003, f. 134 e vijim.*
Ndër kodikët që gjenden në fondin e manastirit të Shën Gjon Vladimirit mund të veçohet një perikope ungjijsh, me format të vogël (10 cm x 7 cm), që përmban 30

fletë. Ky ungjill, që duhet të jetë jo më i vonët se mesi i shekullit të 17-të, njihet edhe me emrin "Ungjilli i Papa Totasit". *Ka interes të posaçëm sepse është shkruar me alfabet të vetin, me bazë alfabetin glagolitik, me 40 grafema. Sipas Dh. S. Shuteriqit, ky dorëshkrim duhet të jetë më i hershëm se data që i është dhënë. Kodiku vjen nga Polisi ose Miraka, ku* "dihet se deri në mesin e shekullit të 17-të ka ekzistuar një sektë herezie". *Shuteriqi mendon se duhet kërkuar nëse ka në këtë kodik shenja të herezisë. Mund të ekzistojë një lidhje midis omonimit "Totoshi" që ruhet në atë krahinë dhe "Totasi", të dyja me rrënjë "totë", me kuptimin "prift". Më hollësisht njofton për këtë dorëshkrim prof. Dhimitër S. Shuteriqi, në* "Shkrimet shqipe", *Tiranë 1976, f. 91-92.*

Në Bibliotekën Kombëtare, veç "Kodikut të Kostë Beratit", *që i takon vitit 1764 (indeksuar: An.S/22F) dhe përmban përkthime prej shkrimeve kishtare, gjendet edhe përmbledhja e akteve të Kuvendit të Arbënit (ku përfshihen edhe* "Letrat e të mbledhunit e Konçillit Provinciall të dheut s'Arbënisë", *që mbajnë nënshkrimin e imzot Vick Zmajevic-it). Akti përfundimtar i Kuvendit titullohet shqip* "Dekreta e Ligja Baam mbë Sinnodi të Provincie s'Arbënie". *Në ballinë shihet titulli* "Conciλi Provintiaλi o Cunvendi i Arbenit mbeliedhune nde viett gnaimije shtat cint e tre", ndene Clementit i gnimidhietmi pape pertemadhit". *Vepra ka këtë indeks në skedarin e vjetër të Bibliotekës Kombëtare: IV.G.14.*

Kodikë që lidhen me hapësirën historike dhe kulturën kombëtare shqiptare gjenden edhe në bibioteka perëndimore. Vetë "Meshari i Gjon Buzukut", *në sinjaturën burimore të vendit ku ruhet (Bibliteca Apostolica Vaticana), është dorëshkrim i tipologjisë "kodik". Në mesin e viteve 1990, kur u diskutua për një mungesë të përkohshme të këtij dorëshkrimi, në shkrimet e rastit u përmend se në skedën orientuese të bibliotekës ka pasur shenjën / signaturën /* 3-194, *e cila më pas është bërë* 4-244. *Për këtë rast marrin vlerë të dhënat e botuara më herët nga historianët e letërsisë, ndër të cilët le të përmendim librin e* Zef Skiroit (junior) "Storia della letteratura albanese" *botuar nga "Nuova Accademia Editrice" (1959), ku shënohet se* "Meshari" *gjendet me skedën* "R. G. Liturgia, III, 194" / "Raccolta Generale Liturgia" *III, 194. Ky indeks përmendet edhe në botimin kritik të E. Çabejt "Meshari i Gjon Buzukut", Tiranë 1968, vëllimi i parë, f. 7. Në botimin kritik të Namik Ressulit singnatura e kodikut që përmban "Mesharin" nuk përmendet. Një mendim krejt origjinal kanë shprehur në lidhje me alfabetin e "Mesharit" në fillim J. Rrota dhe më pas studiuesi Bardhyl Pogoni, në disertacionin* "Albanian writing systems" /"Sistemet e shkrimit shqip", *Indiana University, 1966:* "These special letters ... used in "Meshari" to represent certain albanian sounds are an invention of Buzuku who modelled

them on the astronomic symbols of the zodiac" / "Disa prej grafemave speciale të përdorura në librin "Meshari" për të shprehur disa fonema të veçanta të shqipes janë modeluar nga Buzuku duke u mbështetur në shenjat astronomike të zodiakut". *Sipas Pogonit, një prej shenjave është simboli i demit (*"taurus"*); kurse një tjetër është simbol i ujorit (*"aquaris"*). Shenja zodiake të ujorit ka përveçuar edhe studiuesi Kosta Naço në disa prej dorëshkrimeve në greqisht. Në një shënim të paindeksuar të tij, përshkruhet shenja ujore që gjendet në* "Kodikun e 53-të, të Beratit", *në të cilin, sipas Naços,* "në të 338 fletët e tij ka vetëm një shenjë ujore". *Kjo shenjë është vizatuar në formën e dy rrathëve progresivë të renditur njëri pas tjetrit, të përshkuar nga një vijë që përfaqëson diametrin e tyre të përbashkët drejtvizor, i cili përmbyllet me* "një kryq latin", *domethënë me një kryq që i takon simbolikisht kishës romane! Një pamje të ngjashme ka shenja astronomike e planetit të Afërditës, por kjo shenjë përmban vetëm një rreth dhe një kryq me brinjë të barabarta (shih edhe: Pohlebkin, V.V.:* "Sllovar mezhdunarodnoj simvoliki i emblematiki", *Moskva 1995, st. 377).*

Eshtë e mundshme që shenjat ujore të jenë bërë pjesë e zbukurimores së shkrimeve ungjillore si një traditë e ardhur prej kohërave të krishtërimit të fshehtë, kur emri i Jezu Krishtit nënkuptohej pas shenjës / vizatimit / të peshkut, që gjendet edhe në disa prej kishave të kryehershme të Shqipërisë. Po mund të jetë dhe thjesht shenjë e letrës.

Në një dorëshkrim të fund të shekullit të 14-të që ruhet në Biblioteca Ambrosiana - Milano dhe mban titullin "Kodiku Greqisht 133", *gjendet një këngë pashkësh dhe një pjesë nga Ungjilli sipas Mateut (27: 62-66), shkruar shqip me aflabet greqisht. Shuteriqi e përmend këtë kodik duke e titulluar* "Ungjilli i pashkëve", sipas ritit bizantin, anonim. *Çmon se është i rëndësishëm sepse përfaqëson dokumentin e parë të njohur shqip në dialektin jugor dhe se që prej këtij dokumenti shqipja e koinesë jugore është shkruar me të njëjtën bazë alfabetike (*"Shkrimet shqipe", *Tiranë 1976, f. 29). Prof. Kristo Frashëri e citon këtë kodik me titullin* "Perikopeja e Ungjillit sipas Mateut" *dhe e njëson me të njëjtën signaturë* "Codex gr. 133" *të bibliotekës Ambrosiana. Sipas prof. Frashërit, teksti shqip përmban pjesën ku flitet për ngjalljen e Krishtit. Në shqip ka një fletë, me 13 rreshta. Duhet të jetë një përkthim shqip i shekullit të 15-të,* "në kohën kur kishat e ritit lindor ishin shkëputur nga Patriarkati i Kostandinopojës dhe ishin lidhur me Romën" *(*"Skënderbeu", *Tiranë 2002, f. 401).*

Në të njëjtën vepër prof. Kristo Frashëri përmend dorëshkrimin ku gjendet "Formula e pagëzimit", duke e paraqitur me titullin "Kodeksi i Pal Engjëllit". *Ky kodik ka 37 fletë, të numërtuara me dorë, dhe përmban krysobulat perando-*

rake bizantine, por në latinisht! "Kodiku i Pal Engjëllit" *gjendet në Biblioteca Laurentiana, me tregues identifikimi* "Reg. 1167". *Ky kodik, përveç formulës së pagëzimit, përmban edhe 13 dokumente historike - krysobula perandorake, bula papnore, dekrete të shtetit të Venetikut, qarkore kishtare, nga të cilat dy kanë për autor vetë Pal Engjëllin (Kristo Frashëri, "Skënderbeu", f. 397). Disa nga titujt kryesorë të listës së dokumenteve të këtij kodiku janë:* "Çështje të liturgjisë kishtare" (nga Pal Engjëlli); "Bula papnore e Piut II drejtuar Pal Engjëllit, kryepeshkop i Durrësit", më 4 nëntor 1463; "Krysobulë e perandorit të Bizantit Mihail për rregullat që zbatohen në qytetin e Drishtit", 25 prill 1293; "Krysobulë e perandorit të Bizantit Isaak Engjellit drejtuar Papë Celestin-it", 14 mars 1194; "Concili dei Dieci për Lekë Spanin, zot i Dukagjinit", 27 qershor 1348, *si dhe letërkëmbime të Engjëllorëve me familje të mëdha dhe personalitete të kohës.*

Një studiues që nuk ka nënshkruar, në "Hylli i dritës", *nr. 7-8, 1930, f. 402-403, në artikullin me titull* "Per rreth botimit të dorëshkrimit shqyp të shekullit të 14-të", *ka veçuar edhe dorëshkrime të tjera ungjillore, që terminologjikisht janë emërtuar "kodikë" dhe që ruhen në biblioteka perëndimore. Veç* "Ungjillit të pashkëve", *që përmendet me të njëjtin burim, si kodik nga ky autor përmendet madje edhe një* "Vjershë e palëçitur e Gavrilit i Dharenjëvet", *vepër e shekullit të 17-të, dialekti i shqiptarëve të Italisë, që ka si tregues burimi:* "Codice Barberini latin. 3454, XLIII, 2". *Në të vërtetë, i njëjti numër reference,* "Codice Barberini Latino 3454", *në pronësi të Bibliotekës Apostolike të Vatikanit, përveçon veprën në dorëshkrim të Lukë Matrangës* "Dottrina cristiana - albanese", *veçse me nën-ndarjen LXIX.*

Shproporcionet që vërehen ndërmjet dorëshkrimeve greqisht dhe atyre latinisht duhen kuptuar duke pasur në konsideratë çfarë ndodhi me kishën e ritualit roman pas Reformës dhe sidomos pas Kundërreformës. Një shumicë dorëshkrimesh të karakterit ungjillor, liturgjik dhe teologjik-filozofik, për t'u lejuar të botoheshin, duhej të paraqiteshin në zyrat epërore të Propagandës së Shenjtë, që kishte autoritetin të jepte lejen e shtypshkrimit. Eshtë i njohur tashmë fati i dorëshkrimit të "Çetës së profetëve", autografi i të cilit mbeti në Raguzë, gjatë udhëtimit të autorit për në Padova, ku do të merrej vendimi për dhënien ose jo të lejes së botimit. Bogdani kishte me vete një kopje të këtij libri dhe kjo i mundësoi dhënien e lejes. Por dorëshkrimi origjinal që ruhet në Dubrovnik dëshmon se veprës së botuar i mungon gati një e katërta, në mos më shumë. Studiuesi i njohur Miroslav Vanino, në librin e tij "Aleksandar Komulovic", *botuar në Sarajevë në vitin 1935, njofton se* "në vitin 1584 ... në Romë u shtypën 500 katekizma në gjuhën shqipe, të porositur prej priftit Duka

Armani, i cili në vitin 1590 u bë peshkop i Shkodrës dhe së bashku me një shqiptar të shkolluar i morën këto libra" / "Na pocetku g. 1584 krenuse vizitatori iz Rima preko Ancone (Jakina), Hvara i Dubrovnika u Albaniju, ponesavsi uz misale i razne knjge jos mnogo naboznih predmeta, kojima ce darivati svecenike i narod. U Rimu su dali otisnuti 500 katekizama na albanskom jeziku. Pratila su ih tri albanca: svecenik Duka Armani, koji je g. 1590 postao skadarski biskup, jedan djak Ilirskog Kolegija i jos jedan skolovani albanac, koji ce toga daka pomagati u poucovanju *(str. 44, vep. cit.). Nuk është e vështirë të çmohet rëndësia e këtij katekizmi të shtypur në 500 kopje shqip, qoftë edhe për faktin se ky tirazh nënkupton ekzistencën e një lexuesi të rëndësishëm, brenda klerit dhe në botën laike. Por për dorëshkrimin kodik nuk dihet asgjë, përveç faktit se shtypshkronja në Romë dhe zyrat e censurës duhet ta kenë pasur doemos në duar. Disa kodikë, që janë përshkruar herët prej studiuesve albanologë, si Pukëvili, nuk gjenden më si dorëshkrime, por diçka ka mbetur prej tyre në formën e një metateksti. Një prej këtyre kodikëve përmban kronika të hershme të Gjirokastrës dhe njihet prej shënimeve që zgjodhi e botoi prej tij Pukëvili. Disa kodikë të tjerë, si ai i Delvinës, gjithashtu njihen pak, për shkaqe të ndryshme.*

Këto të dhëna janë të rëndësishme për të shpjeguar shpërpjesëtimet e dukshme ndërmjet greqishtes dhe latinishtes në dorëshkrimet që ruhen në "Fondin 488" të kodikëve të AQSH. Fryma e reformës, që u zhvillua në kishën perëndimore në shekullin e 15-të, si pjesë përbërëse e Rilindjes Europiane dhe nën ndikimin e saj, nxiti përdorimin e gjuhëve kombëtare në shkrimet e shenjta, ndër të cilat e dhe shqipen, përkrah me latinishten. Por njëherësh kjo frymë nxiti edhe lëvizjen e vlerave kulturore drejt qendrës së lëvizjes humaniste. Fakti që një shumicë dorëshkrimesh ungjillore, latinisht e shqip, sot gjenden në bibliotekat e Perëndimit (Vatikan, Milano, Grotaferrata, Laurentiana) tregon gjithashtu se në ç'drejtim shkonin kumtet e shqiptarëve. Kodikë janë edhe aktet përmbledhëse të së drejtës urbane paraosmane, që u themeluan në periudhën e fisnikërisë arbërore. Njëri prej tyre, ai që njihet me titullin "Statutet e Shkodrës", ruhet në: Venezia, Biblioteca Museo Correr, Mss. Correr 295. Ky dorëshkrim quhet "Codice cartaceo in 8° del secolo 16-simo di 40 carte numerate e 9 non numerate" - "Statuti della città di Scutari", *conservato presso il Consiglio dei Dieci. Me të drejtë I. Kadare vëren se mërgimtarët e parë të botës shqiptare, ata që pas dështimit të rezistencës anti-osmane u detyruan të kërkojnë mbrojtje tek Perëndimi humanist,* "zbritën nga anijet e tyre me armë, veshje, stolira, disa herë kambana të hequra nga kishat e të bartura me anije për të mos rënë në duar të osmanëve", *por, ndoshta, edhe me emblemat, epitafet, kronikat dhe dorëshkrimet*

ungjillore që kishin trashëguar prej të parëve (“L’Altra Albania”, *parathënie, Roma 2003, f. 6).*

Merr një rëndësi të posaçme fakti se kodikë kanë pasur jo vetëm kishat katedrale, mitropolitë, qendrat e rëndësishme kishtare, por edhe kisha e manastire të vegjël e shpesh në mënjanësi ndaj zonave urbane. Një shembull i vlerave informuese etnozakonore dhe kishtare të dorëshkrimeve të këtij lloji është paraqitur nga etnologia Andromaqi Gjergji, në studimin “Kodiku i kishave të fshatit Rëmbec (Korçë)”, të cilit i është bashkëlidhur edhe përkthimi i plotë i lëndës së dorëshkruar. Ky kodik ka titullin burimor: “Katastik i të hyrave dhe të dalave të kishës së shenjtë të Fjetjes së Shën Mërisë /në tekst: të Fjetjes së të tërëshenjtës Perëndilindëses/ dhe kishave të tjera të fshatit Rëmbec”. *Është shkruar kryesisht greqisht, por ka edhe shënime shqip. Shkrimi më i hershëm është i vitit 1815, kurse më i voni i vitit 1902. Studimi i etnologes Andromaqi Gjergji është përfshirë në librin* “Mënyra e jetesës në shekujt 13-të deri 20-të”, *Tiranë 2002.*

Të dhëna të tjera njoftojnë ekzistencën e kodikëve në kisha të fshatrave apo qytezave si Delvina, Boboshtica, Vithkuqi, Voskopoja e Dropulli. Një kodik ka qenë ruajtur gjithashtu në një kishë të Kavajës. Kodikë ka në Fondin 32 (Dosja 118), në Fondin 135 (Dosja 5), në Fondin 132 (Dosjet 27 dhe 29), në Fondin 139 (Dosjet 2, 3, 4, 6, 7, 11 dhe 22), në Fondin 140 (Dosjet 14 dhe 15), në Fondin 141 (Dosjet 3, 14, 43, 48, 95, 107, 126, 129 dhe 131), në Fondin 143 (Dosjet 87, 1967 dhe 1970), si dhe në një shumicë fondesh të tjera, që përbëjnë koleksione dokumentesh të krijuara prej institucioneve të kultit. Vetëm këto përbëjnë 25 kodikë.

Në një kuptim më të gjerë të termit, kodikë janë edhe dorëshkrimet në formën e veprave të plota në gjuhët orientale (persisht, osmanisht dhe arabisht), të koleksionuar në “Fondin 143”. Në këtë fond gjenden 495 vepra të plota të dorëshkruara, disa prej të cilave terminologjikisht janë të ngjashme me ato të “Fondit 488”. Për të përmendur vetëm një rast, do të ishte me interes të krahasohej ndërthurja e së drejtës zakonore vendëse me atë fetare universale në kanonet e nomokanonet e dorëshkrimeve kishtare dhe me erkanamet e bashkësive bektashiane që gjenden në koleksionin e dorëshkrimeve të “Fondit 143”. Edhe “Sixhilati i sherijes së Beratit”, si çdo sixhilat, është një dorëshkrim kodik.

Për kodikët e Shqipërisë të dhëna të detajuara përshkrimore janë dhënë edhe në artikullin e përbashkët dhe të ilustruar të Sh. Sinanit e M. Ahmetit, botuar në revistën “Ekskluzive“, 2003.

“Fondit 488” në dy dekadat e fundme i janë bashkëngjitur disa gjetje të reja të kulturës së shkrimeve të krishtera.

Ndërkaq, për të mos cënuar integralitetin e fondit, më saktë të dokumenteve të një fondkrijuesi, një numër dorëshkrimesh të këtij lloji, që llogariten gati aq sa kodikët e “Fondit 488”, janë ruajtur në koleksione të tjera: fondi i manastirit të Shën Gjon Vladimirit (ende i papërpunuar); fondi i arkipeshkvisë së Drinopolit (Gjirokastrës) - ende i papërpunuar; fondi i arkipeshkvisë së Shkodrës, pjesërisht i përpunuar.

Për fragmentet, të quajtur me këtë term për shkak të ruajtjes së pjesshme, nuk është treguar ndonjë vëmendje e posaçme. Fragmentet nuk u bënë objekt studimi për hartuesin e katalogut të kodikëve të Shqipërisë dhe të skedave / pasaportave informuese të tyre Theofan Popa.

Është interesante të konstatohet se këto fragmente janë ruajtur pranë familjeve me traditë kulture dhe besimi edhe në periudhën e ateizmit shtetëror dhe janë dorëzuar prej tyre në arkiva në dekadat e fundit të shekullit të 20-të.

Fragmentet përforcojnë bindjen se ende ka dorëshkrime të karakterit kishtar në familjet qytetare dhe se hapësira e përhapjes së tyre duhet të jetë më e gjerë. Ne nuk kemi të dhëna për regjistat dhe kodikët e kishave romane në Prizren dhe në vise të tjera në Kosovë, si dhe në bashkësinë katolike të shqiptarëve të Malit të Zi. Ka të dhëna se dorëshkrime të tipit “kodik” që lidhen me botën shqiptare mund të gjenden në arkivin e Kotorrit, si dhe në atë të Dubrovnikut.

Në inventarin e fondit 488, si dhe në disa skeda të tjera për kodikët që ruhen në AQSH, dorëshkrimet biblike, ungjillore dhe liturgjike që janë trashëguar në botën shqiptare janë të pjesshme. Për të kuptuar shkallën e gjerë të mbijetesës së këtyre dorëshkrimeve le të paraqesim në vijim një prej procesverbaleve të mbajtur në vitet 1970 për dorëzimin e kodikëve të identifikuar gjatë ekspeditave në terren. Këto dorëshkrime nuk janë përshkruar në inventarin e fondit 488.

Summary:

The Albania's codices constitute a monumental wealth of the culture and human thought.
The Knowledge of the multiple values in an object and task of the cultural anthropology.
"The Purple Codex of Berat" chronologically represent one of the most ancient version of the New Testament, and is put among the 3-4 earliest in the world together with the codices "Sinaiticus", "Vaticana B", "Sinopensis O", "Rossanensis", "Petropolitanus", "Alexandrinus" and "Vindobonensis".
From seven rare and unique codices written on purple parchment whih have arrived up to our modern times two of them are in Albania.
In the beginning it was the word and afterwards the Holy Writ, the Bible. The tradition of conservation of the manuscripts of the Holy Word in Albania is a part of the cultural identity of the Illyrian-Albanian space.
The tradition of copying of the holy evangelical texts which is testified from the depth of the centuries in the Albanian area has led the scholars up to the thesis of the possibility of the existence of a native school of the church manuscripts, of a school of the paleo-Balkan hinterland which exists along the Syrian-Palestian school, the alexandrin school and that of Constantinople.
The existence of a native of the Holy Writ is connected with other cultural traditions developed in continuity since the ancient times in Albania, especially with those of applied church arts as the mastery of the carving of iconosteses, the iconography and mural painting, the liturgical music, the art itself of building the churches and monasteries.
This is also connected with the inclusion of the Illyrian-Albanian areal in what is called "the Biblical source space" since the first century after Christ.
The evangelists and the first missionaries of Christianity initially adressed to the Hebraic comunities, as it is testified by indirect sources, spread in the paleo-Balkanic zone.
Hebraic comunities, as it is testified by indirect sources, but even by biblical matter itself, there were in Illyricum, too, but separately along the coastal line. Some toponyms of the ancient Albania, including the name of cities Oricum (Jericho) and Finiq (Phoinike) testify to a small Hebraic paleo-geography in this country.
The tradition of the Albanian "scribes" gives to the church manuscripts, along with the values as a contribution to the history of the evolution of the Christian thought, even a source quality, connected with the region.

The Holy Writ which are preserved in Albania show that in this space always has been an important cultural elite which not only knew how to preserve them, to serve in the faith's institutions, but also, morewer, to write them with devotio.
In the Albania's codices are preserved values which cannot be re-created of the applied art (paleography, decorations of calligraphy, miniatures, vignettes, canons). Many of these values of culture belong to the pre-iconographic period and have preceded the tradition of the church mural painting.
The preservation of the codices in Albania in this environment where have passed the strom dna stress of the ages, and where crossed irreconciliable influences expresses once more one of the ethno-distinguishing values of the Albanian people, his inter-religious tolerance even for the today's Albania. Such manuscripts are a part of the cultural identity of the people which has preserved them and make known Albania in the world, add to its reputation.
The biblical-evangelical manuscripts, a part of the early and following Christianity, don't constitute in themselves a national tradition, in the conventional sense of the word. They are expression of the general development and elevation of the Christian thought as part of the history of the human thought in general. But the tradition of preservation and, especially, of copying of the Holy Writ from the natives, in the Illyrian-Albanian space, from the paleochristianity up to now, is a part of the popular cultural tradition.
The antropological science has observed that the writers of the holy word, "the scribes" were masters of one of the most ancient applied arts, of the art of the calligraphy.
The paleographs avaluates the autowriting of these works as a design and graphy. The calligraphy has been considered since some centuries consecultively as a noble cultural mastery. This approaches even more in the popular culture the library of the codices. The embellishment of the initial letters the beauty of the handwriting in general are an expression of the tradition of a cultural mastery which is connected Albanian ethnicum.
The Albania's codices, with some rare exceptions, have remained outside of the attention of the anthropoggical and bibliogical knowledge. Their presentation in international scientific environments during the last years has contributed to the consolidatin of the thought that the Illyrian-Albanian space in the church manuscripts preserved in Albania there is an individuality not only in the technique of the writing, but also in the relations between the biblical canonical world and the laical one.
According to some scholars, the individuality of the native school of the writers

standts out since "The Purple Codex of Berat" in which the God's name, yet considered as untranslatable, somewhere surmounting the taboo, is writen in a particular form which isn't found in some other codex of the same or following time. The church manuscripts preserved in Albania are a testimony of the ecumenical character of the region where they are copied, one the qualities that sets apart in general the Albanian ethnicum along its history.

Burime të këshilluara:

1. "Σψντομοσ ιστορικε περιγραπηε τεσλεραδ μητροπολεοσ Βελεγραδον..."; "Përshkrim i shkurtër historik i metropolisë së Beratit dhe i vendeve që janë nën vartësinë e saj shpirtërore", Kerkyra,1868;

2. "Κατολογοσ του εν ταισ ιεραισ εκλισιασ τισ σψνοικιασ καστρου, πολεωσ Βερατιου τισ μιτροπολεωσ Βελεγραδων ευρισκομενων αρχαι–ων χειρογραφων", e Anthim Aleksudhit (Alexoudes) 1900, botuar në revistën "Deltion tis Istorikis kai Etnologikis Etairias tis Ellados", nr. 5, f. 352-369.

3. "Καταλογοσ των χειρογραφιων κοδικον τησ αγιωτατσ Μητροπολεωσ Αργυροκαστρου ", nga Veis, N., Athinë 1952, vëllimi i 4-të, f. 129-200.

4. Batiffol, Pierre: "Les manuscrits grecs de Berat d'Albanie et le Codex Purpureus *Φ*", Extrait des archives des missions scientifiques et littéraire, edit. Imprimerie Nationale, Paris 1886;

5. Batiffol, Pierre: "Evangeliorum Codex Graecus Purpuraeus Beratinus *Φ*", Mélanges d'archéologie et d'histoire (École française de Rome) 5 (1885): 358-76;

6. Gregory, Caspar René: "Textkritik der Neuen Testamentes", I-III, Leipzig, 1900-1909 / "Studim kritik për Testamentin e Ri".

7. Buchthal, H. & Kurz, O.: "A hand list of illuminated oriental christian manuscripts", edit. The Warburg Institute, London, 1942;

8. Koder, Johannes and Erich Trapp: "Katalog der Griechischen Handschriften in Staatsarchiv zu Tirana", edit. in "Jahrbuch der Österreichischen Byzantinischen Gesellachaft", 17 (1968), 197-214;

9. Koder, J.: "Zur wiederentdeckung zweir Codices Beratini", edit. in "Byzantinische Zeitschrift" 65 (1972): 327-28;

10. Aland, Kurt: "Kurzgefasste Liste der Griechischen Handschriftenn des Neuen Testaments", edit. Walter de Gruyter - Berlind - New York, 1994;

11. Aland-Nestle: "Novum Testamente Graece","Codices graeci et latini", *edit. 1993, Munschen;*

12. "I Vangeli dei Popoli", Rinnovamento nello Spirito Santo, Cita di Vaticano, 2000.

13. Crisci, Edoardo & Sinani, Shaban: "Vangeli di Matteo e Marco", në "I Vangeli dei Popoli".

14. Popa, Theofan: "Katalogu i kodikëve mesjetarë të Shqipërisë"; dorëshkrim, 107 faqe, ruhet në AQSH", Tiranë, 1983-1985.

15. Popa, Theofan: "Pasaporta të kodikëve të fondit 488", dorëshkrim, 120 faqe, ruhen pranë AQSH.

16. Naço, Kosta: "Kodikët dhe vlera e tyre", botuar në "Shkenca dhe jeta", nr. 3, v. 1988, f. 12-15.

17. Naço, Kosta: "Rreth "vendlindjes" së dorëshkrimeve mesjetare të Shqipërisë në gjuhën greke", botuar në "Shkenca dhe jeta", nr. 127, janar 1991, f. 34-35.

18. Mullen, Roderic R.: "Bibliography of the New Testament and Related Manuscripts" - comparison for Manuscripts in Albanian Nacional Archive, katalogued by Theofan Popa, with the "Kurzgfasste Liste" of Kurt Aland; ruhet në "Fondin 488", AQSH, 27 maj 2002.

19. Mullen, Roderic L.: "The Byzantine Text and Its Relation to the Church", AQSH, Fondi 488.

20. Listë (inventar) e kodikëve të "Fondit 488", ruhet në AQSH.

21. "Krishtërimi ndër shqiptarë", Shkodër 2000.

22. "Albanica-1", botim i Bibliotekës Kombëtare, Tiranë 1998.

23. Sinani, Shaban: "Kështjella e virtytit", Tiranë 2001, f. 3-52.

24. Sinani, Shaban: "Arkiva të hapur në shoqëri të hapur", botim i DPA, Tiranë 2002, f. 97-126.

25. Sinani, Shaban: "Kodikët e Shqipërisë - sprovë për periudhizim e klasifikim", në "Kultura popullore", 1-2, 2000, f. 13-43.

26. Sinani, Shaban: "The codices of Albania", në "Albania - a Patrimony of Europeen Values", botim i EU, Tiranë 2000, p. 113-119.

27. Sinani, Shaban: "Kodikët", në "Historia e Shqipërisë", vëllimi I, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2002, f. 351-354.

28. Sinani, Shaban dhe Ahmeti, Musa: "Kodikët e Shqipërisë, thesare të kulturës botërore", në "Ekskluzive", nr. 36, 2003, f. 84-119.

29. Sinani, Shaban: "Miniatura të kodikëve të Shqipërisë", në "Mendimi", 2003/3, f. 44-45.

30. Sinani, Shaban dhe Naska, Kaliopi: "Bëhen të njohur 100 kodikë të Shqipërisë" - "100 Codex de l'Albanie à découvrir", në "Kodikët e Shqipërisë, Tiranë 2003, f. 13-23.

31. Sinani, Shaban: “Beratinus-1 - një referencë themelore në traditën e shkrimeve të shenjta”, në “Kodikët e Shqipërisë”, Tiranë 2003, f. 233-253.
32. Qafëzezi, Ilo Mitkë: “Kostë Berati, linguisti i shqipes, më i vjetri ndër shkrimtarët e Toskërisë (1764-1801)”; ruhet në AQSH, Fondi “Ilo Mitkë Qafëzezi”, D. 21, fl. 4.
33. Qafëzezi, Ilo Mitkë: “Berati i dorëshkrimevet antike - të tjerë autografë të Kavaliotit dhe një dorëshkrim shqip bektashian fenomén”, në gazetën “Drita“, Tiranë, nr. 526-527, datë 16-17 gusht 1938, fl. 3.
34. Ressuli, Namik: “Abeceja e dorëshkrimit beratas dhe abeceja e Thodhër Haxhi Filipit”, në “Leka”, Shkodër, 1938, nr. 4-5, fl. 181-185.
35. Shuteriqi, Dh. S.: “Shkrimet shqipe”, Tiranë 1976.
36. Frashëri, Kristo: “Skënderbeu”, Tiranë 2002.
37. Pogoni, Bardhyl: “Albanian writing systems”, dorëshkrim, tezë doktorate, universiteti i Indiana-s, USA, 1966.
38. Çabej, Eqrem: “Meshari i Gjon Buzukut”, Tiranë 1976.
39. Ressuli, Namik: “Il Missale di Giovanni Buzuku”, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
40. Gjergji, Andromaqi: “Mënyra e jetesës në shekujt 13-të deri 20-të”, 2002.
41. Shehu, G. dhe Xhaja, N.: “Pasqyrë e gjendjes fizike të kodikëve”, ruhet në AQSH, Fondi i DPA, Viti 1989.
42. Stathis, Gr. Th.: “Institut de musicologie byzantine”, në: “Jahrbuch der Österreichischen Byzantinistik”, XVI, Wien 1981 - Internationaler Byzantinistenkongress, akten, I/beiheft).
43. AQSH, “Katalogu sistematik i dokumenteve”, shek. i 6-të deri viti 1831, përgatitur nga: A. Nika, E. Duka, F. Duka, M. Pela, N. Hoxha, V. Kita, V. Paçuka, Tiranë 1979, daktiloshkrim.
44. Pohlebkin, V.V.: “Sllovar mezhdunarodnoj simvoliki i emblematiki”, Moskva 1995.
45. Parrino, Ignatius: “Acta Albaniae Vaticana”, Citta del Vaticano, 1971.

Dr. Shaban Sinani
Drejtor i Arkivit shtetror të Shqipërisë

Dr. Milan Pl. Shuflaj (Šufflay), Acta Albaniae III dhe Balshajt

Milan Shuflaj është një prej burimologëve më të mëdhenj të historisë së Shqipërisë dhe njëherësh studiues i përmasave të jashtëzakonshme të saj. Bashkë me "Illyricum sacrum" të bashkautorëve Farlati (Daniele Farlato) dhe Koleto (Iacobo Coleto), "Acta Albaniae" ose "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia", botuar në dy vëllime nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të Vienës, gjegjësisht më 1913 dhe 1918, përbën bankën themelore të referencave të historisë së popullit shqiptar prej paleokrishtërimit në Rilindjen Europiane (344-1406).
Dy vëllimet e para të "Acta et diplomata" Shuflaj i përfundoi në bashkëpunim me dr. K. Jireçekun dhe dr. L. Taloçin (Thaloczy). Në fakt, megjithëse në këto botime emri i Shuflajt shenjohet i fundmi, dihet se ai bëri udhëheqjen shkencore të gjithë punës. Fakt është se punën për identifikimin, klasifikimin dhe renditjen e dokumenteve të tjera për Shqipërinë paraosmane e vazhdoi vetëm Shuflaj.
Në këtë iniciativë Shulfaj qe i inkurajuar mjaft edhe nga qeveria e Shqipërisë, e cila, siç del nga burimet arkivore, i pati kërkuar atij hartimin e një historie të popullit shqiptar dhe vijimin e kolanës "Acta Albaniae"1.
Në vitin 1931 Shuflaj vizitoi Shqipërinë si mik i oborrit mbretëror. Me këtë rast ai foli në tribunën e parlamentit shqiptar dhe bëri të ditur projektet e tij për dy veprat që qeveria e vendit kishte shprehur interes.
Në fakt, qysh më 18.06.1929, Lumo Skëndo e kishte njoftuar Shuflajn se qeveria shqiptare kishte caktuar një honorar prej 75 mijë frangash zvicerane për përgatitjen e vëllimit të tretë "Acta Albaniae". Më 03.12 1930 ministria e arsimit konfirmon dërgesën e parë të honorarit, 3000 franga, zhvilluar me çek në Banque Commerciale de Bale2. Honorari i ofruar nga shteti shqiptar në funksion të pasurimit të burimologjisë së historisë kombëtare përbën një shifër jashtëzakonisht të lartë. Sipas njërit prej botuesve të publicistikës së Shuflajt, "Izbrani radovi", Darko Sagrak, honorari i qeverisë shqiptare për veprën e Shuflajt, i përllogaritur me kurset bashkëkohore të vlerave monetare, është afërsisht 2 milionë franga zvicerane3, kurse, sipas bashkëbotuesit të vëllimit të parë të kësaj përmbledhjeje, i cilësuar "një prej njohësve

më të përgatitur të trashëgimisë së Shuflajt" (shih: Darko Sagrak, hyrje në "Izbrani radovi"), dr. Musa Ahmeti, me vlerat e sotme honorari çmohet jo më pak se 4 milonë dollarë4.

Nga burime arkivore shqiptare të pakëshilluara nga studiuesit del se Shuflaj e çmonte shumë mbështetjen e qeverisë së Tiranës për iniciativat e tij shkencore. Një prej këtyre burimeve bën të ditur se, megjithëse Shuflaj në fillim të viteve '30 ishte në një moshë relativisht të re, në një moshë të tillë që biologjikisht nuk kishte pse t'ia sillte në mendje vdekjen, i kishte besuar mikut të tij dr. Vladimir Petrovic një testament, me anë të të cilit të drejtat e autorit për romanin historik "Kostandin Balsha", në tre vëllime, nënshkruar me emrin letrar Alba Limi; si dhe për monografitë "Qytete dhe kështjella shqiptare" e "Historia e Shqipërisë së Veriut", i mbeteshin në trashëgimi shtetit shqiptar. Siç shprehet Petrovic në deklaratën e tij noteriale, kjo ndodhi se ishte i "frymëzuar nga ndjenja të thella mirëdashjeje ndaj kombit shqiptar"5.

Ky testament, i përgatitur nga Shuflaj më 1 dhjetor 1930 në Zagreb, iu dorëzua pas vdekjes nga miku i tij Petrovic dr. Tahir Shtyllës, i ngarkuar a.i. i mbretërisë së Shqipërisë në Romë. Në të njëjtën kohë nis edhe interesimi i shtetit shqiptar për burimet dhe punët e Shuflajt për historinë e Shqipërisë. E para u interesua ministria e arsimit, e cila, përmes një letre drejtuar ministrisë së punëve të jashtme më 28.03.1931, vetëm pak ditë pas vrasjes së Shuflajt, vërente se, "me sa kish dekllarue vetë, i ndjeri z. Shuflaj kishte mbledhë në kërkimet e tij të shumta në Raguzë, Venedik e gjetiu, nji sasi mjaft të randsishme të këtyne dokumenteve", të cilat, "mbassi për këto kërkime ka qenë ndihmue financiarisht prej shtetit t'onë, do t'ishte e arsyeshme që të bahen pronë e shtetit"6.

Shuflaj, kur shkroi testamentin, nuk e dinte se vdekjen e kishte aq pranë. Vetë ky fakt dëshmon se ç'vend kishte Shqipëria brenda tij. Këtij dinjiteti fisnik e ndoshta të pashoq i përgjigjet me të njëjtën lartësi sjellja e qeverisë së Shqipërisë. Për të mos i dhënë karakterin e një interesimi që lidhej me marrëdhënie a kontratë detyrimesh, ministria e punëve të jashtme kështillon që me çështjen të merret privatisht Lumo Skëndo, si mik i të ndjerit. Në fakt, qeveria e Shqipërisë asnjëherë nuk e shtroi çështjen e honorarit. Marrëveshja e saj me Shuflajn qe një marrëveshje nderi, "nderi fisnik" dhe e tillë mbeti edhe pas vdekjes. Por, pavarësisht nga kjo, që prej vrasjes misterioze të Shuflajt e deri më sot ka vazhduar e vazhdon një diskutim i gjatë, brenda shkencës shqiptare, kroate dhe më gjerë, sa i takon pyetjes nëse studiuesi kishte filluar të punonte për "Acta Albaniae III" dhe, madje, nëse kjo vepër ishte një prej shkaseve të atentatit.

Çështja u ndërlikua mjaft veçmas pas vitit 1942, kur J. Radonic botoi në Beograd një vëllim dokumentesh për Shqipërinë mesjetare, titulluar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Shqipëria në shekullin XV". Në pikëmapje formale vëllimi i Radonic-it ngjante përpikërisht me "Acta Albaniae I-II". Por në përmbajtje dhe në frymë studiuesit vunë re menjëherë një dallim të madh.

Në veprat e Shuflajt kanë një vend të ndritur familjet patronimike arbërore, fisnikëria në lulëzim e këtij vendi në prag të Rilindjes Europiane. Kjo është aq e theksuar, sa i ka shtyrë disa dijetarë të pyesin me një barrë dyshime se "si mund të shpjegohet albanofilia e tij". Në të vërtetë suksesi i veprës së Shuflajt nuk lidhet me ndonjë albanofili. Shuflaj e meritoi këtë sukses sepse tentoi dhe ia arriti ta shmangte shkencën albanologjike të ish-Jugosllavisë monarkiste nga refuzimi a gjykimi me paraprirje kritike i botës shqiptare, tek pozita objektiviste. Tek Shuflaj fitoi kulti i së vërtetës mbi etnocetrizmin superior.

Ndoshta këtë cilësi të lartë shkence me vizion europeist duhet ta shohim në bashkëlidhje me faktin që pjesa më e madhe e veprave të tij u botuan në Vienë. Ndoshta pati ndikim edhe origjina e tij gjysmë-gjermanike dhe ekzistenca e një shkolle të shëndoshë albanologjike gjermane. Por deridiku mund të ketë ndikuar edhe burimi i tij fisnik, çka e lidhte fort me periudhën e ndritur të fisnikërisë arbërore dhe njëherësh për periudhat më këndej e bënte disi të ftohtë e të pavëmendshëm. Sikurse dihet, në një shumicë veprash Shuflaj nënshkruante Emillianus von Šufflay ose Emillianus de Šufflay.

Në të kundërtën e kësaj prirjeje, vepra e Radonic-it shmangej mjaft nga ekodistanca e domosdoshme në raportin "vetja-tjetri", ndonëse jo rrallë është përfolur se, në fakt, në vëllimin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Shqipëria në shekullin XV" pjesërisht kishte përfshirë edhe lëndë e burime të mbledhura prej Shuflajt. U duk se ky botim bëri të pashpresë çdo mundësi të rishpirtëzimit të "Acta Albaniae III".

Vetë Shuflaj, në publicistikën e tij, i është rikthyer disa herë çështjes së "Acta Albaniae III". Në dy vëllimet e "Veprave të zgjedhura", botuar nga Darko Sagrak e Musa Ahmeti në Zagreb, gjegjësisht më 1999 dhe më 2000, disa herë rezulton si shqetësim i shprehur publikisht. Më 1924 boton në "Obzor" studimin "Sredovjeçna plemena Albanije i Crne Gore". Më 1925, po në "Obzor" boton artikullin "Problemi albanologije". Më 1926 boton autorecensionin "Acta Albaniae" në "Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju". Më 1930 boton studimin "Arbanasi i hrvati", në "Hrvatskom pravu". Një studim interesant është ai që mban titullin "Srednovjecni dinaste Albanije i Crne Gore", botuar më 1924 në "Obzor"7.

Diskutimi për fatin e "Acta et diplomata III", siç rezulton nga burimet arkivore, siç

ka ndodhur jo rrallë në historinë e mendimit shqiptar, për vite me radhë është zhvilluar në mënyrë hipotetike, pa kërkime dhe referenca shterruese në fondet dokumentare, jo vetëm kroate, por edhe shqiptare. Një vështirësi për ta kthyer debatin në terrenin e dijes së dokumentuar mund të ketë qenë shkalla e komunikimit me arkivat. Por kjo, gjithsesi, nuk përbën një arsye të qenësishme dhe përmbyllëse.

Në fillim të këtij viti, gjatë një këshillimi me fondin e ministrisë së arsimit, në dokumentet e vitit 1931, u identifikua një tekst prej 43 faqesh, i cili përmbante tituj aktesh për historinë e Shqipërisë për periudhën 1400-1450. Dorëshkrimi, ndonëse pa ndonjë lidhje tipologjike, gjatë përpunimit arkivistik gabimisht u ishte bashkëngjitur dokumenteve administrative, shkresave dhe letërkëmbimit zyrtar të ministrisë së arsimit. Ky dorëshkrim u bë objekt diskutimi dhe vlerësimi profesional me kolegët kroatë në qershorin e këtij viti. Nga këshillimi me studiues të mirënjohur të fondit të Shuflajt në Zagreb, si dr. Miljenko Pandjic, menjëherë u provua se teksti ishte shtypur me makinën e tij të shkrimit. Po ashtu u provua se autoshkrimi i titullit "Exemptio decimarum, Pamaliti, Propati, Trunoi - 17 iuli 1425" dhe ndërhyrje të tjera me karakter qortues mbi tektin machina-sciptum i përkisnin përpikërisht dorës së Shuflajt8. Gjithashtu u konkludua se ky dorëshkrim gjendej kopje e vetme në arkivat e Shqipërisë, qysh prej vitit 1931. Specialistët mendojnë se Shuflaj mund t'ua ketë dhënë vetë autoriteteve shqiptare dokumentin gjatë vizitës në Shqipëri, si duket për të konsoliduar besimin dypalësh se po punohej me një përfytyrim përfundimtar.

Ekzistenca e këtij dorëshkrimi, që përfaqëson një regest tipik, i cili, sipas të gjitha gjasave, do të shërbente si përmbajtje e lëndës për vëllimin e tretë të "Acta Albaniae" de facto i jep fund diskutimit nëse Shuflaj kishte punuar për këtë vepër apo jo. Në 43 faqe përshkrime të dokumenteve dhe të burimeve të tyre, në formën e një inventari, gjenden 972 tituj njësish, që tejkalojnë përmasat e lëndës së një vëllimi.

Këshillimet për regestin e Shuflajt vijuan duke krahasuar karakterin e dokumenteve të zgjedhura prej tij për vëllimin e tretë "Acta Albaniae", nga arkivat e Venecias, të Vatikanit, të Ancona-s, të Raguzës, të Barcelonës, të Napolit etj., me lëndën që përmbajnë dy vëllimet e para të së njëjtës vepër. U vërejt homogjenitet dhe vijimësi e padiskutueshme logjike dhe metodologjike.

Mbi bazën e këtij regesti u bënë kërkime në fondin personal "Milan Shuflaj", që ruhet

në Arkivin Shtetëror Kroat, dhe i veçuan mbi 4000 fletë dokumente, në të cilat momentalisht mund të pohohet pa ngurrim se gjendet mbi 70 për qind e lëndës së pretenduar prej Shuflajt për "Acta Albaniae III".

Në këtë pasuri dokumentare të paçmueshme gjenden akte me vlerë historike epokale, ndër të cilët më i rëndësishmi është "Statuti i Danjës", me mbi 500 nyje, që vlerësohet si një prej statuteve më të plotë të gjithë qyteteve të vijës bregdetare adriatike, prej Vlorës, deri në Piran e Zadar9.

Nga verifikimi që iu bë fondit të Shuflajt pas zbulimit të regestit nga punonjës të arkivave të Shqipërisë, të arkivave kroate dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm rezultoi gjithashtu se disa prej veprave më të rëndësishme të këtij studiuesi, që janë konsideruar të botuara, në fakt kanë qenë vetëm pjesërisht të botuara. Ndër to veçohen: "Biologjia e fisit shqiptar" (1915), "Historia e Shqipërisë së Veriut" (1924), "Kadastri i Shkodrës" (1926), "Historia e Shqipërisë - prospekt" (1930). Ndërsa disa vepra monografike, thuajse të përfunduara, janë edhe sot e kësaj dite jo vetëm të pabotuara, por, madje, të papërmendura në burimet dhe mjetet e kërkimit arkivor: "Statuti, ipeshkvia dhe qyteti i Durrësit", "Biografi e Pal Engjëllit dhe e Pal Dushmanit të Krajës", "Familjet fisnike shqiptare në mesjetë", "Qytete të tjera mesjetare shqiptare - Shkodra, Tivari, Shasi, Bajeza (Balezzio), Danja, Medua, Ulqini etj"; "Fiset, vëllazëritë, emrat dhe mbiemrat tek shqiptarët në mesjetë", "Mbi emigrimin e shqiptarëve", "Familja dhe fshati shqiptar në mesjetë", "Armët dhe ushtarët shqiptarë në mesjetë", "Harta gjeografike të Shqipërisë dhe të Ballkanit Jugor", ""Shin Sergji e Baku në Bunë", "Shin Gjoni Vladimiri" etj.10.

Në arkivin e Dubrovnikut u gjetën gjithashtu dy dokumente të rëndësishme, që provojnë se "Acta Albaniae III" ishte për Shuflajn jo më një projekt, por një punë në kryerje e përkryerje e sipër. Njëri nga këto dokumente përmban fletë-porosinë e fundme të Shuflajt për dokumente nga ky arkiv dhe rezulton se të gjithë titujt e zgjedhur prej tij pikërisht një ditë para atentatit kanë të bëjnë me Shqipërinë. Kjo fletë-porosi mbeti një vullnet i paplotësuar i dijetarit. Dokumenti i dytë ka të bëjë me një relacion të policisë së fshehtë të ish-Jugosllavisë monarkiste, e cila mbikëqyrte qëllimin e kërkimeve të Shuflajt në Dubrovnik dhe çdo veprim të tij jashtë arkivit11.

Eshtë jashtë çdo dyshimi që në vëllimin e tretë të "Acta Albaniae" një vend të privilegjuar zë historia e Shqipërisë së Veriut, Shkodra si kryeqendër kulturore dhe qytetare, qytetet rreth e përqark saj në gjithë atë hapësirë që njihej me emrin "Albania Veneta", familjet patronimike në përgjithësi dhe Balshajt në veçanti.

Dokumentet që kanë të bëjnë me Balshajt janë me burim Raguzën, Venecian, Vatikanin, Napolin dhe arkiva të tjerë perëndimorë. Në vijim, për të mundësuar një përfytyrim të besueshëm mbi intensitetin e burimeve dokumentare të identifikuar për Balshajt, renditen vetëm disa prej titujve të akteve të ruajtura në arkivin e Venecia-s, madje, më saktë, në fondin e Senatit, në 20 vitet e para të shekullit të 15-të, kur tash-

më kjo brezni qeverisësish të mëdhenj nuk ishte më në apogje:

1. 1407, 12 et 13 martii, Balsa, retentio ambassadorum;
2. 1407, 20 oct., Despotus Serviae in facto Balsae;
3. 1407, 25 oct., Balsa: 1000 ducati pro Albania;
4. 1407, 27 oct., Balsa: Scazo, Rotazo, Crayana;
5. 1408, 18 mai, Balsae, conceditur Budua;
6. 1408, 7 iunii, Pactum cum Balsae ad maritima Antibari;
7. 1408, 15 iulii, Provisoribus Albaniae de Balsa;
8. 1410, 19 aug., Defensio Scutari a Balsae obsessae;
9. 1411, 23 nov., Tregua cum Balscha;
10. 1412, 7, iunii, Balsa a occupato Antibari, il cui castelloe ancora in mano dei veneziani;
11. 1414, iulio, Balsa cum Turcis invadit territoria Veneta;
12. 1415, iulii, Balsa, incendia villa de Calderoni;
13. 1415, 19 novembris, Decisio provisionem Balsae;
14. 1416, 29 aug., Foscolo, provisor Balsae;
15. 1417, 9 iunii, Balsa, vinum Dulcigni, portorium etc.;
16. 1418, 13 mai, Balsa violentia in lacu Scutari;
17. 1420, 25 iunii, Plenipotentia comitis Scutari de tractando cum rege Sicilie, in facto Balsa et Stephani di Balsae; 12.

Regesti i "Acta Albaniae III" përbën një udhërrëfyes të shkëlqyer për të gjetur jo vetëm dokumentet e mbledhura prej vetë Shuflajt, por edhe atë pjesë të vogël që vetëm kishte arritur ta saktësonte ku gjendej. Natyrisht, përshkrimi i dokumentit për Balshajt, Shkodrën dhe rrethinat e saj në "Acta Albaniae III" do të kërkonte studime të vëllimshme.

Përmes këtyre dokumenteve Balshajt inkuadrohen në epokën historike të pragut të pushtimit osman, identifikohen si një familje përfaqësuese fisnikërisë arbërore dhe paraqiten në orientimin e tyre në frymën e humanizmit europian.

Eshtë interesant të vihet re se Shuflaj në asnjë rast nuk i përmend Balshajt me mbiemër të formës sllave (Balsic), siç bën rregullisht me mbiemrat patronimikë sllavë, si Cernojeviqët e të tjerë. Nga krahasimi që u është bërë formës së tejshkrimit të emrave dhe mbiemrave të përveçëm del se patronimi "Balsa" shenjohet jorastësisht në trajtën shqipe. Nga të njëjtat krahasime del se kjo formë nuk mund të lidhet e të shpjegohet me faktin se "Acta Albaniae III", sikurse dhe dy vëllimet e para, u përgatit në latinisht, dhe morfologjia e kësaj gjuhe mund të bënte të tepërt formantet e sllavishtes. Kjo përgënjeshtrohet nga fakti se gramatika latine nuk e pengon aspak Shuflajn të mbajë qendrim krejt tjetër në rastin e mbiemrave të tjerë sllavë, si rasti i Cernojeviqëve. Nëse forma "Balsa" do të kishte qenë e kushtëzuar prej rendit të brendshëm të latinishtes, atëherë do të duhej të gjenim të shkruar edhe "Crnojevi" për "Crnojeviqi", gjë që në të vërtetë nuk ndodh asnjëherë.

Rizbulimi i trashëgimisë së plotë të dokumenteve dhe studimeve që Shuflaj ia kushtoi historisë së Shqipërisë e bën më evidente nevojën që shteti shqiptar të nderojë kontributin e tij. Për hir të së vërtetës do thënë se përpjekja e parë për nderimin e veprës së Milan Shuflajt për Shqipërinë është bërë nga oborri i ishmbretit Zog në vitin 1937, në 25-vjetorin e vetëqeverimit, me ç'rast janë dekoruar disa figura të shkencës albanologjike. Në listën e personaliteteve të përzgjedhur për dekorim gjendet edhe emri i Milan Shulfajt. Por nuk janë shpjeguar ende qartë rrethanat në të cilat dekorata e tij, në momentin e fundmë, u anulua.

Burime dhe bibliografi:

1. "I ndjeri prof. Milan Sufflaj ka qenë marrë që me kohë me kërkimin e dokumenteve historike "Acta et Diplomatae", sidomos me ato që i përkasin historisë s'onë… Për këto kërkime ka qenë ndihmue financjarisht prej shtetit t'onë". AQSH, Fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1931, D. 201, fl. 3. Shih edhe: M. Ahmeti, "Një studim kolosal për historinë shqiptare", Ekskluzive, 29, shtator 2002, f. 88-91.

2. AQSH, Fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, citohet sipas tekstit të botuar nga Sagrak-Ahmeti në "Dr. Milan pl. Sufflay, Izbrani radovi", II, Zagreb 2000, f. 296, letër e Lumo Skëndos drejtuar Shufajt më 18.04.1929. Në letrën e tij të datës 29 korrik 1929 Shuflaj falënderon Lumo Skëndon për shpërblimin e ofruar nga qeveria e Shqipërisë (po aty, f. 297).

3. D. Sagrak - M. Ahmeti, "Dr. Milan pl. Sufflay, Izbrani radovi", II, Zagreb 2000, f. 292. Shënim i D. Sagrak: "Taj cijeli slucaj dodatno komplicira cinjenica da u Svicarskoj postoji u banci deponiran iznos od ca. 75.000 svicarskih zlatni franaka, sto odgovora vrijednosti od ca. 2 milijuna danasnjih CHF".

4. M. Ahmeti, "Një studim kolosal për historinë shqiptare", Ekskluzive, 29, shtator 2002, f. 90: "Parlamenti shqiptar nga buxheti i shtetit e urdhëron ministrinë e arsimit të paguajë … në llogari të dr. Milan Shuflajt shumën prej 75.000 frangash ari, që sot është e barabartë me rreth 4 milionë dollarë".

5. AQSH, Fondi 295, V. 1931, D. 85, fl. 39. Gabimisht fleta e testamentit të dorëzuar në përfaqësinë e mbretërisë shqiptare në Romë, shkruar gjermanisht, me dhënien e së drejtës së autorit shtetit shqiptar për tri veprat e përmendura,

është bashkëlidhur me regestin e dokumenteve të "Acta Albaniae III".

6. AQSH, Fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1931, D. 201, fl. 1.

7. D. Sagrak - M. Ahmeti, "Dr. Milan pl. Sufflay, Izbrani radovi", I (1999): f. 94, f. 71; II (2000): f. 57, f. 59, Zagreb.

8. AQSH, Fondi 295, V. 1931, D. 85, fl. 1-43.

9. Shih edhe: Sh. Sinani: "Statutet e qyteteve mesjetare shqiptare dhe tradita vendore e së drejtës urbane", Ekskluzive, 27, gusht 2002.

10. Sakësimet në lidhje me raportin ndërmjet pjesës së botuar dhe asaj të pabotuar të këtyre veprave janë bërë nga studiuesi M. Ahmeti, i cili ka përgatitur një inventar/bibliografi të plotë të shkrimeve të Shuflajt. Shih gjithashtu edhe: Sh. Sinani, "Kështjella e virtytit", Tiranë 2001, f. 221-225.

11. Cituar sipas M. Ahmetit, "Një studim kolosal për historinë shqiptare", Ekskluzive, 29, shtator 2002, f. 90.

12. Të gjitha referencat janë nxjerrë nga regesti: AQSH, Fondi 295, V. 1931, D. 85, fl. 1-43.

Grant Harris
Biblioteka e Kongresit Amerikan

Gjetja e pamjeve dhe e zërave në faqe të internetit

A presentation by Marylaine Block for River Bend Library system, December 4, 2002. Adapted bu Grant Garden Harris, Library of Congress, with permission from Marylaine Block. (Prezentimi i Marylaine Block për sistemin e Bibliotekës River Bend, 4 dhjetor 2002. I përshtatur nga Grant Harris nga Biblioteka e Kongresit me leje nga Marylaine Block).

I.Përse janë të nevojshme pamjet: Fuqia e paraqitjes vizuele

Why Images Are Necessaru: the Power of Visualization

Flightview.com http://flightview.com/
Internet Picture Dictionary http:// www.pdictionary.com/—kid-level, with cartoon illustrations. Search by keyword or browse by category or letter. (Niveli i fëmijëve, me ilustrime në karton. Kërko me fjalët kyç ose sipas kategorisë apo shkronjës)
Life through Geologic Time http://seaborg.nmu.edu/earth/Life.html
Megapenny Project http://www.kokogiak.com/megapenny/default.asp
Geometry Junkyard http://www.ics.uci.edu/~ eppstein/junkyard/
HandSpeak: A sing Language Dictionary Online http://dww.deafworldweb.org/asl/
20th Century Vox: BBS Oral History
http://www.bbc.co.uk/education/20cvox/audio.shtml
World Atlas of Artificial Night Sky Brightness
http://www.lightpollution.it/vorldatlas/pages/figl.htm
Creativille http://www.creativille.org/—math lessons using simulated building projects (Mësime nga matematika duke përdorur projekte ndërtimi të supozuara)
US Presidential Election Maps, 1860-1996 http://fisher.lib. Virginia.EDU/elections?maps/

II.Mjetet kërkuese: Mekanizmat kërkues dhe udhëzuesit
Finding Tools: Search Engines and Directores

Mekanizmat kërkues Search Engines
Princeton 3D Models Search Engine http:// shape.cs.princeton.edu/search Engine http://shape.cs.princeton.edu/search.html
AlltheWeb http://www.alltheweb.com/—clik on Pictures. Videos, or MP3 Files.
Alta Vista http:// altavista.com/— Clik on Image or MP3/Audio or Video.
Ditto.com http://ditto.com/
Google http://google.com/— click on the image tab before searching.(Kliko shenjën me pamje, para se të fillosh kërkimin).
How Stuff Works http://www.howstuffworks.com/
Lycos Multimedia Search http://multimedia.lucos.com/— Your choice to search through pictures, audio, video, MP3, all. Turn parental controls off or on. (Është zgjedhja e juaj të kërkoni nëpërmjet fotografive, audiove, videove, MP3. Kyçne ose shkyçne çelësin prindëror)
Tutorial Find http://www.tutorialfind.com/

Udhëzuesit
Directories

Digital Librarian: Images http://www.digital-libraryan.com/images.html
Finding Images on the Web: a Tutorial
http://www.bu.edu/library/training/webimages.htm—Ruth Thomas, Art History Bibliographer at Boston University,teaches you about image copyright issues, downloading and inserting images, and the grammar for searching images on different search engines: she also links to large image repositories. (Ruth Thomas, bibliografe e historisë së artit në Universitetin e **Bostonit**, ju mëson për të drejtën e botimeve të pamjeve, nxjerrjen dhe futjen e pamjeve, si dhe mënyrën për kërkimin e pamjeve në mekanizma të ndryshëm kërkues; ajo, po ashtu, ju mundëson të hyni në depozitë të mëdha të pamjeve).

Image Databases http://www.allearn.org/er/tree.jsp?c=43029

III.Disa fjalë kyç kërkuese
Some key Search Words

Oral history tutorial simulation game chart graph
Webcam (or "web cam") photo(or photograph) video audio
3-D gallery exhibit museum map "how to"
visualization demonstration animation radio webcast

IV.Hartat
Maps

Geography Networ http://www.geographynetwork.com/
Google-Directory- Maps http://directory.google.com/Top?Reference/Maps/
Historical Maps Overview http://www.culturalresources.com/Maps.html
Maps arranged by historical period and place. (harta të radhitura sipas periudhës historike dhe vendit)
Map Tech MapServer http://maserver.maptech.com/homepage/index.cfm—"The largest online mapping resource for topographic maps and charts for land, sea, and air. Browse, view, print, and email the maps for free." You can also customize the maps for your specific needs. (Burimi më i madh në Internet i hartave topografike të tokës, detit dhe qiellit. Kërko, shiko, shtyp dhe dërgo me E-mail harta falas).

UT Library Online – Perry Perry- Castaneda Library Map Collection
http://www.lib.utexas.edu/maps/index.html
World Thematic Map Browser http://www.esri.com./data/online/esri/woth-physic.html

V.Kronologjia
Timelines

Google Directory – Timelines
http://directory.google.com/Top/Society/History/Timelines/
Timelines Directory http://topsites.us/Top/Society/History/Timelines/

VI.Klip Artet
Clip Art

100% Free Clipart Collection http://www.top 100-websites.com/clipart/
Classroom Clipart http://Cllasroomclipart.com/
Clip Art Connection http://www.clipartconnection.com/
VII.Burimet e zërit Saund Sources
FindSounds http://www.findsounds.com/

Wav Central: Wav Files and Sound Files Detabase http://www.wavcentral.com/

VIII.Koleksionet digjitale
Digital Collections

Collection Finder: American Memory
http://memory.loc.gov/ammem/collections/finder.html
Digital Library Federation—Public Access Collections
http://www.hti.umich.edu/cgi/b/bib/bib-idx?c=dlfcoll —Search or browse this annotated listing of amazing digital collections, like Columbia's Digital Scriptorium of medieval manustcripts. Duke's Ad Access to over 7000 advertising images, New York
Public Library's Black New York, the Making of America collection (from University of Michigan and Cornell), University of Washington's WTO History Project.(Kërko këtë listë të shënuar të koleksioneve mahnitëse digjitale, të tillë si Skriptoriumi digjital i Kolumbisë me dorëshkrime të periudhës së mesjetës,

shpalljet e Dukës mundësojnë qasje në mbi 7000 pamje të shpallura).
Images of History on the Web http://www.infotoday.com/searcher/may02/mattison.htm
David Mattissons's excellent article about web repositories of historical images, from the May issue of Searcher.
MuseumStuff – Museums Online http://www.museumstuff.com/
Search or browse by category throught thousands of virtual museums, museum gift shops, and exhibits; virtually visit the Lascaux caves, explore the history of marbles, try to decipher the meaning of the ancient object of the day, etc.(Kërko, sipas kategorisë nëpërmjet mijëra muzeve virtualë, lokaleve muze të dhuratave dhe eksponateve në mënyrë virtuale vizito shpellat e Lascaux-it, hulumto historinë e mermereve, provo që ta dëshifrosh domethënien e objekteve të lashta të kohës, etj.).

IX. Kamerat në faqen e Internetit
Web Cams

Google Directory – Webcams – Directories
http://directory.google.com/Top/Computers/Internet/On-the-

Web/Webcams/Directories/?tc=1/

Science Webcams http://www.bottomquak.com/sections.php?op=viewarticle&artid=11
Where you can watch rhinos, hissing cockroaches, the US base in Antarctica, or even move a robot arm to stack blocks or build a model railroad—and lots more besides. (Aty ku ju mund të shihni rinoçerontët, kacabutë freshëllues, bazën e SHBA-ve në Antarktika, madje edhe futjen në lëvizje të krahut të robotit për të grumbulluar blloqe ose për të ndërtuar një model hekurudhe).

WebCam Central http://www.camcentral.com/

X.Radiot dhe videot në Internet
Internet Radio and Video

American Field Guide http://www.pbs.org/americanfieldguide/—Over 1200 PBS video clips of American wilderness. (Mbi 1200 PBS video klipe të botës së egër të Amerikës).
Google Directory – Radio – Guides
http://directory.google.com/Top/Arts/Radio/Resources/Guides/?il=1
Google Directory – Video Shows
http://directory.google.com/Top/Computers/Internet/Broadcasting/Video-Shows/?tc=1/

XI.Muzikë
Music

Amazon http://amazon.com/

Classical Music Search http://la.znet.com/~iwamura/page2.html—"When you know a melody and you do not know its title or composer, this melody search engine will help you." (Kur ju e dini një melodi por nuk e dini titullin dhe kompozitorin, ky mekanizëm kërkues i melodive do t'ju ndihmojë).
Folk Music of England, Scotland, Ireland, Wales, and America
http://www.contemplator.com/folk.html
Music from TV Commercials http:// www.songtitle.info/
If you're wondering what that song was in the commercial you just heard, or if that was really the Ramones or Jesus Jones or Jethro Tull, look no farther.(Nëse

jeni duke menduar se çfarë kënge ishte ajo që posa e keni dëgjuar në treg, ose nëse ishin Ramonët ose Jesus Jones apo Jethro Tull, mos kërko tjetërkund).
Songfacts – fun facts about uour favorite songs http://www.songfacts.com/
OK, no actual music clips here, but… Search or browse by perfomer or song title, or click on randon songfact and get trivia about the song and the perfomer, and lists of songs with similar features or history: "I Don't Like Mondays" generates links to "More songs with days of the week in the title," and "More songs about people who committed crimes."
Wedding Song Library http://www.weddingrommance.com/music/index.html
Search by title or artist for specific songs, or browse throught suggestions for songs and music for specific parts of the wedding and reception (prelude music:garter songs:the mother and son dance, etc.): each title is clickable to the Amazon description of the album the songs is on, which may have song clips.

XII.Fjalimet
Speeches

Great Speeches [in Real Audio] http://www.chicago-lav.net/speeches/speech.html
DOUGLASS: Archives of American Public Address
http://douglassarchives.org/—Texts os major speeches: some vith links to Audio.
Historic Audio Archives http://www.webcorp.com/sounds/index.htm
History and Politcs Out Loud
http://database.library.northwestern.edu/hpol/byspeaker.asp?=t=browse
History Channel Speech Archives
http://www.historychannel.com/speeches/index.html

XIII.Burimet e veshjeve
Costume Resources

Costume Gallery http://www.costumegallery.com/
The Costumer's Manifesto: Your Free One-stop Site Costume Information and Images http://www.costumes.org/— A directory of costume sites: accessories, corsets & underwaer, ethnic dress, military attire, religious garb, costume history by period, and more.(Një udhëzues i faqes së veshjeve, dekoreve, gjoksoreve dhe ndërresave të brendshme, veshjeve etnike, rrobave ushtarake e fetare, veshjeve historike sipas periudhave, dhe të tjera)
The Regency Fashion Page http://locutus.ucr.edu/~cathy/reg3.html

BadFads Museum http://badfads.com/home.html— A look at the more bizarre fashions, collectibles, activities, and events of the past 100 years.

XIV. Disa faqe me pamje të mrekullueshme shkencore
Some Nfty Science Image Sites

E Nature.com.http://www.enature.com./main/home.asp—Inculdes online field guides to birds,butterflies, native plants, seashells, and more. Also, regional wildlife guides by zip code, "bird of the day," "ask an expert," and more.(Përmban udhëzime drejtpërdrejt nga natyra sipas kodit të vendit,"zogu i ditës,"pyete një ekspert," dhe të tjera.
Guide to Poisonous Plants http://www.vth.colostate.edu/poisonous-plants/
An Illustrated Herbal-500 Medicinal Plants and their Properties
http://www.magdalin.com/herbal/ Great pictures and info.For each plant, includes where to find it flowers, medicinal virtues, and modern uses. Browse alphabetically or use cryptic symbols at the bottom of the page to find a search engine, glossary, site map, and more.(Fotografi të mrekullueshme dhe informacione për secilën bimë, përfshirë edhe vendin se ku mund të gjindet ajo, kur lulëzon, kur lulëzon, vlerat mjekësore dhe përdorimi modern. Kërko sipas alfabetit ose përdor simbole lakonike në fund të faqes për të gjetur ndonjë mekanizëm kërkues, fjalorth, faqe të hartave dhe të tjera).
Science Photo Libray http://www.sciencephoto.com/
US Fish & Wildlife Service National Image Linrary http://images.fws.gov/— "The National Image Library contiains still photo images of wildlife, plants, National Wildlife Refuges and other scenics, as well as wildlife, management work."(Biblioteka e Pamjeve Kombëtare përmban fotografi jo-lëvizëse të pamjeve të kafshëve të egra, bimëve, strehimin e kafshëve të egra dhe pamjeve të tjera pitoreske, e të tjera, gjithashtu edhe punën menaxhuese me kafshët e egra").

XV. Pamje të mjekësisë
Medical Images

MedPix Medical Image Database http://medpix.net/medpix/
Bristol Biomedical Image Archive http://www.brisbio.ac.uk/— "A collection of about 8500 medica, dental and veterinary images for use in teaching."(Një koleksion i rreth 8500 pamjeve mjekësore, dentale dhe të veterinës për t'u përdorur në mësimdhënie).

XVI. "Si t'i kërkojmë burimet
" How To" Resources

DoItYourself.com http://repairclinic.com/sitemap.htm

RepairClinic.com http://repairclinic.com/
Lowe's Home Imrovement Warehouse How To Library
http://www.lowes.com/ikn?action=topicSelect&topic=howTo

XVII. Disa burime të mira të artit Some Good Art Sources

Art Images for College Teaching http://images.umdl.umich.edu/a/aict/
ArtCyclopedia:the guide to Fine Art on the Internet
http://www.artcyclopedia.com/
Masters of Photography http://masters-of-photography.com/—Choose a photographer and get sample photos, articles, and references to related books and web sites.
Web Gallery of Art http://www.kfki.hu/~ a virtual museum and searchable database of European painting and sculpture of the Gothic,Renaissance and Baroque periods (1150-1800), currently contaning over 11,ooo reproductions." (Një muze virtual dhe të dhëna të mundshme për t'i hulumtuar në pikturat dhe skulpturat evropiane të periudhës Gotike, Renesancës dhe Barokut (1150-1800), që tash përmban mbi 11.000 kopje)

10 prill 2003

Dr. Isak Shema

Fjalori rëndësishëm i Letërsisë Botërore

("Dictionaire mondiale des littératures", "LAROUSSE", Paris, 2002)

Tradita e botimeve të edicioneve "Larousse" është mjaft e pasur, prandaj edhe rëndësia e tyre për kulturën dhe shkencën botërore është shumë e madhe. Pas botimit të "Fjalorit të letërsive franceze dhe të huaja" ("Dictionaire des littératures française et étrangeres") më 1985, në Paris më 2002 doli nga shtypi vepra enciklopedike kushtuar letërsisë së përgjithshme me titullin "Fjalori botëror i letërsive" ("Dictionaire mondiale des littératures"). Me veçoritë e një vepre të nivelit adekuat enciklopedik, ky është botim i shekullit XXI, në të cilin përfshihen tekste dhe informacione shkencore për zhvillimin e letërsive të mbarë botës, për epokat letrare, për drejtimet dhe rrymat letrare, për gjinitë dhe zhanret letrare, për shkrimtarët më të njohur dhe për krijimet letrare në gjuhët e popujve të ndryshëm, që nga fillimet e shkrimit të gjuhëve dhe të krijimtarisë letrare dhe deri më sot.

Në këtë libër voluminoz, që ka 1017 faqe të formatit të madh enciklopedik, përfshihet informacion i pasur shkencor për letërsitë e zhvilluara në të gjitha anët e botës dhe në këtë mënyrë plotësohet kërshëria e punonjësve shkencorë, por edhe e lexuesve, për dituritë në fushën e artit letrar. Në artikujt e shumtë të fjalorit të letërsisë dhe të shkencës së letërsisë, në njësitë e shumta kushtuar jetëshkrimit dhe krijimtarisë së shkrimtarëve më të njohur, në kapitujt e veçantë dedikuar letërsive nacionale, dhe letërsive të shteteve, të vendeve dhe të regjioneve të

ndryshme, janë paraqitur rrjedhat e përgjithshme të zhvillimit të letërsisë gjatë shekujve dhe arritjet bashkëkohore. Me këto dimensione të gjera hapësinore dhe kohore, duke bërë sintezën e njohurive për letërsitë gjatë mijëvjeçarëve të kaluar, me konceptet bazë të hartimit dhe të botimit, ky është fjalor universal i letërsive. Si i tillë, ky botim është në funksion të përhapjes së diturive dhe afirmon letërsitë dhe kulturat nacionale, shkrimtarët dhe veprat e tyre letrare.

"Fjalori botëror i letërsive", përveç parathënies së drejtuesve të këtij projketi të madh botues: Pascal Mougin dhe Karen Haldad- Wotling, në fillim ka pasqyrën orientuese, ku janë evidentuar tërësitë e lëndës shumë të pasur, të mbarështruara sipas renditjes alfabetike, pasojnë tekstet e përmbajtjeve sintetizuese për letërsitë kombëtare, për autorët, për veprat letrare, për epokat, për shkollat dhe për drejtimet letrare, për mitet temat që lidhen me letërsitë e caktuara, për personazhet letrare, për çmimet letrare, "pa harruar fjalorin e retorikës dhe të poetikës". Paraqitja e lëndës shumë voluminoze është realizuar duke marrë për bazë renditjen alfabetike të letërsive kombëtare dhe të shteteve përkatëse. Në kuadër të 174 njësive përbërëse, në njësinë ALBANIE (Shqipëria), është përfshirë për herë të parë në këtë mënyrë, si e tërësishme, edhe letërsia shqiptare. Autor i tekstit përmbledhës dhe i 27 njësive të veçanta kushtuar shkrimtarëve shqiptarë, është Murat Bejta, professor i Universitetit të Poatijesë. (Université de Poitiers- France).

Në faqen e parë të pasqyrës orientuese, në njësinë ALBANIE, janë radhitur mbiemrat e shkrimtarëve të letërsisë shqipe: Agolli, Arapi, Asdreni, Buzuku, Çaçi, Çajupi, Fishta, Frashëri (N.), Frashëri (S.), Gjerqeku, Kadare (H.), Kadare (I.), Marko, Mekuli, Musaraj, Noli, Pashku, Podrimja, Poradeci, Qosja, Sherifi, Shkreli, Shuteriqi, Skanderbeg (personazh i letërsisë- I.SH), Spasse, Xhuvani, Xoxa.

Në faqet 16 dhe 17, në kuadër të njësisë SHQIPËRIA (ALBANIE) është botuar vështrimi përmbledhës për zhvillimin e letërsisë shqiptare. Teksti vijues përfshin të dhëna për gjuhën shqipe, për fillimet e shkrimit të shqipes, për dokumentet e para, për librin "Meshari" të Gjon Buzukut dhe për shkrimtarët e letërsisë së vjetër shqipe (Lekë Matrënga,, Frang Bardhi, Pjetër Budi dhe Pjetër Bogdani). Pastaj është shkruar për shkrimtarët të cilët në veprat e veta kanë përdorur alfabetin arab (Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Muhamet Kyçyku).

Lëvizja kulturore është njësi përbërëse e vështrimit për letërsinë e Rilindjes. Rilindja Kombëtare Shqiptare si lëvizje e gjerë shtrihet në Shqipëri dhe në kolonitë shqiptare dhe ka ndikim të fuqishëm në emancipimin kulturor, arsimor, politik, shoqëror dhe veçanërisht në zhvillimin e gjuhës shqipe e të letërsisë së romantizmit shqiptar. Formimi i shoqërive kulturore, botimi i gazetave, i revis-

tave, i librave shkollore dhe i veprave letrare, i dha hov të madh zgjimit kulturor. Ndër shkrimtarët e epokës letrare të romantizmit në këtë artikull shquhen: Naim Frashëri, Andon Zako Çajupi, Asdreni, Ndre Mjedja, Filip Shiroka, dhe Luigj Gurakuqi. Romantikët arbëreshë të Italisë: Jeronim de Rada, Gavril Dara i Riu dhe Zef Serembe janë përfshirë në kapitullin Letërsia shqiptare e Italisë.
Në periudhën pas Luftës së Parë Botërore shquhet veprimtaria e Fan S. Nolit (poet, dramaturg, historian, muzikolog dhe përkthyes i disa kryeveprave të letërsisë botërore).

Fillimet e letërsisë sociale

Gjatë viteve `30 spikatet kontributi letrar i shkrimtarëve: Foqion Postoli, Mihal Grameno, Haki Stërmilli, Migjeni, Nonda Bulka, etj. Brezi tjetër i shkrimtarëve përfaqësohet me krijuesit letrarë: Aleks Çaçi, Shevqet Musaraj, Andrea Varfi, Dhimitër S. Shuteriqi, Risto Siliqi, Sterjo Spasse, Zihni Sako.
Për krijimtarinë letrare të viteve të luftës 1941-1944 nuk është është dhënë informacion i veçantë.

Realizmi socalist

Aspekte të zhvillimit të letërsisë së sotme shqipe në Shqipëri pas Luftë së Dytë Botërore janë përmbledhur në tekstin me nëntitullin Realizmi socialist. Shkrimtarët, të cilët i përkasin kësaj periudhe letrare, sipas renditjes që bën autori i këtij shkrimi enciklopedik, janë: Ismail Kadare, Sabri Godo, Spiro Çomora, Llazar Siliqi, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Fatmir Gjata, Jakov Xoxa, Sterjo Spasse, Shevqet Musaraj, Ali Abdihoxha, Elena Kadare, Sulejman Pitarka, Besim Levonja, Naum Prifti, Teodor Laço, Kolë Jakova, Loni Papa, Ruzhdi Pulaha dhe Agim Cerga.

Letërsia shqiptare e Italisë

Në vazhdim është shkruar për Letërsinë shqiptare të Italisë, që bën një njësi të posaçme. Përfaqësuesit kryesorë janë: Jul Variboba, Jeronim de Rada, Gavril Dara i Riu, *Anton Santori, Vinçenc Stratikoi dhe Zef Serembe. Ndër krijuesit e fazave vijuese përmenden : Guisepe Schiro dhe Salvatore Braili.*

Letërsia shqiptare e Kosovës

Në vështrimin enciklopedik për letërsinë shqiptare përfshihet edhe njësia e veçantë
Letërsia shqiptare e Kosovës, ku janë paraqitur aspekte të zhvillimit të letërsisë

në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Shkrimtarët e kësaj pjese të letërsisë shqipe, të prezentuar në këtë njësi, janë: Esad Mekuli, Josip V. Rela, Rexhep Hoxha, Murat Isaku, Hivzi Sulejmani, Sitki Imami, Tajar Hatipi, Zekeria Rexha, Hasan Vokshi, Azem Shkreli, Enver Gjerqeku, Fahredin Gunga, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja, Din Mehmeti, Jakup Ceraja, Muhamed Kërveshi, Musa Ramadani, Beqir Musliu, Anton Pashku dhe Skënder Sherifi ("një shkrimtar shqiptar frankofon"). Në vazhdim shkruhet për zhvillimin e kritikës letrare dhe prezentohen këta kritikë letrarë: Vehap Shita, Hasan Mekuli, Agim Vinca, Sabri Hamiti dhe Rexhep Qosja.

Kjo është ecuria e përgjithshme e mbarështrimit të përmbajtjes së tekstit për letërsinë shqipe në "Fjalorin botëror të letërsive". Sigurisht ka edhe shumë çështjë për t`u shqyrtuar, varësisht nga këndi i vështrimit kritik. Në fillim u dha lista e shkrimtarëve, për të cilët është hartuar tekst i veçantë, pra janë trajtuar zëra për sejcilin autor sipas modelit të botimit në tërësi. Madhësia e zërave është megjithatë e ndryshme: kemi zëra të vegjël, zëra të mesëm dhe zëra të mëdhenj. Për çdo zë duhet të bëhet vlerësimi i posaçëm dhe adekuat. Njëkohësisht janë dhënë emrat e shkrimtarëve të cilët janë përfshirë në tekstin e tërësishëm të njësisë ALBANIE (Shqipëria).

Vështrimi kritik lidhur me hartimin e këtij teksti enciklopedik për letërsinë shqiptare në tërësi, për mënyrën e mbarështrimit të lëndës, për prezentimin e këtillë të shkrimtarëve shqiptarë, për përfshirjen e veprave, të fakteve relevante, për informacionin shkencor të domosdoshëm, sintetik dhe objektiv, për atë se sa është realizuar synimi i trajtimit shkencor, duke pasur për bazë vlerësimet e sotme të shkencës së letërsisë, dhe më në fund cilat janë arritjet dhe kufizimet e këtij angazhimi, për të afirmuar në mënyrë dinjitoze dhe me përgjegjësi profesionale dhe shkencore letërsinë shqipe në suazat kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshin edhe vërejtjet e duhura.

Në këtë "Fjalor botëror të letërsive", me madhësinë adekuate të zërave, është dashur të përfshihen edhe shkrimtarët shqiptarë: Jeronim de Rada, Faik Konica, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi, Martin Camaj, etj., sepse janë personalitete të njohura shumë mirë jo vetëm nga bota letrare dhe shkencore shqiptare por edhe më gjerë. Pos këtij plotësimi ka arsye të rishqyrtohet dhe të rivlerësohet prania e shkrimtarëve dhe e veprave të tyre, si edhe të analizohet çështja e mbarështrimit të lëndës si tërësi dhe në disa paragrafë. Shprehim bindjen se lënda e vështrimit sintetik për letërsinë shqipe është dashur të shtrihet në aspektin kompozicional, duke marrë për bazë periudhat letrare: letërsia e vjetër, romantizmi, etj. Disa shkrimtarë dhe kritikë letrarë të njohur nuk janë përmendur askund, disa të tjerë sigurisht s`ka pasur asye të përfshihen fare. Shkrimtarët e anatemuar më parë, siç është e njohur, tani janë kthyer në historinë e letërsisë shqiptare dhe si të tillë e kanë vendin e vet edhe në botimet enciklopedike. Pas të gjitha ndryshimeve që kanë ndodhur në jetën shoqërore, kulturore dhe letrare në Shqipëri, që nga fillimi i viteve `90 dhe deri më sot, metoda letrare e realizmit socialist nuk zbatohet më, prandaj nuk justifikohet vënia e nëntitullit po me këtë formulim në vështrimin për letërsinë e krijuar në Shqipëri. Kjo nuk i përgjigjet as zhvillimeve të sotme të letërsisë dhe as ecurive të studimeve historike letrare. Është dashur të evitohet përsëritja e emrave të njëjtë të disa shkrimtarëve dhe në kuadër të asaj hapësire tekstore, sipas vlerësimit objektiv, të zënë vendin e duhur emrat e shkrimtarëve të tjerë.

Pas analizës së gjithanshme dhe të hollësishme të tekstit në tërësi dhe të gjitha zërave që përfshihen në këtë fjalor, vështrimi kritik në disa aspekte do të plotësohet dhe më shumë.

Duke përfunduar këtë shkrim, me rastin e përurimit të "Fjalorit botëror të letërsive", vlerësojmë se kjo vepër ka rëndësi të madhe për letërsinë, për kulturën dhe për shkencën e letërsisë.

10 prill 2003



Dr. Don Lush GJERGJI

Bija shqiptare - Nëna e botës - tani Shenjtëresha e Dashurisë Nëna Tereze /1910 - 1997/

"E lumja ti që besove se do të plotësohet çka të qe thënë prej Zotit" /Lk 1, 45/.
SHEKUJT E PRITEN DHE PËRGATITEN, NE E PËRJETUAM.

Për ta kuptuar njeriun si qenie personale, familjare, shoqërore, kombëtare, fetare, kulturore lypset njohur rrethin, ambientin, kontekstin jetësor, sepse pa këto tipare dalluese njeriu humb disi tërësinë, rrënjet, mbetet në "ajër", pa identitet dhe personalitet bazor.

Kush ishte Gonxhe Bojaxhiu?

Bija e Kolë Bojaxhiut, me prejardhje nga Prizreni, dhe Drane lindur Bernaj – Bojaxhiu, nga Novosella e Gjakovës, por edhe më tepër bija e krishtërimit tonë dymijëvjeçar , e traditës, kulturës dhe martirizimit të popullit shqiptar.

Përse ajo lindi në Shkup?

Familja e Gonxhe Bojaxhiut u shpërngul nga Prizreni në Shkup për shkaqe të përnd-

jekjeve dhe masakrimeve turke kundër shqiptarëve, veçmas shqiptarëve katolikë; për shkaqe të epidemisë, sidomos të kolerës, që e përgjysmojë popullatën e Prizrenit gjatë viteve 1850 – 1855, si dhe për shkaqe të kërkimit të tregjeve më të mëdha.

Kush ishin prindërit e saj?

Kolë Bojaxhiu /1872-1919/ ishte tregtar i njohur, ndërtimtar, muzikant, poliglot, patriot i shquar, por mbi të gjitha bamirës dhe "babë" i shumë të varfërve të Shkupit dhe të rrethinës. Angazhimin e tij për drejtësi dhe barazi e pagoi me jetë, qe helmuar në Beograd, sepse i mbronte të drejtat themelore të njerëzve të pambrojtur, sidomos të shqiptarëve.

Drane Bojaxhiu (1889-1972) ishte grua e mirë, shtëpiake e kujdesshme, nënë e zellshme dhe shumë e përshpirtshme, shpirt dhe zemër për çdo nevojtar, edukatorja e parë e Gonxhe Bojaxhiut.

Familja Bojaxhiu pati edhe dy fëmijë të tjerë : Lazër Bojaxhiu (1905-1981) dhe Age Bojaxhiu (1908-1973).

Në çfarë rrethana lindi dhe u edukua Gonxhe Bojaxhiu?

Ajo lindi më 27 gusht 1910. (disa pohojnë më 26 gusht), gjatë sundimit turko-

otoman, në një ambient të përzier etnikisht dhe fetarisht. Katër vitet e para të shkollës fillore i kreu shkollën katolike të "Zemrës së Krishtit" në Shkup, katër vitet të tjera dhe gjimnazin në shkollën publike shtetërore po ashtu në Shkup. Atë së pari, familja, pastaj famullia, e edukuan për dashuri flijuese dhe dhuruese, për vëllazëri të gjithmbarshme, për shërbim ndaj Zotit dhe të afërmit, sidomos ndaj atyre që vuanin në trup apo në shpirt.

Si erdhi deri te thirrja rregulltare?

Gjashtë vite "luftoi me Zotin", prej moshës 12 deri në atë 18 vjeçare, dhe pas shumë këshillimeve, lutjeve, shtetimeve të rregullta në Letnicë, së fundi vendosi : "DUA TË BËHEM MOTËR MISIONARE PËR T'I SHËRBYER TË VARFËRIT E BOTËS".
/Letnicë, 14 gusht 1928/.

Pse shkoi në Kalkutë, në Indi?

Sepse, si e re, kishte lexuar dhe dëgjuar në Shkup prej etërve jezuitë, që kishin misonarë në Kalkutë dhe më gjerë në Bengali /Indi/, mbi mjerimin , varfërinë, gërbulën si dhe mbi ndasitë fetare, kastore, gjinore, racore, dhe më s'mund të ishte e qetë, por dëshironte të jetonte me ta dhe të vepronte në mesin e tyre.

Si udhëtoi deri në Kalkutë dhe kur mbërriti atje?

Udhëtimi për Kalkutë u zhvillua në tri faza : me tren Shkup – Zagreb /26 shtator 1928/, prapë me tren Zagreb –Dublin /13 tetor 1928/ dhe së fundi me anije Dublin – Kalkutë/ prej 1 dhjetorit deri më 6 janar 1929/. Në një mënyrë ky udhëtim simbolizon dhe parajalmëron tri fazat e saja jetësore, si Gonxhe Bojaxhiu /1910-1928/, Motra Tereze /Loretos /1929-1950/ dhe Nëna Tereze – Misionare e Dashurisë /1950-1997/.

Këto tri përiudha jetësore përputhen me tri virtytet hyjnore: FEJA, SHPRESA dhe DASHURIA.

Faza e parë - 18-vjeçare, karakterizohet me KËRKIME. Gonxheja, së pari në gjirin familjar gjithnjë kërkonte prej prindërve, babit Kolë dhe nënës Drane kuptimin e jetës dhe domethënien e veprimit. Më vonë këtë kërkim e kishte vazhduar edhe në bashkësinë famullitare të "Zemrës së Krishtit" në Shkup, së bashku me rininë katolike, por edhe me të gjithë të tjerët. Kërkonte në brendi dhe në thellësi psehin për shumë, nuk ndalej vetëm në vrojtime dhe konstatime, por gjithnjë hulumtonte, gjurmonte, analizonte…

Edhe pasi ishte vendosur për thirrjen rregulltare, si motër e Loretos, ajo nuk

ndalej me kaq. Kërkonte vullnetin e Zotit, Zotin, nëpërmjet njeriut, dhe në njeriun Vëlla – Motër – ZOTIN. Gjithnjë kërkonte dhe gjithnjë gjente Zotin në çdo njeri, dhe mu për këtë ishte aq e lumtur, më e lumtura në botë "sepse 24 orë në ditë jetoi dhe veproi me Zotin, për Zotin, me njeriun, për njeriun".
Kërkimi i saj vazhdoi gjatë tërë jetës, në çdo hap dhe kënd të botës, në çdo mënyrë dhe rrethanë jetësore, me çdo mjet dhe mundësi, me një qëllim të vetëm; : Që njeriu – njerëzimi mos të pësojë, por të jetojë, mos të urrejë, por të dashurojë, mos të vdes por të jetojë tani dhe në amshim. Syri, mendja dhe zemra e saj e madhe ishte gjithnjë në kërkim.
Për Nënën Tereze të besosh, domethënë të kërkosh. Kërkoi dhe mjekoi të ligat e mbarë botës, si të varfërve, ashtu edhe të pasurve, duke dashuruar dhe dhuruar Dashuri – Zotin çdo njeriut.
Pas përgatitjes për jetën rregulltare, noviciatë apo rishtare në Darjeeling /1929-1937/, ajo për pak kohë punoi si infermjere, kreu studimet universitare histori dhe gjeografi dhe punoi si profesoreshë, më vonë edhe si drejtoreshë e shkollës së mesme të Motrave të Loretos, St. Mary në Kalkutë.

Pse quhej motra Tereze e Loretos?

Sepse atëherë ishte tradita dhe ligji kishtar i ndërrimit të emrit të pagëzimit me ndonjë emër të ri në rregulltari. Gonxhe Bojaxhiu e ndërroi emrin e pagëzimit në atë të Motra Tereze e Loretos, sepse ishte anëtare e bashkësisë rregulltare të motrave që quheshin "Motrat e Loretos". E ndërroi emrin për ta ndërruar së pari vetveten, jetën dhe veprimtarinë e saj, pastaj Kalkutën, Indinë, botën mbarë.
Afro 20 vjet e mësonte rininë e Klakutës, e edukonte me fjalë, mësime, shembuj, jetë, etj. gjithnjë e udhëhequr nga fuqia e fesë dhe frymëzimi i dashuirisë. Mirëpo as kjo nuk e kënaqte. Të gjithë e donin dhe e nderonin, e admironin, mrekulloheshin me jetën dhe me veprimtarinë e saj, ndërsa ajo gjithnjë kërkonte, vepronte dhe e pyeste veten para Zotit dhe para ndërgjegjes: Kush jam unë? Çka kërkon dhe pret Zoti prej meje? Çka duhet të bëj unë këtu dhe tani për këta njerëz, për mbarë Kalkutën, Indinë, për mbarë njerëzimin?
Nga kjo FE – KËRKIM – shqetësim kreativ, nga ky VEPRIM –Angazhim që ishte Shpresa e saj e madhe dhe e pathyeshme, lindi faza e tretë : NËNA TEREZE MISIONARE E DASHURISË, dhurimi dhe flijimi si shprehje e vazhdueshme dhe e plotë e DASHURISË.
Kërkimi / feja/, angazhimi apo veprimi / shpresa/ dhe dhurimi apo flijimi / dashuria/ ishin dhe mbesin shtyllat, në të cilat ajo mbështeti mbarë jetën dhe tërë veprimin – flijimin për ta mahnitur njerëzimin si Nëna e Dashurisë.

Sa kohë jetoi dhe veproi si motër e Loretos në Kalkutë?

Prej vitit 1929 deri në vitin 1950, kur përfundimisht mori lejën e themelimit të bashkësisë së re rregulltare "MISIONARET E DASHURISË". Këto tri faza jetësore janë konteksti jetësor i saj, dhe pa këtë ajo s'mund të kuptohet, dhe më pak të imitohet.

Çka bëri Nëna Tereze për Kalkutën, Indinë, botën?

Asgjë dhe gjithçka. Me fuqinë e fesë dhe me frymëzimin e dashurisë, vërtetoi dhe dëshmoi se i vetmi mjekim për trup dhe shpirt, për varfëri, sëmundje, gërbulë, vetmi, për pleq, fëmijë dhe rini, për të këqiat e botës së pasur dhe të varfër, për të gjithë është DASHURIA VEPRUESE ose NË VEPRIM.

Ajo së pari i përballoi të ligat e Kalkutës, më vonë edhe të Indisë, së fundi edhe të mbarë botës, dhe ia doli, i tejkaloi të gjitha ndasitë, dallimet, përkufizimet kombëtare, fetare, gjinore, racore, kastore… duke e pasur si pikënisje dhe si përfundim të çdo veprimtarie binomin ZOTI dhe NJERIU. Për të Zoti dhe njeriu ishin të pandarë, sepse ajo ishte mbi të gjithë që të jetë dhe të mbetet NËNA E TË GJITHËVE.
Për të bërë të gjitha këto vepra bamirësie, Nëna Tereze ka themeluar: MISIONARET E DASHURISË /1950/, VËLLEZËRIT MISIONARËT E DASHURISË /1963/, BASHKËPUNËTORËT E NËNËS TEREZE /1969/, MISIONARET E DASHURISË –DEGA KONTEMPLATIVE /1976/ dhe VËLLEZËRIT E FJALËS – RREGULL MESHTARAK / 1984/.

Çka kemi ne prej saj?

Me Nënën Tereze edhe një herë ndriçoi dhe lulëzoi krishtërimi ynë 2000 vjeçar martir, dialogu ndërfetar shqiptar krishtero-mysliman, dialogu ndërkishtar katoliko-ortodoks, tradita bujare e mikpritjes dhe e bamirësisë, ndihma ndaj të varfërve, strategjia paqësore - jodhunuese, me pak fjalë vlerat tona shekullore të fisnikëruara dhe të begatuara me përvojën madhore të Nënës Tereze. Jeta kushtuar Zotit, Kishës, njeriut, dha fryte të mrekullueshme sidomos për krijimin e kulturës së jetës dhe qytetërimin e dashurisë. Ajo në vitiun 1979 na ngriti në piedestalin

e Nobelizmit për Paqe, na paraqiti dhe nderoi anekënd botës si ambasadore e popullit shqiptar, ndërhyri vendosmërisht për mbrojtjen dhe shpëtimin e Kosovës te Papa Gjon-Pali II, Bill Clintoni dhe shumë personalitete të tjera botërore.
Me rastin e Shpërblimit Nobel për Paqe, së pari, gojarisht, pastaj edhe më shkrim para mijëra gazetarëve, ma dha këtë porosi në gjuhën tonë shqipe:

Oslo, 10/ 12/ 79

"Une gjithmon e kam në zemër popullin tem Shqiptar. Shum luti Zotin qi Pagja e Tij të vijn në zemrat tona, në gjitha familjet tona, në gjith botën. Lutnu shum për fukarat e mij – dhe për mua dhe motrat e mija.
Une lutem për juve".

M. Teresa Bojaxhiu

Me rastin e pajtimeve të gjaqeve në Kosovë dhe në diasporë gjatë vitit 1990 me dorë e shkroi ndër të tjera këtë porosi në gjuhën shqipe :
"Gjithmonë shpirtnisht jam e lidhun në uratë dhe dashni me popullin tem Shqiptar, sidomos në kohë të vështira. Mbas shumë hjekave dhe rreziqeve, me gëzon pamase lajmi i pajtimeve. Urime rinisë Shqiptare kosovare që e nisi këtë vepër, si dhe të gjithë atyne që marrin pjesë në këtë punë të madhe dhe shenjte…."

Në Krishtin
M. Teresa MC
3 Maj 1990

Çka kemi ne me beatifikimin apo lumturimin e Nënës Tereze?

Shumë. Sepse, do të jetë Shenjtëresha e parë Shqiptare edhe zyrtarisht e pranuar dhe e shpallur nga ana e Selisë Shenjte; ajo që bota e shpalli NËNË UNIVERSALE dhe SHENJTËRESHË E GJALLË e mbarë njerëzimit.
BIJA SHQIPTARE, NËNA E BOTËS, TANI EDHE SHENJTËRESHA E DASHURISË, ja NËNA JONË TEREZE. Ajo do të lutet dhe do të ndërmjetësojë për ne para Zotit, ndërsa ne do të mundohemi të jemi bijtë dhe bijat e saja në jetë dhe në veprim.

Porosia apo testamenti shpirtëror i Nënës Tereze për ne?

"Pa dashuri dhe flijim jeta s' ka kuptim" dhe "Vetëm dashuria do ta shpëtojë botën".
Duke i përngjarë Nënës së madhe, atë do ta nderojmë më së shumti, veten do ta ndihmojmë, botës do t' ia dëshmojmë se ajo ishte dhe mbetet Nëna jonë, simboli dhe ideali ynë, ndërsa ne tashmë e kemi gjetur rrugën e paqes, të pajtimit, të faljes, të vëllazërisë, të bashkëpunimit dhe bashkëjetesës me të gjithë duke krijuar kështu me të dhe si ajo bashkimin në dallime.
Nga goja dhe zemra e plotë lind urata spontane : NËNA TEREZE LUTU PËR POPULLIN SHQIPTAR, PËR KISHËN TONË, PËR BOTËN MBARË! Amen.

Veprat e Don Lush Gjergjit mbi Nënën Tereze:

Nëna jonë Tereze, shqip, 1980; 1990; kroatisht ,1982;1990; sllovenisht , 1983; italisht, 1983; 1985, 1988; frëngjisht, 1985; spanjollisht, 1988; hungarisht, 1990; anlisht, 1992.
Lule për Nënën, shqip, 1986; italisht, 1987.
Dashuria në vepër: Nëna Tereze, shqip, 1992; kroatisht, 1995.
Gonxhja jonë – Nëna e botës, 1998.
Madre della carita', italisht, 1990, ribotohet për çdo vit; anglisht, 1991; frëngjisht, 1993; spanjollisht, 1993; polakisht, 1994, gjermanisht, 1995; shqip, 2000.
Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza, Poezi dhe Uratë, zgjodhi: Dr. don Lush Gjergji, 1998; 2000.
Vivere amare testimoniare, La spiritualita' di Madre Teresa, dy vëllime, italisht, 1995, ribotohet për çdo vit; anglisht, 1998; polakisht, 1999.
Zivjeti s Kristom, kroatisht, 1997.
Ljubiti s Marijom, kroatisht, 1997.
Svjedociti s Crkvom, kroatisht, 1998.
Zraka Bozje Ljubavi, kroatisht, 1998.
L' amore in azione. Madre Teresa, italisht, 2002;2003; polakisht, 2002; 2003; litvuanisht, 2003.
Bog ljubi danas preko nas, kroatisht, 2003.

10 prill 2003

Nehat Krasniqi

Fjalë rasti

Materiali bibliotekar që kemi zgjedhur për këtë ekspozitë, është vetëm një pjesë nga thesari i trashëgimisë kulturore të shkruar që ruhet në trezorët e Sektorit të Koleksioneve të Veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ky sektor u themelua në vitin 1984 dhe detyrë themelore e tij është që të hulumtojë, të përpunojë, të jap në shfrytëzim, të prezantojë dhe të ruajë materiale jolibra, të cilat dallohen nga koleksionet themelore bibliotekare, si për nga vlera dhe rëndësia e tyre kulturore, shkencore, historike dhe muzeore, po ashtu edhe për nga vlera materiale. Me një fjalë, ka detyrë të kujdeset për materiale të cilat paraqesin kujtesën e popullit të Kosovës. Ky sektor numëron 1819 tituj librash të vjetër e të rrallë, 294 tituj periodiku të rrallë, 653 vëllime dorëshkrimesh orientale në gjuhën arabe, osmane, persiane dhe shqipe me grafi arabe, dy legate (biblioteka personale të dhuruara), 1724 harta dhe atllase gjeografike, si dhe materiale të tjera që i përkasin koleksionit të muzikaljeve dhe fono-dokumenteve dhe koleksionit të foto-dokumenteve dhe materialit filmik. Këto dhe materiale të tjera që posedon Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës janë një pasqyrë e përafërt e përpjekjeve të vazhdueshme të popullit shqiptar për të ecur përpara në fusha të ndryshme të dijes dhe të arteve, si dhe në ngritjen kulturore përgjithësisht. Kjo rrugë, siç dihet, nuk qe aspak e lehtë, siç nuk qe i lehtë rrugëtimi dhe zhvillimi historik i këtij populli. Në këto materiale reflektohet qartë kryqëzimi i linjave ndërlidhëse midis Perëndimit dhe Lindjes dhe interferenca e dy kulturave të mëdha, të asaj perëndimore të krishterë dhe të kulturës orientale islame në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare gjatë shekujve.

Andaj, si të tilla disa nga këto materiale tejkalojnë kufijtë e kulturës kombëtare shqiptare dhe paraqesin vlera të trashëgimisë kulturore botërore.

Kosova është ndër vendet më të pasura me krijimtari dhe trashëgimi vlerash kulturore, por luftërat e shpeshta dhe mugesa e lirisë, kanë shkaktuar zhdukjen dhe tëhuajsimin e pjesës më të madhe të vlerave kulturore të shkruara dhe të tjera. Le të kujtojmë dëmet që solli në këtë drejtim lufta e fundit në Kosovë, si dhe faktin se në shumicën e koleksioneve të dorëshkrimeve që sot ruhen nëpër bibliotekat dhe institucionet kulturore shkencore të rajonit të Ballkanit dhe më gjerë, ka qindra dorëshkrime që janë krijuar apo trashëguar në Kosovë.

Në rrethanat e reja të krijuara në Kosovë pas luftës çlirimtare, janë bërë dhe planifikohen të bëhen përpjekje profesionale që të ndërpriten mundësitë e varfërimit të mëtejmë të këtij vendi nga ky aspekt. Si një nga hapat e rëndësishëm që kemi filluar në këtë drejtim, është aksioni i regjistrimit të përgjithshëm të dorëshkrimeve orientale në Kosovë. Për këtë projekt të rëndësishëm, i detyrohemi Zyrës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, për mbështetje financiare, dhe zotit Michael Mc Clellan, për mirëkuptim. Disa nga dorëshkrime**t** që janë ekspozuar këtu, i kemi sjellë nga terreni, pikërisht, gjatë këtij aksioni.

Dorëshkrimet që kemi zgjedhur për këtë ekspozitë modeste si dhe të tjerat që kemi në koleksionin tonë, janë burime relevante për historinë e kulturës në Kosovë gjatë periudhës së sundimit osman. Ato ofrojnë informacione me vlerë për institucionet e asokohshme arsimore të Kosovës, ku edhe janë shkruar një numër sosh, për institucionet fetare dhe kulturore, ku janë ruajtur dhe japin të dhëna për autorët, krijuesit, komentuesit dhe kopjuesit e tyre që në të shumtën e rasteve janë shqiptarë. Këto dorëshkrime hedhin dritë edhe për veprimtari e zanate të tjera që ndërlidhen me to, siç janë libërlidhja dhe puna dekorative artistike.

Pjesën më të madhe të këtyre materialeve me interes kombëtar, kësaj biblioteke ia kanë dhuruar dashamirët e shumtë të saj të cilëve do t'u jemi falënderues ne dhe gjeneratat e ardhshme.

11 prill 2004

Anthony Lee

"Krijimi i grupeve të pakicave brenda shoqërisë"
(Përmbledhje diskutimi)

Duke shfrytëzuar historinë e zezakëve në Shtetet e Bashkuara, Z.Lee do të diskutojë për atë se si raca dhe përkatësitë etnike studiohen dhe kuptohen aktualisht në studime akademike.

Ndonëse racat dhe përkatësitë etnike shtiren si kategori biologjike dhe pretendojnë të jenë dallime natyrore të qarta mes qenieve njerëzore, shënimet bashkëkohore kanë vërtetuar me prova të shumta se kjo nuk ndodh. Grupet e racave dhe ato etnike janë të krijuara me rend shoqëror, mbi themele arbitrare. Ideja e racës për shembull, nuk ka baza shkencore dhe në të vërtetë as baza racionale. Është thjeshtë një krijim artificial i dallueshmërisë, që është adoptuar nga shoqëria evropiane për arsye të caktuara historike.

Në mënyrë të ngjashme, kombësia dhe përkatësia etnike janë kategori të krijuara, sepse mund të demonstrohen lehtë. Këto kategori po ashtu mund të"rrënohen" lehtë. Kjo për të bërë të kuptohet se kufijtë e shënuar nga këto kategori janë artificiale dhe arbitrare.

Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, zezakët janë etiketuar historikisht si kategori e veçantë e qenies njerëzore. Kjo kategori, sidoqoftë, është e krijuar në mënyrë arbitrare, siç mund të tregohet nga një studim i shkurtër i kufijve të dallueshmërisë raciale. Për shembull, në SHBA, çdonjëri me prejardhje afrikane pavarësisht sa pak, konsiderohet të jetë zezak.

Kategoria përforcohet me ligj, zakon, religjion dhe tabutë shoqërore. Këto kategori dhe lloje të të menduarit mund të shihen në vende të ndryshme të botës, ku kategoritë racore dhe etnike janë krijuar që të ngrisin kufijtë mes grupeve të njerëzve.

11 prill 2003

Mr. Osman GASHI

Bashkudhëtar dhe kronikan i letërsisë

Hasan Mekuli: Letërsi botërore (Autorë dhe vepra), Sh. B. "Libri shkollor", Prishtinë, 2002

Studimet mbi letërsinë në Kosovë nuk e kanë një histori shumë të gjatë. Nuk mund të themi se janë krijuar shkolla apo orientime të veçanta kritike a teoriko – letrare. Nuk kemi as përfaqësues të mirëfilltë shkollash, rrymash apo drejtimesh të tilla. Mirëpo që në vitet e para të botimit të veprave letrare të autorëve shqiptarë e të huaj në Kosovë, diku nga mesi i viteve '50 – të të shekullit të kaluar, u shfaq edhe në fushën e kritikës letrare një zë i veçantë, një emër i ri: **Hasan Mekuli**. Që nga ajo kohë ky emër do të shndërrohet në një bashkudhëtar, në një përcjellës dhe në një kronikan të vërtetë të letërsisë sonë dhe jo vetëm të saj.

Në shkrimet e tij diskursive Hasan Mekuli do të sjellë informacione të shumta dhe do t'ia bëjë të njohur lexuesit në Kosovë autorët dhe veprat kulmore të letërsisë shqiptare të traditës dhe asaj bashkëkohore si dhe ato të letërsive të ndryshme, të afërta apo të largëta në kohë e në hapësirë.

Për më tepër se tridhjetë vjet Hasan Mekuli, ndonëse gjithnjë e avancoi diskursin e tij, gjuhën kritike dhe qasjen ndaj veprave në veçanti si dhe letërsive përgjithësisht, në esencë i mbeti besnik botëkuptimeve të tij mbi krijimtarinë letrare, ndonëse ndoqi një rrugë që s'ishte e lehtë: të zbërthente në totalitet gjithë përbërësit e një vepre letrare, duke u marrë njëkohësisht me syzheun, kompozicionin, përmbajtjen, po ashtu edhe me jetëshkrimin e autorëve si dhe me pikë-

pamjet e tyre filozofike, politike, sociale. Gjithë këtë përvojë dhe këtë pasuri idesh e botëkuptimesh Hasan Mekuli e barti për shumë vite edhe tek studentët e tij të Albanologjisë.

Hasan Mekuli shkroi shumë. Opusi i tij kritik është tejet i gjerë dhe me plot variacione. Nga kritika është cilësuar shpesh si diskurs që ka për bazë një qasje sociologjike ndaj letërsisë dhe po ashtu se e shquan tej mase funksionin shoqëror të saj. Duke pasur parasysh kontekstin kohor kur është shkruar dhe gjithashtu duke qenë se tek ne një kohë të gjatë ishte më se e nevojshme **të krijohej lexuesi i mirëfilltë**, kjo nuk është e habitshme.

Kritikat, vështrimet e studimet historiko – letrare të Hasan Mekulit kryesisht kanë mbetur të shkapërderdhura nëpër periodikun tonë letrar, në radhë të parë në revistën letrare “Jeta e Re”.

Vëllimi me studime “Letërsi botërore” (Autorë dhe Vepra), që me përpjekje e mund të jashtëzakonshëm u mblodh dhe u përzgjodh nga mësimdhënësit e Degës së Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filologjisë në Prishtinë dhe më parë studentë e kolegë të rinj të tij: Dr. Sali Bashota, Mr. Basri Çapriqi dhe Mr. Osman Gashi, përmbledh shkrimet diskurzive pa dyshim më të arrira e më karakteristike të Hasan Mekulit, që trajtojnë probleme, vepra dhe autorë të letërsisë së përbotshme.

Gjithsesi këtu kanë zënë vend studimet mbi veprën e Dante Aligierit, Shekspirit, Omar Khajamit, Leon Tolstojit, F. M. Dostojevskit, Turgenievit, Gogolit, Shandor Petëfit, Emil Zolës, Aleksandro Manxonit, Teodor Drajzerit, Mirosllav Kërlezhës, Ernest Heminguejit, Xhek Londonit, e shumë të tjerëve, veprat e të cilëve sot konsiderohen perla të letërsisë së të gjitha kohërave.

Në të gjitha këto shkrime kritike (disa edhe mund t`i quajmë edhe monografi për shkak të gjerësisë së këndvështrimeve dhe gjithëpërfshirjes) kritiku Hasan Mekuli shprehte përgjithësisht vizione të qarta, e botëkuptime të qëndrueshme. Në shkrimin e gjatë “Lirika e flaktë dhe profetike e Shandor Petëfit” ai e cilëson në këtë mënyrë këtë poet romantik hungarez: “këngëtor fisnik i dashurisë, atdhetarizmit dhe lirisë, poet, i cili bëri reformën e poezisë hungareze dhe po ashtu “këngëtor dashurie, romantik dhe plot njomësi e flakë gjaku, që i jep ngjyrë vargut të tij; këngëtor lirie, i cili deklaron pa ngurrim se jep jetën për dashurinë, por për lirinë jep edhe dashurinë, sepse atë e merr si kusht jete; poet satirik e mendimtar, për shumë arsye i brengosur dhe – profetizues çuditërisht i saktë i fatit të vet tragjik.”

Për Heminguejin pohonte se ishte “një nga shkrimtarët më të thellë dhe më humanistë, i cili gjithmonë shkonte atje ku ziente dhe ku “zgjidhej fati” i një

njeriu apo kolektivi, apo edhe fati i mbarë njerëzimit. Arriti kudo, pohonte Mekuli për Heminguejin, dhe mbeti një nga shkrimtarët më internacionalë dhe më prezentë kudo në botë, duke cituar fjalët e vet këtij prozatori të mrekullueshëm se “asnjë njeri nuk është Ujëdhesë e vetmuar, se njeriu kurrë nuk është i vetëm në det”(duke aluduar tek romani i tij “Plaku dhe deti”).

Janë gjithsesi të rëndësishme venerimet e Mekulit për romanin “Të fejuarit” e Manxonit. Jo vetëm për pasurinë e ideve dhe për problemet që trajtonte kjo vepër, por për një fakt që ka të bëjë edhe me kulturën dhe gjuhën shqipe. Duke qenë se vepra “Të fejuarit” e A. Manxonit ishte përkthyer në gegërishte ai pohon: “Dikujt mund t’i duket arkaike kjo gjuhë, mund t’i duket edhe e tepërt me botue vepra në një përkthim kësodore. Por, ata që mendojnë kështu gënjehen. Ky dhe përkthimet e këtilla kanë rëndësi shumë të madhe shkencore dhe letrare për ne dhe zhvillimin e letrave tona. Njeriu pa njeriun nuk mundet kurrsesi. As toska pa gegën, as gega pa toskën. Pra – as gegnishtja pa toskënishten, as toskënishtja pa gegnishten! Cila prej tyne asht ma e bukur, ma dinamike, ma e përshtatshme? Kjo asht gja irelevante dhe e dorës së dytë. Ma e bukur asht – gjuha shqipe si tansi. Sepse a mund ta mohojë kush bukurinë e mrekullueshme të gjuhës së Naimit, apo t’asaj të Fishtës, t’asaj të Ndre Mjedës, Gurakuqit, Çajupit, Fan Nolit dhe shumë të tjerëve. Këto gjëra Hasan Mekuli e kishte shkruar që në vitin 1967 dhe atëherë, e dimë, ende nuk ishte mbajtur Kongresi i Drejtshkrimit.

Pa dyshim sot tek ne ekzistojnë përgjithësisht botëkuptime të tjera mbi letërsinë, qasje të tjera, koncepte e preferenca të tjera leximesh, por vendi i kritikut letrar Hasan Mekuli mbetet krejtësisht i veçantë. Bota e tij e ideve, gjerësia dhe thellësia e këndvështrimeve nuk është e largët as sot.

Vëllimi me studime “Letërsi botërore tashmë e ka gjetur lexuesin, në radhë të parë midis brezave të rinj, studentëve, dhe të gjithë atyre që dëshirojnë të merren më thellë me problemet e letërsisë së përbotshme e me klasikët e saj. Do t’u shërbejë si një referencë e pashmangshme për të depërtuar në të fshehtat e artit letrar të të gjithë njerëzimit.

12 prill 2003

Dr. Liman MATOSHI

Romani është jeta e vërtetë njerëzore

Hasan Mekuli është emër i madh i kulturës sonë, është njeri që la gjurmë të thella në arsim, në shkencë dhe në kulturë. Ai i takon brezit të parë të intelektualëve tanë të pas Luftës së Dytë Botërore, të cilët, të frymëzuar nga ideale të larta humane për zhvillim shoqëror, të etur për dije e kulturë, për etikë humane e fisnikërim shpirtëror, u nisën vetëdijshëm rrugës së gjatë e të vështirë, rrugës fisnike të dijes. Ky rrugëtim ishte me plot pengesa e vështirësi nga më të ndryshmet: me shtrëngesa materiale, me mungesë të literaturës në gjuhën shqipe, me ndalesa të saj të zhvillimit normal të gjuhës shqipe e deri te pengesat e kufizimet ideologjike e politike. Por, me forcën e idealeve dhe me gjeturinë e intelektualitetit të vërtetë të Hasan Mekulit, si dhe shokëve të tij të këtij brezi dhe të këtyre idealeve (Esad Mekuli, Hivzi Sulejmani e të tjerë) diti t'i përballojë ato dhe të arrijë masën e vet të plotë njerëzore dhe kombëtare.

Në fillim të viteve '50 Hasan Mekuli nis të botojë shkrimet e tij të para, në poezi dhe në prozë. Por shpejt i kushtohet kritikës letrare dhe formave të tjera të studimit të letërsisë, për t'u bërë ndër ne, për dy decenie me radhë, lexuesi më i pasionuar dhe studiuesi më i zellshëm e më autoritativ i letërsisë, i letërsisë sonë dhe i letërsisë së huaj. Gjatë kësaj periudhe, por edhe më vonë, në vijimësi, deri në vdekje, ai ndoqi me përkushtim e profesionalizëm zhvillimin e letërsisë sonë, në mënyrë të veçantë zhvillimin e letërsisë shqipe në Kosovë, e cila, për arsyet e ditura, nuk kishte njohur përpara, pothuaj kurrfarë zhvillimi.

E gjatë, madje shumë gjatë, është lista e punimeve profesionale, e studimeve, kritikave, vështrimeve dhe e eseve për probleme të ndryshme letrare, për

fenomene e dukuri letrare, për autorë e vepra të letërsisë kombëtare dhe të letërsisë së huaj. Bibliografia e tij kap mbi 600 njësi punimesh profesionale e shkencore të botuara. Këto studime i botonte në shtypin e kohës, sidomos në revistën autoritative "Jeta e re" dhe i botonte edhe si parathënie e pasthënie të veprave letrare. Për të gjallë autori nuk arriti t'i përmbledhte në botime të veçanta. Katër vjet pas vdekjes së tij Shtëpia Botuese "Libri shko llor" në Prishtinë i botoi dy libra me studime, të cilat po i përurojmë sot, njëra me studime për romanin shqiptar dhe tjetra me studime për letërsinë e huaj.

Në librin "Romani shqiptar -kritika dhe vështrime" janë përfshirë të gjitha kritikat letrare që Hasan Mekuli ka botuar për romanin shqiptar. Në pjesën e parë të librit botuesi ka përfshirë shkrimet për romanin shqiptar për të rritur, duke iu përmbajtur kronologjisë së botimit të tyre, si shkrimin për romanin "Afërdita" të Sterjo Spasse, "Gjarpijt e gjakut" të Adem Demaçit, "Besniku" të Rexhai Surroit, "Karvani i bardhë" të Azem Shkrelit, "Njerëzit" e "Fëmijët e lumit tim" të Hivzi Sulejmanit, për romanin "Këneta" të Fatmir Gjatës, "Me valët e jetës" të Vedat Kokonës, "Lumi i vdekur" të Jakov Xoxës, "Vdekja më vjen prej syve të tillë" të Rexhep Qosjes e për disa romane të tjera. Në pjesën e dytë janë përfshirë shkrimet për romanin shqiptar për fëmijë, ndërkaq në pjesën e tretë shkrimtarë shqiptarë të Kroacisë e të Malit të Zi, shkrimi për romanin "Uria" të Augustin

Stipçeviqit dhe për romanin "Viti i Gucisë" të Zuvdi Hoxhiqit-Berishës.
Hasan Mekuli romanin e kuptonte dhe e pëlqente të jetë shprehje e botëkuptimit dhe e përvojës jetësore, reflektim i vetëdijes shoqërore të shkrimtarit. Sipas kësaj ai besonte se sa më e madhe të jetë dhuntia e krijuesit aq më tepër do të ndihen vlerat pozitive të traditës, por edhe do të zbulohen vlera të reja, që janë karakteristike për kohën dhe për shpirtin e shkrimtarit. Romani i mirëfilltë artistik është jeta e vërtetë njerëzore e shpalosur dhe e paraqitur në kuptimin e saj më të thellë dhe më të gjithanëshme. Romani i tillë zbulon dhe përgjithëson vlerat e jetës të cilat i synojmë, ose të cilat i luftojmë, prandaj para lexuesit ajo shpaloset si zbulim i ri. Kjo do të thotë se ai kërkonte nga romani ynë të formësojë kuptimësinë e jetës sonë, jetës njerëzore në përgjithësi. Kërkonte që romani të shprehte këtë qenësi dhe kuptimësi në totalitetin e vet të plotë. Këto vepra, sipas tij, synojnë dhe realizojnë vlera të plota artistike dhe, si të tilla, veçohen prej jo vlerave, prej veprave të cilat kënaqen me sipërfaqësinë jetësore, që flasin për ngjarje e fenomene jetësore jo tipike, që kultivojnë sentimentalizmin sipërfaqësor e naiv.
"Është e vërtetë e njohur që moti, që tash është bërë konvencionale" - shkruan Hasan Mekuli, se faktet e jetës nuk mund të transponohen në art në mënyrë faktografike. Kjo do të thotë se prej shtjellimit artistik hudhen të gjitha ato që janë të rastit dhe jotipike, të gjitha ato që janë të dorës së dytë, e merren vetëm ao që janë tipike e me rëndësi, që janë karakteristike". Dhe vazhdon më tutje: "Është e natyrshme se ne dëshirojmë me mish e me shpirt që romani ynë të çelë rrugë sa më të frytshme të zhvillimit të vet. Është e natyrshme të presim që ai të bëhet vepër e harmonishme, e këndshme dhe e ekuilibruar, e endur me kujdes dhe e komponuar me aftësi; presim që romani ynë të jetë shumë më i gjallë dhe më kompleks në të rrokurit me ngjarjet e jetës, shumë më plastik në paraqitjen e problematikës etj. Është e natyrshme, më në fund, edhe moskënaqësia jonë nëse, në vend të këtyre elementeve, hasim në një materie që vetëm është grumbulluar, por jo edhe e orga-nizuar, e e pjekur mirë". Këto mendime të autorit flasin për botëkuptimin letrar, për konceptet e tij estetike, por shpjegojnë edhe kriteret vlerësuese. Duke i njohur letërsisë rolin specifik shoqëror, duke e kuptuar atë si "fryt më subtil dhe më specifik" të krijimtarisë njerëzore, ai kërkonte atë që ne ndjejmë, romani të na e paraqesë përmes pamjeve të tij, në mënyrë që t'i njohim problemet, ëndrrat dhe idealet tona e përmes tyre edhe synimet, idealet e problemet e mëdha sociale, politike, filozofike e morale të shoqërisë njerëzore në përgjithësi. Si rrjedhojë, roli i saj qëndron në formësimin e vetëdijes shoqërore dhe në fisnikërimin e shpirtit njerëzor. Duke qenë njohës i mirë i letërsisë botërore është e kuptueshme që ai të kërkonte shumë nga romani ynë, me qëllim

që edhe letërsia jonë të begatojë fondin e letërsisë botërore.
Ndërkaq, kritiku letrar-shkruan Hasan Mekuli, "e ka me borxh të shkruajë si ndien, ta lexojë veprën bashkë me lexuesin që paramendon. Do të thotë, të meditojë për veprën nga të gjitha anët dhe këndvështrimet, të vrojtojë, të gjykojë mbi veprat që i do, të ushqejë mirënjohje dhe dashuri për to, por t'i vrojtojë e të flasë hapur edhe për veprat që nuk i do, që eventualisht nuk i pëlqejnë". Këtij parimi autori i është përmbajur në shkrimet që janë përfshirë në këtë libër. Në analizën e këtyre veprave letrare atë e interesojnë njësoj si permbajtja ashtu edhe forma e saj, e interesojnë temat, motivet, ngjarjet, idetë, karakteret, konfliktet, forma kompozicionale, rrjedhat e rrëfimit, veçoritë stilistike dhe gjuhësore etj. Për të gjitha këto elemente të strukturës së romaneve ai shkruan gjerësisht, shpesh deri në imtësi, por bie në sy një përqëndrim më i madh i analizës së gjithanshme të botëkuptimit dhe të psikologjisë së karaktereve të romanit.
Shkurt: kemi përpara një vepër të rëndësishme shkencore për romanin tonë, vepër që pasuron dijen tonë për këtë zhanër. Ajo do të lexohet me kënaqësi edhe nga lexuesi i rëndomtë, po sigurisht që është një ndihmesë e madhe për studentët e letërsisë dhe për specialistët e saj. Ata që do të provojnë të shkruajnë historinë e romanit tonë, pikë referuese do të kenë këtë libër.

Botues

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

•

Java
e
bibliotekës 1

•

Shtypi shtypshkronja
“Prograf” Prishtinë
2004